



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Universiteti i Evropës Juglindore

Fakulteti i Drejtësisë

Studimet Master

Programi: E Drejta Penale LLM

PUNIM MASTERI

**“KORRUPSIONI ZYRTAR DHE VEPRAT PENALE KUNDËR
DETYRËS ZYRTARE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS –
ANALIZË KRAHASUESE”**

Mentori:
Prof. dr. Ismail Zejneli

Kandidati:
Orhan Çeku

Tetovë, 2023



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Fakulteti: i Drejtësisë

Niveli i studimeve: Master LLM

Programi: E Drejta Penale

Mentori: Prof. Dr. Ismail Zejneli

Studenti: Orhan M. Çeku

Numri i ID-së: 131294

Viti i regjistrimit: 2022/2023

Tema: “KORRUPSIONI ZYRTAR DHE VEPRAT PENALE KUNDËR
DETYRËS ZYRTARE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS –
ANALIZË KRAHASUESE ”

Tetovë, 2023



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Deklarata e origjinalitetit

Me anë të kësaj deklarate, unë, **Orhan Çeku**, duke ditur përkufizimin dhe format plagjiaturës në botën akademike, deklaroj që Punimi Master me titull **“Korrupsioni Zyrtar dhe Veprat Penale kundër Detyrës Zyrtare në Republikën e Kosovës – Analizë Krahasuese”**:

- (1) Përfaqëson punimin tim origjinal, duke shmangur çdo formë të plagjiaturës, duke respektuar rregullat e shkrimit akademik për kërkimin shkencor, citimet, sistemin e referencave, konfidencialitetin e të dhënave, etj.
- (2) Të dhënat e siguruar dhe që përdoren në punim nuk kanë natyrë konfidenciale dhe janë siguruar nga institucione kompetente.
- (3) Në çdo rast është cituar burimi i të dhënave, përveç rasteve kur të dhënat statistikore apo grafike janë llogaritur nga vetë kandidati nëpërmjet programeve kompjuterike, apo modeleve simuluese.
- (4) Punimi nuk është marrë nga studentë të tjerë apo punime të tjera në Universitet ose nga ndonjë institucion tjetër akademik.
- (5) Punimi nuk është kopje e ndonjë punimi të marrë në internet apo bibliotekë.
- (6) Punimi nuk përmban modifikim të dhënash, duke i paraqitur ato si personale.

Me nënshkrimin e kësaj deklarate, konfirmoj se çfarë u tha më sipër është e vërtetë dhe për çdo gjë të vërtetuar ndryshe mbaj përgjegjësi personalisht.

Nënshkrimi

Tetovë, me _____.2023



Abstrakt

Shteti përbëhet nga institucione të degëve të ndryshme të pushtetit të cilat udhëhiqen nga teknokratë dhe zyrtarë publikë me funksione dhe kompetenca të përcaktuara në ligj apo ndonjë akt tjetër normativ. Shteti, por edhe institucionet e tij janë krijuar nga shoqëria për të shërbyer në funksion të mirëqenies së qytetarëve, sigurisë publike, duke përfshirë edhe sigurinë kombëtare. Gjatë ushtrimit të funksioneve publike, titullarët e institucioneve përballen me situata dhe sfida të cilat i bëjnë të keqpërdorin autoritetin e tyre të dhenë. Keqpërdorimi i autoritetit në ushtrimin e funksionit publik me qëllim përfitimi për vete apo për tjetrin në shkencë njihet edhe si korrupsion. Korrupsioni i zyrtarëve publik/shtetëror është një dukuri negative e përhapur pothuajse në të gjithë botën. Kësaj dukurie nuk i kanë shpëtuar as disa nga shtetet e zhvilluara të botës, e aq më pak një vend i vogël dhe i ri si Republika e Kosovës. Në këtë punim është trajtuar problemi i korrupsionit nga perspektiva e luftimit përmes ligjeve kombëtare, konventave ndërkombëtare dhe nga prizmi i bashkëpunimit institucional. Në punim janë përfshirë instrumentet kryesore ndërkombëtare kundër korrupsionit dhe legjislacioni vendor. Vëmendje e shtuar i është kushtuar masave legjislative dhe mekanizmave institucional për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në Republikën e Kosovës.

Republika e Kosovës ka një bazë të mirë ligjore në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit (Kodi penal dhe Kodi i procedurës penale, Ligji për Agjencinë kundër korrupsion, Ligji për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë, etj.), të cilat ligje plotësojnë standardet ndërkombëtare të inkuorpuara në konventa ndërkombëtare (Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit dhe Konventa penale kundër korrupsionit, etj.). Edhe pse asnjërin nga këto konventa nuk i ka nënshkruar dhe nuk është pjesë e tyre, Kosova ka inkuorpuar kërkesat e tyre në legjislacionin kombëtar.

Për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin e personave zyrtarë/zyrtarëve publik, nuk mjafton vetëm legjislacioni adekuat, por kërkohet bashkërendim i veprimeve të institucioneve kompetente në sistemin juridik (policia dhe prokurori i shtetit në njërin anë dhe sistemi gjyqësor në anën tjetër). Aktivitetit të këtyre institucioneve i shtohet edhe puna e Agjencisë Kundër Korrupsion, si institucion i pavarur me kompetenca të caktuara me ligj. Rëndësia e sistemit efektiv ligjor dhe funksionimi i institucioneve të drejtësisë është objektiv kyç në luftën kundër korrupsionit. Lufta efikase kundër korrupsionit mund të fitohet edhe duke bashkëpunuar qytetarët me organet kompetente dhe duke raportuar rastet korruptive.

Qëllimi i punimit është të analizohet kuadri ligjor ndërkombëtar dhe përputhshmëria e legjislacionit vendor – kosovar me standardet ndërkombëtare në luftën kundër korrupsionit si dhe të bëhet analizë krahasuese ndërmjet legjislacionit të Kosovës me të Republikës së Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut. Legjislacioni i Kosovës ka ngjashmëri më të madhe me legjislacionin e Republikës së Maqedonisë Veriore në krahasim me legjislacionin e Shqipërisë.

Punimi përbën interpretim juridik të normave juridike nacionale dhe instrumenteve ndërkombëtare dhe roli i tyre në luftën efikase në parandalimin dhe ndëshkimin e zyrtarëve publik të korruptuar. Në punim fokusi është përqendruar tek veprat penale të korrupsionit të parapara me Kodin Penal të Republikës së Kosovës dhe sanksionet për këto vepra penale.

Fjalë kyçe: Korrupsion, keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, legjislacion, konventë ndërkombëtare, vepër penale, zyrtarë publik, etj.



Përmbajtja:

Abstrakt.....	4
1. Hyrje.....	9
1.1. Problemi i hulumtimit.....	9
1.2. Qëllimi i hulumtimit.....	11
1.3. Hipotezat.....	11
1.4. Pyetjet kërkimore.....	12
1.5. Metodologjia e hulumtimit.....	12
1.6. Rëndësia shkencore e punimit.....	13
1.7. Struktura e punimi.....	13

KAPITULLI I PARË

1. KUPTIMI I NOCIONIT KORRUPSION.....	15
1.1. Përkufizimi i korrupsionit.....	15
1.1.1. Përkufizimi i nocionit zyrtar publik.....	25
1.2. Historiku dhe paraqitja e korrupsionit.....	29
1.3. Korrupsioni politik.....	30
1.4. Korrupsioni zyrtar.....	32
1.5. Shkaqet dhe faktorët e korrupsionit.....	33

KAPITULLI I DYTË

INSTRUMENTET NDËRKOMBËTARE KUNDËR KORRUPSIONIT.....	41
2.1. Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit.....	42
2.2. Konventa Penale kundër korrupsionit.....	44
2.3. Konventa civile kundër korrupsionit.....	46
2.4. Konventa për luftimin e ryshfetit të zyrtarëve publik të huaj në transaksionet e biznesit ndërkombëtar.....	47

KAPITULLI I TRETË

3. LEGJISLACIONI NË REPUBLIKËN E KOSOVËS KUNDËR KORRUPSIONIT.....	49
--	-----------



3.1. Kodi Penal i Republikës së Kosovës.....	49
3.1.1. Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar.....	54
3.1.2. Keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik.....	59
3.1.3. Keqpërdorimi i informatës zyrtare.....	61
3.1.4. Konflikti i interesit.....	62
3.1.5. Përvetësimi në detyrë.....	64
3.1.6. Mashtrimi në detyrë.....	65
3.1.7. Përdorimi i paautorizuar i pasurisë.....	67
3.1.8. Marrja e ryshfetit.....	67
3.1.9. Dhënia e ryshfetit.....	70
3.1.10. Dhënia e ryshfetit zyrtarit publik të huaj apo personave të huaj zyrtar.....	72
3.1.11. Ushtrimi i ndikimit.....	72
3.1.12. Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore.....	73
3.1.13. Zbulimi i fshehtësisë zyrtare.....	74
3.1.14. Falsifikimi i dokumentit zyrtar.....	75
3.1.15. Arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme.....	76
3.1.16. Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor.....	77
3.1.17. Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare.....	78
3.2. Ligji për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit.....	79
3.3. Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.....	80
3.4. Ligj për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave.....	82
3.5. Analizë krahasuese (Maqedoni e Veriut dhe Shqipëri).....	84
3.5.1. Analizë krahasuese me legjislacionin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.....	84
3.5.2. Analizë krahasuese me legjislacionin Republikën e Shqipërisë.....	87
3.5.2.1. Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik.....	89
3.5.2.2. Krime kundër autoritetit të shtetit, seksioni i vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit.....	89
3.5.2.3. Vepra penale kundër drejtësisë.....	90
3.5.2.4. Vepra penale të kryera në shoqëritë tregtare.....	91



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

KAPITULLI I KATËR

4. BASHKËPUNIMI INSTITUCIONAL PËR LUFTIMIN E KORRUPSIONIT.....92

4.1. Roli i Agjencisë për parandalimin e Korrupsionit.....	95
4.2. Roli i Policisë së Kosovës.....	99
4.3. Prokurori i shtetit.....	100
4.4. Gjykatat.....	104

KAPITULLI I PESTË

5. ANALIZA E TË DHËNAVE STATISTIKORE TË INSTITUCIONEVE TË DREJTËSISË (Këshillit Prokurorial dhe Këshillit Gjyqësor).....106

6. PËRFUNDIMI.....114

Bibliografia.....117



Lista e tabelave

Tabela 1. Konventat ndërkombëtare kundër korrupsionit.....	42
Tabela nr. 2. Legjislacioni në Republikën e Kosovës kundër korrupsionit.....	50
Tabela nr. 3. Renditja e veprave penale të korrupsionit zyrtar në Kodin Penal	54
Tabela nr.4. Veprat penale kundër detyrës zyrtare sipas Kodit Penal të Maqedonisë.....	85
Tabela nr. 5. krahasimi i veprave penale kundër detyrës zyrtare: Kodi Penal i Kosovës me të Maqedonisë së Veriut.....	87
Tabela nr. 6. Veprat penale kundër detyrës zyrtare të cilat nuk parasheh Kodi Penal i Maqedonisë së Veriut dhe parashihen me Kodin Penal të Kosovës.....	88
Tabela nr.7. Veprat penale që ndërlidhën me korrupsionin në Republikën e Shqipërisë.....	89
Tabela 8. Paraqitja tabelore e institucioneve kompetente për luftimin e korrupsionit.....	94
Tabela 9. Aktet akuzuese të cilat janë ngritur nga Prokurori i shtetit për periudhën 2015-2020.....	107
Tabela 10. Vendimet gjyqësore në lidhje me veprat penale korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare sipas rasteve të zgjidhura në periudhën 2016-2020.....	109
Tabela 11: Vendimet gjyqësore në lidhje me veprat penale korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare sipas numrit të personave të zgjidhura në periudhën 2016-2020.....	111
Grafiku nr. 1. Paraqitja grafike lakores së vendimeve gjyqësore së rasteve të zgjidhura nga gjykatat në periudhën 2016-2020.....	110
Grafiku nr. 2. Paraqitja grafike lakores së vendimeve gjyqësore sipas numrit të personave të zgjidhura nga gjykatat në periudhën 2016-2020.....	113



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Lista e shkurtesa dhe akronimeve

AKK	Agjencia për parandalimin e korrupsionit
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për sundim të ligjit
IGJK	Instituti Gjyqësor i Kosovës
KIPRED	Instituti Kosovar për kërkime dhe zhvillim të politikave
KPRK	Kodi Penal i Republikës së Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PK	Policia e Kosovës
PSRK	Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës
PSH	Prokurori i Shtetit
TI	Transparency International
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
ZKM	Zyra e Kryeministrit



1. HYRJE

1.1.Problemi i hulumtimit

Krimi ekonomik ku përfshihet korrupsioni, pastrimi i parave, kontrabanda, evazioni fiskal, trafikimi i qenieve njerëzore, dhe format e tjera të krimit të organizuar, vazhdojnë të mbeten probleme serioze për institucionet e Republikës së Kosovës. Parandalimi dhe luftimi i këtyre krimeve do të jetë një indikator serioz i konsolidimit të institucioneve ligj-zbatuese dhe efikasitetit të sistemit të drejtësisë. Ushtrimi i funksioneve të publike nga zyrtaret shtetëror, që nga nivelet e ulëta menaxheriale e deri të nivelet e larta, por edhe në sistemin e drejtësisë përballen me veprime korruptive dhe keqpërdorim të detyrës apo autoritetit zyrtar. Ky abuzim me pushtetin ka të bëjë me situatat kur zyrtarët publik gjatë ushtrimit të funksioneve të besuara nuk e respektojnë ligjin dhe përfitojnë për vete apo për tjetrin në mënyrë të padrejtë, ose i bëjnë dikujt tjetër dëm, njihet si korrupsion zyrtar apo keqpërdorim i detyrës zyrtare. Korrupsioni na paraqite edhe në sektorin privat dhe legjislacioni i parasheh edhe këto raste.

Korrupsioni është dukuri kundërligjore e cila nuk është e re dhe ndaj të cilës nuk janë imune as disa shtete të zhvilluara ekonomike apo shtete të fuqishme të cilat kanë institucione shtetërore profesionale. *“Korrupsioni dëmton rëndë ekonominë dhe shoqërinë në tërësi”*¹. Së pari, korrupsioni pengon zhvillimin ekonomik dhe biznesin e shëndoshë sepse krijon pasiguri, shtrembëron konkurrencën dhe gjeneron kosto shtesë.² Së dyti, si lehtësues i krimit, korrupsioni kërcënon edhe sigurinë tonë. Në të vërtetë, korrupsioni dhe krimi i organizuar janë të lidhura.³ Së fundi, dhe ndoshta më e rëndësishmja, korrupsioni është një kërcënim për demokracinë. Ai dobëson sundimin e ligjit, gjeneron pabarazi dhe minon besimin në institucionet publike.⁴

Korrupsioni pengon institucionet publike në ofrimin e shërbimeve cilësore, minon punën e institucioneve dhe dëmton buxhetin e shtetit. Duke qenë një dukuri e cila ka pasoja negative multidisiplinare, atëherë edhe interesi publik dhe shqetësimit për korrupsionin kanë

¹ European Commission (2014), The EU Anti-Corruption Report, p. 2

² TNS Political and Social (2017), Flash Eurobarometer 457: Businesses’ attitudes towards corruption in the EU, pp. 4-5

³ European Parliament (2016) resolution of 25 October 2016 on the fight against corruption and follow-up of the CRIM resolution (2015/2110(INI))

⁴ MéliSSa BLANCHE - Adeline DEPARDON - Félix GROS, EU Action Against Corruption: Steps forward and setbacks in a strategic policy for Europe, THEMIS COMPETITION 2019, P. 4



rezultuar në një sasi të madhe kërkimesh shkencore mbi këtë temë. Pa dyshim, ka ende boshllëqe të mëdha në gjendjen aktuale të informacionit dhe njohurive mbi këtë çështje dhe mbetet shumë për të bërë. Megjithatë, hulumtimet teorike dhe empirike që janë kryer deri më tani, kanë dhënë njohuri të reja për problemin. Tani kemi një kuptim më të qartë të shkaqeve themelore të korrupsionit, pasojat e tij, si dhe idetë dhe qasjet për masat e mundshme për ta luftuar atë. Në të njëjtën kohë, është marrë një perspektivë më e mirë për arsyet pse korrupsioni vazhdon në kaq shumë vende dhe pse është i vështirë për t'u përballur me të, megjithëse njerëzit në mbarë botën e shohin atë me disfavor. Në këtë aspekt kërkohet legjislacion strikt dhe bashkërendim të veprimeve institucionale për luftim efikas të tij. Nganjëherë nuk janë të mjaftueshme vetëm legjislacioni dhe institucione kompetente, por nevojitet edhe vullnet politik dhe vetëdije e lartë qytetarë për sjellje etike në ushtrimin e funksioneve publike. Korrupsioni mund të paraqitet edhe në sektorin privat dhe mund të ketë konsekuenca të dëmshme për ekonominë në veçanti për konkurrencën e drejtë.

Për ta penguar dhe luftuar në mënyrë efikase këtë dukuri kërkohen veprime shtetërore të organizuara në kompletimin e legjislacionit adekuat, pastaj duhet zbatuar në mënyrë konsekuente ligjet në fuqi dhe duke ndërmarrë masa adekuate për të zbuluar, penguar, apo ndëshkuar personat që shkelin rregullat juridike të atij shteti. Këto veprime kërkojnë koordinim ndërmjet institucioneve të zbatimit të ligjit (prokurorisë dhe policisë) dhe gjykatave si institucione kompetente për shqiptuar sanksione ndaj personave të korruptuar.

Republika e Kosovës është një vend i ri dhe ka probleme të theksuara me nivelin e lartë të korrupsionit që ekziston në të gjitha nivelet e pushtetit. Organizata “Transparency International” në raportin vjetor “Corruption Perceptions Index 2022”⁵ e rendit Kosovën në vendin e 84-të. Ky rangim tregon se nga viti 2018 është ulur niveli i korrupsionit në këtë shtet.

Duke qenë një veprimtari e dëmshme për shtetin dhe shoqërinë në tërësi, korrupsioni përbën edhe objekt trajtimi shkencor nga studiuesit e kësaj fushe. Trajtimi shkencor ndihmon në qasjen institucionale ndaj kësaj dukurie negative. Në këtë punim është trajtuar korrupsioni i zyrtarëve publik me fokus të veçantë në Republikën e Kosovës. Në punim është përfshirë analizimi i legjislacionit vendor dhe është krahasuar me konventat ndërkombëtare të cilat

⁵ <https://www.transparency.org/en/cpi/2022>.



merren me çështjen e luftimit të korrupsionit. Në analizën krahasuese janë përfshirë edhe shtetet fqinje të Kosovës: Shqipëria dhe Republika e Maqedonisë së Veriut. Punimi përbën një analizë penalo juridike të normave juridike vendore dhe ndërkombëtare të cilat inkriminojnë veprën penale të korrupsionit. Pra, punimi më tepër fokusohet në trajtimin e normave juridike të Kodit Penal të cilat përcaktojnë figurën e veprës penale të korrupsionit.

1.2. Qëllimet e hulumtimit

Qëllimi i punimit është të analizohet kuadri ligjor ndërkombëtar dhe përputhshmëria e legjislacionit vendor – kosovar me standardet ndërkombëtare në luftën kundër korrupsionit si dhe të bëhet analizë krahasuese ndërmjet legjislacionit të Kosovës me të Republikës së Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut.

Qëllimet e hulumtimit të kësaj teme janë:

- Analiza shkencore dhe juridike e dukurisë së keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar – korrupsioni zyrtar;
- Të analizohen aktet juridike nacionale dhe instrumentet ndërkombëtare me të cilat inkriminohet vepra penale e korrupsionit dhe keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar;
- Të shpjegohen format dhe mënyrat e shfaqjes së korrupsionit dhe keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar;
- Të evidentohet roli i institucioneve të sistemit të drejtësisë në luftimin efikas të korrupsionit.
- Të evidentohen efektet negative të dukurisë së korrupsionit për sistemin juridik dhe ekonominë e tregut të lirë.

1.3. Hipotezat

Në këtë punim janë ngritur këto hipoteza :

- Korrupsioni apo keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar paraqet një fenomen me shtrirje të gjerë në Kosovë e po ashtu edhe në Republikën e Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut;



- Korrupsioni cenon rendin juridik dhe ligjor, dëmton ekonominë dhe konkurrencën e drejtë;
- Baza ligjore në Kosovë është e mjaftueshme për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.
- Ngritja e kapaciteteve dhe bashkëpunimi institucional ndikojnë në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit;
- Forcimi i sistemit juridik (prokurorisë dhe gjykatave) ndikon në luftimin e korrupsionit.

1.4. Pyetjet kërkimore

- Sa është i përhapur Korrupsioni në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut?
- A e dëmton shtetin juridik dhe ligjor, ekonominë dhe konkurrencën e drejtë korrupsioni?
- A është e mjaftueshme baza ligjore në Republikën e Kosovës për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit?
- Si ndikon bashkëpunimi institucional në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit?
- A ndikon në uljen e nivelit të korrupsionit, forcimi i prokurorisë dhe gjykatave?

1.5. Metodologjia e hulumtimit

Në trajtimin e kësaj teme janë përdoren këto metoda:

- **Rishikimi i literaturës** (literature review). Përmes kësaj metode do të shtjellohet definimi i konceptit “Korrupsion” jemi shërbyer me literaturë të studiuesve të njohur ndërkombëtar të kësaj fushe. Gjithashtu janë cituar edhe autorë vendor dhe përkufizimet e legjislacionit.
- **Metoda dogmative dhe metoda normative**. Analiza doktrinarë e legjislacionit pozitiv në fushën e korrupsionit. Përmes kësaj metodologjie do të bëjmë interpretimin teorik – doktrinar të normave juridike penale që inkriminojnë veprën penale të korrupsionit zyrtar dhe keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar.
- **Metodat statistikore**. Përmes kësaj metode të dhënat statistikore të mbledhura nga Këshilli Prokurorial dhe Këshillit Gjyqësor i Kosovës do të krijojmë një pasqyrë të nivelit të korrupsionit që ekziston në vend. Kjo metodë na ndihmon të kuptojmë vëllimin e vendimeve gjyqësore të shqiptuara nga gjykatat e rregullta.



- **Metoda krahasuese.** Në punim është përdorur metoda e krahasimit, përmes të cilës kemi krahasuar pikat përafruese dhe dalluese të legjislacionit penal të Kosovës me shtetet si Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut.

1.6. Rëndësia shkencore e punimit

Duke qenë fenomen i pranishëm i cili dëmton rëndë ekonominë e vendit, konkurrencën e drejtë dhe të lirë, krijon pabarazi konkurruese dhe sociale, por edhe rendin juridik dhe ligjor, korrupsioni meriton trajtim serioz edhe nga prizmi shkencor. Punimi është trajtim gjithëpërfshirës i veprimtarisë kriminale të korrupsionit – duke u ndalur në aspekte ligjore të përcaktuara me dispozita juridike penale.

Punimi do të shërbej për të kuptuar rolin e legjislacionit dhe institucioneve kompetente në luftën efikase për parandalim dhe ndëshkimin e krimit të korrupsionit në institucionet publike. Gjithashtu, punimi do të shërbej për të vetëdijesuar opinionin për efektet negative që prodhon një veprimtari e tillë e paligjshme.

1.7. Struktura e punimi

Ky punim përbëhet nga pjesa hyrëse (objekti i studimit; qëllimi; pyetjet kërkimore; hipotezat; metodologjinë; rëndësinë shkencore të punimi) nga pesë kapituj; përfundimet dhe rekomandimet si dhe literatura e shfrytëzuar.

Në kapitullin e parë: “**Kuptimi i Nocionit Korrupsion**”, është trajtuar koncepti teorik i përkufizimit të termit korrupsion. Gjatë përkufizimit të termit korrupsion, janë marrë për bazë studimet e autorëve më të njohur të kësaj fushe në botë dhe autorët vendor. Gjithashtu, në trajtimin teorik definues, janë marrë parasysh edhe përkufizimet e instrumenteve ndërkombëtare, legjislacionit të brendshëm si dhe studimet e organizatave ndërkombëtare që merren me fushën e korrupsionit. Ky kapitull vazhdon me përkufizimin ligjor të termit zyrtar



publik; pastaj me historikun dhe paraqitjen e korrupsionit; llojet e korrupsionit (korrupsioni politik; korrupsioni zyrtar; si dhe shkaqet dhe pasojat e korrupsionit.

Në kapitullin e dytë: **“Instrumentet Ndërkombëtare kundër Korrupsionit”**, janë trajtuar aktet juridike ndërkombëtare të cilat merren me parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. Në këtë kontekst, instrumentet ndërkombëtare të tilla me karakter universal (Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit) dhe me karakter regjionale (Konventa e të drejtës penale kundër korrupsionit; Konventa e të drejtës civile kundër korrupsionit) të miratuara nga Këshilli i Evropës dhe Konventa për luftimin e ryshfetit të zyrtarëve publik të huaj në transaksionet e biznesit ndërkombëtar e miratuar nga Organizata për bashkëpunim ekonomik dhe zhvillim.

Kapitullin i tretë: **“Legjislacioni në Republikën e Kosovës kundër Korrupsionit”**. Në këtë kapitull është trajtuar në tërësi legjislacioni pozitiv në Republikën e Kosovës për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. Në veçanti, fokusi është përqendruar në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, përkatësisht në kapitullin XXXIII (korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare). Në kuadër të shqyrtimeve në këtë kapitull është bërë analizë krahasuese me legjislacionin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikën e Shqipërisë.

Në kapitullin e katër: **“Bashkëpunimi institucional për luftimin e korrupsionit”**, është analizuar roli i institucioneve kompetente për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, siç janë: Agjencia për parandalimin e korrupsionit; Policia e Kosovës; Prokurori i Shtetit; Gjykata e rregullta.

Kapitulli i pestë **“Analiza e të dhënave statistikore të institucioneve të drejtësisë”**. Në këtë kapitull, të dhënat statistikore 5 vjeçare të marra nga Këshilli Prokurorial i Kosovë dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës, janë paraqitur në formë tabelore dhe në paraqitje grafike dhe janë interpretuar.

Punimi është përmbyllur me përfundime dhe rekomandime.



Kapitulli i parë

1.0. KUPTIMI I NOCIONIT KORRUPSION

1.1. Përkufizimi i korrupsionit

Ekziston një shqetësim në mbarë botën për rritjen e nivelit të korrupsionit. Në vend që të ulet niveli, shohim në vitet e fundit një rritje të përfshirjes së autoriteteve publike në korrupsion. Sot, pothuajse kemi arritur në një konsensus se, korrupsioni është global. Ai ekziston në të gjitha vendet, si të zhvilluara ashtu edhe ato në zhvillim, në sektorin publik dhe privat, në organizatat joqeveritare por edhe organizata bamirëse. Akuzat dhe kundër akuzat për korrupsion tani luajnë një rol më qendror në politikë se në çdo kohë tjetër. Qeveritë kanë rënë, karriera e figurave politike të njohura botërore është shkatërruar dhe reputacioni i organizatave dhe bizneseve të respektuara është njollosur keq për shkak të përfshirjes në afera korruptive. Për këto arsye ekzistojnë tendenca në rritje në përdorimin e korrupsionit si një mjet për të diskredituar kundërshtarët politikë. Madje ky është ndër preokupimet kryesore të mediave , të cilat sjellin para publikut skandale të ndryshme korruptive sidomos të akterëve të rëndësishëm politik.

Incidenca e korrupsionit ndryshon midis shoqërive dhe mund të jetë e rrallë, e përhapur ose sistematike. Kur është e rrallë, është relativisht e lehtë të zbulohet, izolohet dhe ndëshkohet dhe të parandalohet përhapja e kësaj sëmundje. Kur korrupsioni përhapet gjerësisht, është më e vështirë të kontrollohet dhe të trajtohet. Por skenari më i keq është kur bëhet sistematik. Kur korrupsioni sistemik pushton një vend, institucionet, rregullat dhe sjelljet dhe qëndrimet e njerëzve përshtaten me mënyrën korruptive të duke bërë gjëra dhe korrupsioni bëhet mënyrë jetese. Korrupsioni sistemik është shumë i vështirë për t'u kapërcyer dhe mund të ketë një efekt shkatërrues në ekonomi.⁶

Për përkufizimin e termit korrupsion ka mendime dhe qasje të ndryshme, të cilat në instancë të fundit pajtohen se ai është një fenomen i cili ngërthen në vete abuzimin me pozitën që ushtron në sektorin publik – zyrtari publik. Personi i cili ushtron pushton ose kryen shërbime

⁶ U Myint, Corruption: Causes, Consequences and Cures. Asia-Pacific Development Journal Vol. 7, No. 2, December 2000. F. 41



të besuara përmes emërimit ose me kontratë pune në sektorin publik. Se këndejmi, duhet potencuar se ekziston një përkufizim i pranuar universalisht për korrupsionin.

“Korrupsioni është një fenomen kompleks, dinamik dhe shpesh kontradiktor. Ai është i fshehur, por i pranuar gjerësisht, i dëmshëm, por nganjëherë i dobishme, ku një viktimë sot mund të jetë një autor ose përfitues nesër. Është ky kompleksitet që mundëson që korrupsioni të minojë sistematikisht rezultatet e ndihmës zhvillimore”.⁷

"Korrupsioni dëmton seriozisht ekonominë dhe shoqërinë në tërësi"⁸. Korrupsioni pengon zhvillimin ekonomik dhe biznesin e shëndoshë sepse krijon pasiguri, shtrembëron konkurrencën dhe gjeneron kosto shtesë.⁹ Kjo dukuri na paraqitet edhe si një lehtësuese i krimit, dhe gjithashtu kërcënon sigurinë tonë. Në të vërtetë, korrupsioni dhe krimi i organizuar janë të lidhura.¹⁰ Më në fund, dhe mbase më e rëndësishmja, korrupsioni është një kërcënim për demokracinë. Ai dobëson shtetin e së drejtës, gjeneron pabarazi dhe minon besimin në institucionet publike.¹¹

Studiuesja e njohur Cecilie Wathne (2021), në hyrje të studimit të saj “Understanding corruption and how to curb it A synthesis of latest thinking”, ka renditur disa pika kryesore të cilat e përbëjnë korrupsionin.

- Korrupsioni nuk është sëmundje apo devijim, por standard historik. Asnjë vend nuk ka arritur zero korrupsion dhe asnjë vend nuk ka gjasa ta bëjë këtë në mënyrë të shpejt.
- Korrupsioni është kompleks dhe elastik. Procesi i kalimit nga një shoqëri me korrupsion të lartë në një shoqëri me korrupsion të ulët është i gjatë dhe jolinear.
- Ka shumë forma dhe shkallë të korrupsionit në të gjithë dhe brenda vendeve.
- Ndërhyrjet kundër korrupsionit duhet të bazohen në një kuptim specifik të kontekstit të nxitësve të shumtë përforcues të korrupsionit, si dhe të ekonomisë politike më të gjerë, në një lokalitet apo vend të caktuar.

⁷ Scharbatke-Church, C. and Chigas, D. 2016. Taking the blinders off: Questioning how development assistance is used to combat corruption. Occasional Paper. Medford, MA: Institute for Human Security, Fletcher School of Law and Diplomacy, Tufts University.

⁸ European Commission, The EU Anti-Corruption Report, 2014, fq.2

⁹ TNS Political and Social, Flash Eurobarometer 457: Businesses' attitudes towards corruption in the EU, 2017, fq. 4-5

¹⁰ European Parliament (2016) resolution of 25 October 2016 on the fight against corruption and follow-up of the CRIM resolution (2015/2110(INI))

¹¹ Méliissa Blanche / Adeline Depardon / Félix Gros, EU Action Against Corruption: Steps forward and setbacks in a strategic policy for Europe, Themis Competition, 2019, fq. 4



- Nuk ka asnjë plan të vetëm. Nevojitet një kombinim unik i qasjeve, mjeteve dhe aktorëve për të trajtuar shkaqet rrënjësore të korrupsionit në një kontekst të caktuar.
- Kur korrupsioni është sistematik, përpjekjet kundër korrupsionit duhet të marrin një qasje sistematike që shkon përtej individëve “mollëve të kalbura” brenda sistemit korruptiv.
- Nuk ka asnjë rrugë të vetme drejt reformës, faktorët e mundshëm të suksesit përfshijnë bashkëpunimin dhe koordinimin, ndërtimin e besimit, shfrytëzimin e dritareve të mundësive, ndërtimin dhe shfrytëzimin e vullnetit politik dhe mbështetjen e qytetarëve për qeverisje të mirë, ndryshimin e pritshmërive dhe ri formësimin e arenës së politikave.
- Ka kufij për atë se çfarë mund të arrijnë vetëm ndërhyrjet kundër korrupsionit, si dhe rolin që mund të luajnë agjencitë ndihmëse. Efektiviteti i ndërhyrjeve kundër korrupsionit varet nga ekonomia më e gjerë politike, duke përfshirë edhe arenën e politikave.¹²

Nuk ekziston ndonjë përkufizim i vetëm i pranuar universalisht në lidhje me korrupsionin. Përkufizime për korrupsionin dalin nga studiuesit e ndryshëm, nga instrumentet ndërkombëtare dhe legjislacioni vendor. I vlefshëm është edhe kontributi që japin organizatat e shoqërisë civile, prej të cilave duhet përmendur Transparency International.¹³

Një nga përkufizimet më të zakonshme të korrupsionit është "keqpërdorimi i pushtetit të besuar për përfitime private". Megjithatë, siç theksohet nga Këshilli i Evropës, 'nuk mund të gjendet një përkufizim i saktë që të zbatohet për të gjitha format, llojet dhe shkallët e korrupsionit, ose që do të ishte i pranueshëm në mënyrë universale.¹⁴

Ndër përkufizimet më të cituara, është, ai i studiuesit të njohur Nye (1967), “Korrupsioni është sjellje e cila devijon nga detyrat formale të një roli publik [zyre] për shkak

¹² Cecilie Wathne, Understanding corruption and how to curb it A synthesis of latest thinking, Chr. Michelsen Institute (CMI) in Norway, U4 Issue 2021:3, fq. 3

¹³ Transparency International është një OJQ globale, e themeluar në vitin 1993 me seli në Berlin-Gjermani, që punon në mbi 100 vende për t'i dhënë fund padrejtësisë së korrupsionit. Misioni i saj është të ndalojë korrupsionin dhe të promovojmë transparencën, llogaridhënien dhe integritetin në të gjitha nivelet dhe në të gjithë sektorët e shoqërisë.

¹⁴ Cecilie Wathne, Understanding corruption and how to curb it A synthesis of latest thinking, Chr. Michelsen Institute (CMI) in Norway, U4 Issue 2021:3, fq. 2



të përfitimeve monetare (personale, familjare të ngushtë, private) private ose statusore; ose shkel rregullat kundër ushtrimit të disa llojeve të ndikimit privat”.¹⁵

Një nga përkufizimet me të njohura është ai Rose-Ackerman (2004): “Korrupsion” është një term kuptimi i të cilit ndryshon me folësin. . . . Unë përdor përkufizimin e përbashkët të korrupsionit si "keqpërdorim i pushtetit publik për përfitime private ose politike", duke pranuar se "keqpërdorimi" duhet të përkufizohet në terma të disa standardeve. Shumë aktivitete korruptive sipas këtij përkufizimi janë të paligjshme në shumicën e vendeve – për shembull, pagesa dhe marrja e ryshfeteve, mashtrimi, përvetësimi, vetë-trajtimet, konfliktet e interesit dhe sigurimi i një çmimi pro quo në këmbim të dhuratave të fushatës. Megjithatë, një pjesë e debatit të politikave ka të bëjë me atë se ku të vihet vija ligjore dhe si të kontrollohen kufijtë e këtij fenomeni, si konfliktet e interesit, të cilat shumë sisteme politike nuk arrijnë t'i rregullojnë. Një nga debatet më të rëndësishme lidhet me çështjen e "kapjes së shtetit" ose problemin e krijimit të shoqërive të hapura demokratike/tregut në shtetet ku një elitë e ngushtë ka një ndikim joproporcional në politikën shtetërore. Në ato vende ryshfeti i drejtpërdrejtë mund të jetë i ulët, por sistemi është i mbushur me marrëveshje me interesa të veçanta që favorizojnë të paktët mbi shumicën.”¹⁶

C. Friedrich jep përkufizimin e mëposhtëm në librin e tij me titull Patologjia Politike: “Modeli i korrupsionit mund të thuhet se ekziston sa herë që një pushtetar, i cili është i ngarkuar të bëjë disa gjëra, d.m.th., që është një funksionar ose zyrtar përgjegjës, nuk ka shpërblime monetare ose të tjera të parashikuara ligjërisht, të shtyrë për të ndërmarrë veprime që favorizojnë këdo që jep shpërblimet dhe në këtë mënyrë dëmton publikun dhe interesat e tij.”¹⁷

"Korrupsioni është një aspekt i vazhdueshëm dhe praktikisht i kudondodhur i shoqërisë politike; nuk ka gjasa që ndonjë reformë ta zhdukë ndonjëherë plotësisht. Kudo që burrat konkurrojnë për mallra me vlerë, por të kufizuara, qofshin ato licenca për të operuar taksi, ekskluzivitet për të shitur mallra për qeverinë, ose liri për të drejtuar një lojë me numra, do të

¹⁵ Nye, J. S. (1967). Corruption and Political Development: A Cost-Benefit Analysis. American Political Science Review, 61, fq. 966

¹⁶ Susan Rose-Ackerman, . The Challenge of Poor Governance and Corruption. Copenhagen Consensus 2004 project. Cambridge University Press, 2004. F.1-2

¹⁷ Friedrich, Carl Joachim, “Political Pathology”, The Political Quarterly, 37.1966. fq. 74



ketë një tundim për të siguruar këto mallra përmes induksioneve korruptive nëse përpjekjet e tjera dështojnë."¹⁸

Scott¹⁹ identifikon tre standarde me të cilat përcaktohet nëse një veprim përbën korrupsion: interesi publik, opinionin publik dhe ligji. Në shumicën e rasteve, të tre kriteret përkojnë. Në fakt, aktivitetet që shoqëria që konsiderohet e korruptuar janë gjithnjë e më të paligjshme. Aktorët e korruptuar janë të aftë të gjejnë mënyra të reja për të anashkaluar ligjin. Aktet korruptive mund të institucionalizohen edhe në ligje dhe rregulla nëpërmjet asaj që njihet si kapja e shtetit.²⁰

“Korrupsioni përkufizohet si mos bindje ndaj përgjegjësive zyrtare ose dëmtimi në procesin e marrjes së një vendimi/eve, në të cilën një vendimmarrës pajtohet të devijojë ose të kërkojë devijim nga kriteri i cili duhet të vendosë vendimmarrjen e tij ose të saj, në këmbim të një shpërblimi ose për premtimin ose pritjen e një shpërblimi, ndërsa këto motive që ndikojnë në vendimmarrjen e tij ose të saj nuk mund të jenë pjesë e arsytimit të vendimit.”²¹

Me anë të korrupsionit krijohet pozitë e privilegjuar në krahasim me të drejtat dhe interesat e të tjerëve. Nocioni më i gjerë i korrupsionit konsiston në keqpërdorimin e autorizimeve zyrtare me qëllim të realizimit të fitimit privat të personit i cili e ushtron detyrën zyrtare publike. Sipas një përkufizimi tjetër korrupsioni është proces ku së paku dy persona me anë të këmbimit të ndaluar ndërmarrin veprime me qëllim të realizimit të përfitimeve personale në dëm të interesit publik dhe duke i shkelur normat juridike dhe kështu duke cenuar themelet e shtetit ligjor dhe të sundimit të së drejtës.²²

Korrupsioni përfshin ndërmarrjen ose dështimin për të ndërmarrë veprime të caktuara gjatë ose në kuadër të kryerjes së detyrave të tij si përgjigje të dhuratave pranuar ose të kërkuara, premtime ose ndikime ose si rezultat i marrjes së paligjshme të tyre pas kryerjes ose moskryerjes së veprimeve të tilla.²³

¹⁸ Gardiner, John A. 1970. The Politics of Corruption. New York: Russell Sage Foundation, fq.93

¹⁹ Scott, J. C. 1972. Comparative political corruption. Prentice-Hall. Chapter 1.

²⁰ Mason, Philip P. (2018). Pressure to change: A new donor approach to anti-corruption? Public Administration Review, 22 October.

²¹ <http://www.corruptie.org/en/corruption/what-is-corruption/>

²² Ismet Salihu. Leksikon i së Drejtës Penale. Prishtinë, 2022, f. 356

²³ Nedzat Korajlic, Driton Muharremi dhe Xhemajl Ademaj. Fjalori Terminologjia Kriminalistike. Prishtinë, 2016. F. 241-242



Korrupsioni prezanton disa aspekte të veçanta: serialitetin dhe depërtueshmërinë. Serialitetin, sepse bëhet fjalë për një krim me tendencë ri përsëritëse në pafundësi herësh. Një funksionar publik që shitet, pse do të duhet të shitet për një herë të vetme? Ai ka prirje të përsërit veprimin e njëjtë kur i jepet mundësi, pasi ai ka krijuar bindjen se nuk ndëshkohet. Depërtues ose shpërndarës është, sepse shfaqet shpejt fenomeni ku një i korruptuar pasohet shpejt ose më vonë me të tjerë, për aq kohë sa njerëzit e ndershëm lihen mënjane.²⁴

Nga instrumentet ndërkombëtare të miratuara për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, Konventa e të Drejtës Civile për Korrupsionin, e cila konventë është miratuar nga Këshilli i Evropës e përkufizon këtë dukuri:

"Korrupsion" do të thotë të kërlesh, të ofrosh, të japësh ose të pranosh, direkt ose indirekt, një ryshfet ose ndonjë avantazh apo perspektivë tjetër të panevojshme të tij, që shtrembëron kryerjen e duhur të çdo detyre ose sjelljeje të kërkuar nga marrësi i ryshfetit, avantazhin e padrejtë ose perspektiva e saj”²⁵

Organizata “Transparency International”, e përkufizon korrupsionin si në vijim:

“Korrupsioni është abuzim me pushtetin e besuar për përfitime private. Korrupsioni gërren besimin, dobëson demokracinë, pengon zhvillimin ekonomik dhe përkeqëson më tej pabarazinë, varfërinë, ndarjen sociale dhe krizën mjedisore. Zbulimi i korrupsionit dhe mbajtja e llogarive të të korruptuarve mund të ndodhë vetëm nëse kuptojmë mënyrën se si funksionon korrupsioni dhe sistemet që e mundësojnë atë.”²⁶

Në historinë e legjislacionit në Kosovë, janë miratuar, ndryshuar dhe shfuqizuar ligje të cilat kanë pasur për objekt rregullimi korrupsionin. Fillimisht është miratuar Ligjin kundër korrupsionit (Ligji Nr. 2004/34), i cili i takon periudhës para Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës. Pas këtij, është miratuar Ligji për Agjencinë kundër Korrupsion (Ligji nr. 03/L- 159) e përkufizonin termin korrupsion. Këto ligje janë shfuqizuar dhe nuk janë më në fuqi, përkatësisht janë zëvendësuar nga Ligj për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (Ligji Nr.08/L-017). Ligji i ri ka hyrë në fuqi muajin gusht të vitit 2022 dhe nuk parasheh asnjë

²⁴ Piercamillo Davigo. Sistemi i Korrupsionit. Botimet Toena, Tiranë, 2017. F. 47

²⁵ Neni 2 i Konventës Civile për Korrupsionin, Strasbourg, ETS 174 4.XI.1999,

²⁶ What is corruption? Available at: <https://www.transparency.org/what-is-corruption#define>.



dispozitë me të cilën përkufizohet termi korrupsion. Në Ligjin kundër korrupsionit (Ligji Nr. 2004/34), është përkufizuar termi korrupsion kështu:

*“Korrupsion - nënkupton çdo shkelje të detyrës së personave zyrtarë ose përgjegjës në subjektet juridike dhe çdo veprimtari e iniciatorëve apo përfituesve të kësaj sjelljeje, e drejtuar si përgjigje ndaj një shpërblimi që drejtpërdrejt ose indirekt është premtuar, ofruar, dhënë, kërkuar, pranuar apo është pritur për t’u marrë për veten apo për një person tjetër”.*²⁷

Ndërsa, Ligji për Agjencinë kundër Korrupsion (Ligji nr. 03/L- 159), e përkufizonte këtë term:

“Korrupsion – çdo keqpërdorim të pushtetit apo çdo sjellje tjetër të personit zyrtar, personit përgjegjës apo personit tjetër me qëllim të arritjes së një përparësie apo përfitimi të kundërligjshëm për veten apo për tjetrin”.

Ligj i ri për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (Ligji Nr.08/L-017), nuk përmban normë me të cilën përkufizohet korrupsioni dhe as nuk ka dispozitë referenciale për këtë çështje. Kjo len të nënkuptohet se përkufizimi i korrupsionit zyrtar dhe privat bëhet nga inkriminimi i veprës që e ka paraparë Kodi Penal i Republikës së Kosovës (në vijim referuar si KPRK). Kodi penal në kapitullin XXXIII (Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare), e parasheh veprën penale *“Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”*. Sipas nenit 414 të KPRK-së:

*Personi zyrtar, i cili duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që t’i shkaktojë dëm personit tjetër ose që t’i shkel të drejtat e personit tjetër, dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.*²⁸

Pra, esenca e kryerjes së kësaj vepre penale qëndron në keqpërdorimin e detyrës apo autoritet zyrtar nga një person i cili është duke ushtruar një funksion me prerogativa të pushtetit apo ndonjë shërbim publik (përkufizimi i nocionit zyrtar publik vijon në pikën pasuese).

²⁷ Ligjin kundër korrupsionit (Ligji Nr. 2004/34), neni 2

²⁸ Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Kodi Nr. 06/L-074), neni 414.



Korrupsioni ekziston gjithashtu brenda dhe ndërmjet bizneseve private, brenda organizatave joqeveritare dhe ndërmjet individëve në marrëdhëniet e tyre personale, pa përfshirë asnjë agjenci shtetërore apo zyrtar shtetëror. Ka edhe korrupsion në formën e ryshfetit, mashtrimit dhe metodave mafioze brenda dhe ndërmjet bizneseve private, ka individë tradhtarë dhe punonjës të pabesë edhe në firma private. Ky lloj korrupsioni madje mund të ketë pasoja në sistemin politik pasi shkatërron moralin publik dhe mund të jetë simptomatik për zhvillimin e përgjithshëm ekonomik dhe moral të një shoqërie.²⁹

Edhe KPRK-ja e parasheh dhe e ka inkriminuar veprën penale të korrupsionit në sektorin privat. Këto vepra penale janë përfshirë në Kapitullin e veprave penale kundër ekonomisë. Në këtë kapitull janë inkriminuar dy vepra penale që kanë të bëjnë me korrupsionin: Pranimi i ryshfetit në sektorin privat (neni 309 i KPRK-së) dhe Dhënia e ryshfetit në sektorin privat (Neni 310 i KPRK-së).

Korrupsioni mund të jetë aktiv dhe pasiv. Në të vërtetë, në të gjitha rastet korruptive kemi, korrupsion pasiv dhe aktiv. Korrupsion aktiv kryen subjekti i cili jep ryshfet, dobi pasurore me qëllim të përfitimit të ndonjë favore në mënyrë të padrejtë. Ndërsa korrupsion pasiv kryen subjekti i cili pranon ryshfet, prano dobi pasurore kundërligjshëm për kryerjen e ndonjë punë në dobi të dhënësit të ryshfetit në mënyrë të pa drejtë.

Autorët Matthew Murray dhe Andrew Spalding, mendojnë se korrupsioni shkel të drejtat e njeriut. Ata janë të mendimit korrupsioni zyrtar përbën shkelje të të drejtave të njeriut. Në studimin e tyre “Liria nga korrupsioni zyrtar si e drejtë e njeriut” (Freedom from Official Corruption as a Human Right), duke analizuar faktin “Pse ta quajmë korrupsionin si shkelje të të drejtave”?, përmendin katër arsye:

Së pari, të drejtat e njeriut zënë rrënjë në filozofi dhe teori ligjore, rriten në mënyrë organike dhe përhapen për të formuar një moral universal. Ato tejkalojnë rrethanat politike, ekonomike dhe kulturore të përdorura shpesh për të justifikuar dhe racionalizuar sjelljen e keqe. Ekzistojnë shkolla të ndryshme të mendimit filozofik mbi mënyrën se si formohet e drejta e njeriut dhe kuptohet si një e drejtë e patjetërsueshme dhe themelore për të cilën një person ka të drejtën e natyrshme. Pikëpamja jonë është se teoria e së drejtës natyrore e John Locke ofron

²⁹ Inge Amundsen, “Political Corruption: An Introduction to the Issues”, Chr. Michelsen Institute Development Studies and Human Rights, WP 1999. Fq. 3



themelin për të drejtën e njeriut për të qenë i lirë nga korrupsioni zyrtar. Globalizimi e bën të mundur kodifikimin e kësaj lirie si një e mirë publike dhe si produkt i konsensusit shoqëror. Qeveritë kombëtare dhe organet ndërkombëtare mund të vendosin në mënyrë legjitime një rregull universal në këmbim të sigurisë dhe përfitimeve ekonomike. Më tej, siç ilustron akti i guximit të Mohamed Bouazizi, e drejta e njeriut për të qenë i lirë nga zhvatja e qeverisë është një shprehje jetike e vullnetit dhe aftësisë njerëzore për liri. Së dyti, konsiderimi i korrupsionit si shkelje e të drejtave u jep ligjeve ndërkombëtare dhe vendase peshë më të madhe normative, duke rritur rëndësinë e tyre në politikat publike. Shkeljet e të drejtave janë kuptuar prej kohësh si më skandaloze dhe një prioritet më i lartë zbatimi se sa deliktet apo edhe krimet. Shkeljet e të drejtave janë "më rezistente ndaj kompromiseve". Së treti, njohja e një të drejte universale të njeriut për të qenë i lirë nga korrupsioni kundërshton në mënyrë efektive kundërshtimin më të dëgjuar ndaj nismave ndërkombëtare kundër korrupsionit: se korrupsioni është kulturor. Një e drejtë e njeriut sipas përkufizimit është "një e drejtë morale universale, diçka që të gjithë [personat], kudo, në çdo kohë duhet ta kenë, diçka nga e cila askush nuk mund të privohet pa një fyerje të rëndë ndaj drejtësisë, diçka që i detyrohet çdo njeriu. duke qenë thjesht sepse [a] është njeri." Të drejtat ekzistojnë pavarësisht nëse ndonjë qeveri e caktuar, grup praktikash kulturore bashkëkohore, apo edhe opinionin publik mbizotëruar i pranon ato. Së katërti, një qëllim kryesor i konventave ndërkombëtare kundër korrupsionit është parandalues – krijimi i standardeve më të larta të sjelljes zyrtare që lehtësojnë qeverisjen e mirë, rritjen ekonomike dhe sigurinë kombëtare. Po kështu, instrumentet ligjore që vendosin të drejtat e njeriut janë zgjeruar për të përfshirë të drejtën për të gëzuar pronësinë e dikujt dhe për të siguruar arsimim dhe shëndet. Por, si mund të nxisë e drejta ndërkombëtare kushtet e nevojshme për të mbështetur të mirën qeverisjen dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut të dakorduara? E pra, të gjitha këto konventa sugjerojnë se parandalimi i korrupsionit zyrtar është një parakusht thelbësor për të përmbushur këto synime.³⁰

Në kuptimin juridiko penal, korrupsioni është vepër penale e përcaktuar me Kodin penal dhe për të cilën është paraparë sanksioni penal.

³⁰ Matthew Murray and Andrew Spalding. Freedom from Official Corruption as a Human Right. Governance Studies at Brookings Institution, January, 2015, f. 5



Nga të gjitha përkufizimet e sipërpërmendura duhet të nxjerrim të gjitha elementet të cilat e përbëjnë nocionin kompleks të korrupsionit. Në radhë të parë – korrupsioni është veprim i kundërligjshëm (me Kodin penal është e paraparë si vepër penale dhe është caktuar sanksioni penal), pra veprimi i subjekteve është kundërligjor. Subjekte të korrupsionit janë të paktën dy persona (subjekti aktiv dhe subjekti pasiv), nga të dyja anët mundën me qenë më shumë persona. Për tu llogaritur si vepër penale e korrupsionit zyrtar, duhet që njëri subjekt – subjekti pasiv të jetë zyrtar publik, përkatësisht person i cili ushtron detyra publike, është i veshur me autorizime shtetërore – publike (punon në një institucion publik – paguhet për punën e tij nga buxheti i përgjithshëm i shtetit). Ky subjekt duhet të ndërmerr veprim të kundërligjshëm gjatë ushtrimit të funksionit të tij zyrtar. Duke shkelur ligjin, gjatë ushtrimit të funksionit zyrtar, subjekti (subjekti pasiv) pranon dhurata, dobi pasurore për vete ose për ndonjë person tjetër ose i bën dëm një personi të tretë. Duke pranuar dhurata ose dobi tjetër pasurore i jep favore subjektit dhurues (subjektit aktiv) që nuk i takon sipas ligjit. Dhënia e favorit rezulton me shkelje të ligjit, pasi që subjekti aktiv nuk i plotëson kushtet për të marrë favorin, d.m.th., nëse nuk do të jepte dhurata ose dobi tjera pasurore, subjekti aktiv nuk do të mund të përfitonte nga zyrtari publik (subjekti pasiv). Në këtë mënyrë, cenohen të drejtat e subjekteve tjera të cilat paraqiten në punë publike, dëmtohet konkurrenca e mirëfilltë, humb besimi në institucione dhe përfshihet zyrtaret e shtetit në inkriminime penale. Kësisoj, subjektet aktive të korrupsioni, përfitojnë dobi nga punët publike dhe krijojnë bagazh ekonomik. Ata krijojnë monopole ekonomike dhe shkatërrojnë konkurrencën. Punët publike të cilat kryhen nga të korruptuarit nuk janë të cilësisë së lartë dhe efektet negative shihen në teren. Politikanët e nivelit të lartë, duke përdorin fuqinë e tyre dhe pushtetin, përfshihen në afera korruptive dhe financojnë fushatat e tyre elektorale. Në këtë mënyrë ata pastaj japin punë publike për financuesit e fushatave në mënyrë të paligjshme. Gjithashtu mund të punësohen njerëz pa meritokraci dhe dëmtohet shteti nga individë të papërgjegjshëm të cilët nesër priten të korruptohen ose të kryejnë punë për interesa të grupeve kriminale. Në këtë mënyrë zgjerojnë rrjetin e krimit ekonomik (krimi i organizuar) dhe financojnë edhe veprimtari tjera kundërligjore duke përfshirë edhe pastrimin e parave. Duke krijuar asete ekonomike-financiare, krijojnë rrjete kriminale të fuqishme dhe depërtojnë thellë në strukturat shtetërore. Në këtë mënyrë cenohet rendi juridik dhe ligjor, krijohet pasiguri juridike, dëmtohet buxheti i shtetit dhe bjen kredibiliteti i institucioneve shtetërore.



Përveç korrupsionit zyrtar, në shoqëritë moderne paraqitet edhe korrupsioni në sektorin privat. Për këtë arsye, ligjdhënësi ka paraparë edhe vepra penale që mund të kryhen në sektorin privat, siç janë marrja dhe dhëna e ryshfetit. Pra, siç shihet, korrupsioni është gjithëpërfshirës, përfshinë të gjitha kategoritë dhe shtresat e shoqërisë. Dëmet e të cilit janë evidente, ku më shumë e ku më pak.

1.1.1. Përkufizimi i nocionit zyrtar publik

Në përcaktimin e nocionit korrupsion, element i domosdoshëm është keqpërdorimi i detyrës zyrtare. Këtë veprim të kundërligjshëm mund ta kryejnë zyrtarët publik (shërbyesit civil dhe zyrtarët shtetëror të emëruar përmes procesit politik). Në këtë aspekt është më rëndësi të bëhet përkufizimi i termit “*zyrtar publik*”, pasi që përbën elementin e domosdoshëm për përcaktimin e figurës së veprës penale të korrupsionit.

Në radhë të parë vlen të përmendet Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit, e cila e bën përkufizimin e termit zyrtarë publik:

a) “Zyrtarë publik” është:

(i) çdo person që mban në post legjislativ, ekzekutiv, administrativ ose gjyqësor në një shtet palë, i emëruar ose i zgjedhur, i përhershëm ose i përkohshëm, i paguar ose i papaguar, pavarësisht nga kohëzgjatja e shërbimit të personit;

(ii) çdo person tjetër që ushtron një funksion publik, duke përfshirë në agjenci publike ose ndërmarrje publike, ose që kryen një shërbim publik, sipas përcaktimit të ligjit të brendshëm të shtetit palë dhe sipas zbatimit në sferën përkatëse të ligjit në shtetin palë;

(iii) çdo person tjetër të përcaktuar si “nëpunës publik” në ligjin e brendshëm të shtetit palë, megjithatë, për qëllimet e disa masave specifike që parashikohen në kapitullin II të kësaj Konvente, “nëpunës publik” është çdo person që ushtron një funksion publik ose jep një shërbim publik sipas parashikimit të ligjit të brendshëm të shtetit palë dhe sipas zbatimit në fushën përkatëse të ligjit të shtetit palë.



b) “Nëpunës publik i huaj” është çdo person që ka një post legjislativ, ekzekutiv, administrativ ose gjyqësor të një shteti të huaj, i emëruar ose i zgjedhur, dhe çdo person që ushtron një funksion publik për një vend të huaj, duke përfshirë një agjenci publike ose një ndërmarrje publike.

c) “Nëpunës i një organizate publike ndërkombëtare” është një punonjës i shërbimit civil ndërkombëtar ose çdo person që është i autorizuar nga një organizatë e tillë për të vepruar në emër të asaj organizate. d) “Pronë” është pasuri e çdo lloji, materiale ose jomateriale, e tundshme ose e patundshme dhe dokumentet ose instrumentet ligjore që vërtetojnë tituj ose interesa në pasuri të tilla.³¹

Përkufizimin e termit person zyrtar/zyrtarë publik e ka dhënë edhe Konventa Penale Kundër Korrupsionit (27.01.1999), Sipas kësaj Konvente:

a) “Zyrtar publik” do të kuptohet në referencë me përkufizimin e “zyrtar” “shërbyes publik”, “kryebashkiak”, “ministër”, ose “gjyqtar”, në ligjin kombëtar të shtetit në të cilin personi në fjalë ushtron funksion dhe sikurse zbatohet në ligjin e tij penal;

b) termi “gjyqtar” i referohet paragrafit të mësipërm “a” dhe përfshin prokurorët dhe mbajtësit e shërbimeve gjyqësore;

c) në rastin e procedimeve që përfshijnë një zyrtar publik të një shteti tjetër, shteti procedues mund të zbatojë përkufizimin e zyrtarit publik, vetëm në rast se ky përkufizim përputhet me ligjin e tij kombëtar”;

d) “Person juridik” do të kuptohet çdo entitet që ka këtë status, sipas ligjit kombëtar të zbatueshëm, përveçse për shtete ose trupa të tjerë publike në ushtrim të autoritetit shtetëror dhe për organizata ndërkombëtare publike.”³²

Pra, Konventa i përmend në mënyrë taksative disa autoritete të cilët kanë statusin e zyrtarit publik (ministër, kryebashkiak, gjyqtar apo persona tjerë të cilët ushtrojnë funksione zyrtare), po ajo parasheh që termi zyrtar publik të zbatohet ashtu siç e parasheh legjislacioni vendor. Në këtë aspekt gama e personave të cilët marrin statusin e zyrtarit publik është mjaft e gjerë.

³¹ United Nations Convention Against Corruption, article 2/a, b dhe c

³² Konventa e të drejtës penale për Korrupsionin, neni 1/a



Nocioni person zyrtar përkufizohet edhe me dispozitat e KPRK-së. Sipas KPRK-së:
Person zyrtar - nënkupton:

2.1. personi i cili në organin shtetëror kryen punët zyrtare;

2.2. personi i zgjedhur, i emëruar ose i caktuar në organin shtetëror, në organin e pushtetit lokal ose personi që përherë ose përkohësisht kryen detyrat zyrtare ose funksionet zyrtare në ato organe;

2.3. personi në institucion, ndërmarrje ose në ndonjë subjekt tjetër, të cilit i janë besuar kryerja e autorizimeve publike, që vendos për të drejtat, obligimet ose interesat e personave fizik apo juridik ose për interesin publik;

2.4. person zyrtar konsiderohet edhe personi të cilit i është besuar kryerja faktike e detyrave të caktuara zyrtare apo punëve;

2.5. person ushtarak përpos kur janë në pyetje dispozitat e Kreut XXXIII (Veprat penale kundër detyrave zyrtare) të këtij Kodi.³³

Përkufizimi i lartpërmendur mbulon personat të cilët kryejnë detyrën zyrtare ose ushtrojnë funksion zyrtar në organet e shtetit (duke përfshirë kryetarët e komunave dhe ministrat, gjyqtarët dhe prokurorët), pavarësisht llojit të kontratës së tyre dhe të karakterit të përkohshëm/përherëshëm të funksionit që kryejnë. Shtrirja e gjerë e këtij përkufizimi lejon gjithashtu përfshirjen e individëve të caktuar me ligj për të kryer detyra të caktuara të administratës së shtetit ose të ofrojnë shërbime publike apo detyra zyrtare të veçanta (p.sh.: doktorët, mësimdhënësit dhe profesorët, instruktorët e auto-shkollave, punonjësit social, etj.), punonjësit e ndërmarrjeve publike, etj.³⁴

Termi zyrtar publik përkufizohet edhe nga ligji i cili rregullon raportet juridike të zyrtarëve publik, përkatësisht Ligji për Zyrtarët Publik. Sipas këtij ligji:

2. Zyrtarë publikë janë:

³³ Kodi Nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, neni 113/2

³⁴ Flemming Denker, Drino Galičić, Jean-Christophe Geiser dhe Edmond Dunga, "Raporti i Vlerësimit mbi përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare në fushën e luftës kundër korrupsionit (LKK), Këshilli i Evropës, Prill 2015, Edicioni në gjuhën shqipe (I përkthyer nga gjuha angleze) Botuar nga Këshilli i Evropës F-67075 Strasbourg Cedex www.coe.int, fq. 115



2.1. nëpunësi i Shërbimit Civil;

2.2. nëpunësi i Shërbimit Publik;

2.3. nëpunësi i Kabinetit (i shfuqizuar me vendim të Gjykatës Kushtetuese të republikës së Kosovës³⁵); dhe

2.4. nëpunësi administrativ dhe mbështetës.

3. Nëpunës civil - është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë.

4. Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike.

5. Nëpunës i Kabinetit - është zyrtari publik, që ushtron detyrën në Kabinetin e Presidentit të Kryetarit të Kuvendit, të Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, të Kryeministrit, të Zëvendëskryeministrit, të Ministrit ose të titullarit të një institucioni të pavarur kushtetues dhe të Kryetarit të Komunës. Statusin e nëpunësit të Kabinetit e kanë edhe nëpunësit të cilët ushtrojnë detyrat për nën kryetarin e Kuvendit të Kosovës dhe për grupin parlamentar.

6. Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike.³⁶

Pra, nuk ka mospërputhje ndërmjet dispozitave të KPRK-së dhe Ligjit për Zyrtarët Publik. Me rastin e përcaktimit të figurës së veprës penale, në aktakuzë apo vendim gjyqësor,

³⁵ Akgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. ref.:AGJ 1583/20, në rastin nr. KO203/19 parashtues Avokati i Popullit Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve të caktuara të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë

³⁶ Ligji Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë, neni 2



duhet të merret parasysh përkufizimi i nocionit zyrtar publik. Për këtë arsye edhe është e rëndësishme të mos ketë mos përputhje ndërmjet të dy ligjeve. Në rast të ekzistimit të dallimeve në përkufizim, atëherë në përcaktimin e termit zyrtar publik me rastin e ngritjes së aktakuzës apo shqiptimit të sanksionit penal për veprën penale të korrupsionit, mendojmë se duhet të merret përkufizimi i Ligjit për Zyrtarët Publik, pasi që është ligj special me të cilin rregullohet punë dhe veprimtaria e zyrtarëve publik në vend.

1.2. Historiku dhe paraqitja e korrupsionit

Ashtu sikurse çdo fenomen shoqëror apo koncept shkencor, edhe korrupsioni i ka një zhvillim historik. Përpyekjet kundër korrupsionit shpesh përshkruhen si një luftë për të luftuar dhe madje çrrënjosur korrupsionin. Ndonëse një gjuhë e tillë mund të jetë e dobishme për të tërhequr vëmendjen ndaj çështjes, është e rëndësishme të njihet qëndrueshmëria historike e korrupsionit. Korrupsioni është jo një 'sëmundje' e sapo shfaqur që mund të kurohet me kombinimin e duhur të trajtimeve. Nuk është një devijim dhe nuk mund të shpjegohet duke fajësuar kulturën kombëtare. Korrupsioni është i përhapur dhe ekziston për mijëra vjet.

Korrupsioni ndodh kur zyrtarët publike të "*Të mirat publike*" të një shoqërie i kthejnë ato në të mirat e tyre private.³⁷

Argumenti ynë kryesor është se korrupsioni sistematik është rrënjosur thellë në strukturën politike shoqërore dhe historike të një shteti. Ky argument është në përputhje me një literaturë në rritje mbi institucionalizimin historik, i cili argumenton se kushtet historike duke filluar nga institucionet të burimet natyrore mund të kenë efekte afatgjata në prosperitetin ekonomik dhe demokratizimin.³⁸

³⁷ Rothstein, Bo and Jan Teorell. 2012. "Defining and measuring quality of government." Pp. 6-26 in Good Government: The Relevance of Political Science, edited by S. Holmberg and B. Rothstein. Cheltenham: Edward Elgar.

³⁸ Daron Acemoglu and James A. Robinson, Why Nations Fail: The Origins of Power, Prosperity and Poverty (London: Profile, 2012). Diego Comin, William Easterly, and Erick Gong. "Was the Wealth of Nations Determined in 1000 BC?" American Economic Journal-Macroeconomics, 2 (July 2010), 65–97.



1.3. Korrupsioni politik

Korrupsioni politik është një lloj korrupsioni që përfshin vendimmarrësit politikë. Kjo ndodh kur politikanët dhe zyrtarët publikë që janë përgjegjës për zbatimin e drejtë të ligjeve përdorin fuqinë e tyre politike për të mbështetur fuqinë dhe pasurinë e tyre dhe/ose marrin vendime në dobi të interesave private³⁹. Kështu, korrupsioni politik shpesh përfshin abuzimin e pushtetit dhe çon jo vetëm në keq shpërndarjen e burimeve, por gjithashtu ndikon në procesin vendimmarrës – në mënyrën në të cilën merren vendimet⁴⁰. Kjo nënkupton se vendimet e pushtetarëve janë të ndikuara nga interesat e ngushta të atyre që i mbajnë pozitat udhëheqëse. Në vend se të merren vendime politike me të cilat rritet mirëqenia e qytetarëve, zakonisht merren vendime me të cilat favorizohen oligarkë dhe persona të fuqishëm nga fusha e biznesit dhe ekonomisë.

Korrupsioni politik ka bërë me marrjen dhe mbajtjen e pushtetit dhe privilegjeve të caktuara politike, nga pozicioni lokal e deri të ai qendror. Korrupsioni politik duhet kërkuar në lidhshmëri të një elitë politike me bartësit e fuqishëm ekonomik të cilët njëherë janë edhe financues të partive politike.⁴¹

Korrupsioni i nivelit të lartë i referohet sjelljes së keqe në krye dhe nga politikanët kryesorë. Meqenëse këta njerëz janë përgjithësisht të pasur dhe kanë shumë privilegje që lidhen me postin e tyre të lartë, sjellja e tyre korruptive nuk i atribuohet pagave të ulëta dhe nga nevoja për të përballuar shpenzimet e jetesës së familjeve të tyre. Në vend të kësaj, lakmia konsiderohet një faktor kryesor motivues. Por ka edhe detyrime të tjera. Qëndrimi në detyrë, për shembull, mund të jetë gjithashtu një forcë motivuese kryesore. Ndërsa fushatat zgjedhore po bëhen të shtrenjta, korrupsioni në lidhje me financimin e fushatës është një çështje e madhe politike në disa vende.⁴²

³⁹ Transparency International. 2009. Anti-Corruption Plain Language Guide

⁴⁰ Amundsen, I. (1997). Political corruption: An introduction to the issues. Chr. Michelsen Institute Development Studies and Human Rights, 1997, fq. 3

⁴¹ Nedzat Korajlic, Driton Muharremi dhe Xhemajl Ademaj. Fjalori Terminologjia Kriminalistike. Prishtinë, 2016. F. 242

⁴² U Myint, Corruption: Causes, Consequences and Cures. Asia-Pacific Development Journal Vol. 7, No. 2, December 2000. F. 40



Me rëndësi të veçantë që të përmendet këtu është se “kuadri zyrtar ligjor i shtetit është i pamjaftueshëm për të referuar, vlerësuar dhe gjykuar problemin e korrupsionit politik. Do të duhen sjellë standarde morale, normative, etike dhe në të vërtetë politike, të paktën sepse do të jetë e nevojshme të dallohet ligjshmëria nga legjitimiteti kur bëhet fjalë për korrupsionin politik. Përveç kësaj, korrupsioni burokratik normalisht mund të merret përmes auditimit, legjislacionit dhe rregullimeve institucionale, efektet degjeneruese të korrupsionit politik nuk mund të kundërvihen vetëm nga një qasje administrative. Korrupsioni politik endemik kërkon reforma rrënjësore politike”⁴³. Ky lloj i korrupsionit me të drejtë edhe mund të konsiderohet si forma e korrupsionit që zakonisht mbizotëron në sistemet autoritare. Në këtë drejtim thuhet me të drejtë se “korrupsioni politik (zakonisht i mbështetur nga korrupsioni i përhapur burokratik ose i vogël) duhet të konsiderohet më tej si një nga mënyrat themelore të funksionimit të regjimeve autoritare. Këtu, korrupsioni është rrallë një sëmundje që politikanët përgjegjës janë të etur ta shmangin, është një praktikë e qëllimshme, e kërkuar dhe e zbatuar; është një nga mënyrat e sundimtarëve të pasurimit dhe kontrollit ekonomik”⁴⁴.

Masat për parandalimin dhe frenimin e korrupsionit politik shpesh përfshijnë iniciativa në fushat e mëposhtme:

- **Financat politike:** Është thelbësore të ketë rregulla të qarta në lidhje me financimin e partive politike dhe kandidatëve, si dhe një organ të fortë mbikëqyrës që heton plotësisht korrupsion dhe abuzime të mundshme. Transparenca është gjithashtu instrumentale për të lejuar shoqërinë civile, mediat dhe votuesit të monitorojnë procesin.
- **Korrupsioni në zgjedhje:** Një kornizë e qartë ligjore që përcakton rregullat për administrimin e zgjedhjeve si dhe një organ i fuqishëm mbikëqyrës është thelbësor për të parandaluar mashtrimin zgjedhor, blerjen e votave dhe shpërdorimin e detyrës. Monitorimi i zgjedhjeve mund të përfshijë monitorimin e financimit të fushatave zgjedhore dhe partive politike, keqpërdorimin e fondeve shtetërore dhe burimeve

⁴³ Inge Amundsen: “Political Corruption: An Introduction to the Issues”, Chr. Michelsen Institute Development Studies and Human Rights, 1997, fq.4

⁴⁴ Ibid, fq.4



administrative publike për qëllime elektorale dhe ryshfet ndaj votuesve dhe zyrtarëve zgjedhorë.

- **Ndikimi i korporatës në vendimmarrje:** Mundësitë për blerjen e ndikimit në qeveri nuk kufizohen vetëm në procesin zgjedhor; prandaj, vendet duhet të kërkojnë të zbatojnë rregulla që rregullojnë lobimin dhe lëvizjen mbrapa-mbrapa ndërmjet zyrave publike dhe kompanive private (dera rrotulluese).
- **Favorizimi:** Për të siguruar që politikanët të mos abuzojnë me pushtetin dhe burimet e tyre shtetërore dhe që vendimet të merren në interes të qytetarëve në përgjithësi, është thelbësore të futen kodet e sjelljes, rregullat për konfliktin e interesit dhe regjimet e deklarimit të pasurisë. Rregulla të mëtejshme për të rritur integritetin në politikë mund të përfshijnë rregulla të papajtueshmërisë.
- **Mosndëshkimi i politikanëve dhe anëtarëve të qeverisë.** Në shumë raste, politikanët mund të përdorin pushtetin e tyre për të ushtruar ndikim mbi gjyqësorin në mënyrë që të mbeten të pandëshkuar për korrupsion dhe krime të tjera. Përveç kësaj, në shumë vende politikanët gëzojnë privilegje të mëdha dhe imunitet që i ndihmojnë ata të mbeten të pandëshkuar. Rregullat e imunitetit duhet të jenë të balancuara – duke mbrojtur funksionet që mbajnë politikanët, por edhe duke i lejuar politikanët të mbahen përgjegjës për vepra më të rënda (sidomos me vepra penale).⁴⁵

1.4. Korrupsioni zyrtar (i nivelit të ulët)

Korrupsioni i nivelit të ulët – siç është pagesa e fshehtë që duhet t'i bëhet një nëpunësi për të përshpejtuar lëshimin e lejes së drejtimit - ka grupin e vet të problemeve. Në këtë rast perceptimi i përgjithshëm është se nëpunësit civilë me paga të pamjaftueshme për të përballuar shpenzimet e jetesës së familjeve të tyre janë të shtyrë nga nevoja për t'u përfshirë në praktika korruptive. Rritja e pagës së tyre, argumentohet, do të nënkuptojë më pak nevojë për t'u varur nga aktivitetet e paligjshme për të fituar jetesën, ndërsa ata kanë më shumë për të humbur nëse kapen.⁴⁶

⁴⁵ Francesco Bosso, Maíra Martini, Iñaki Albisu Ardigó. Political Corruption Topic Guide Compiled by the Anti-Corruption Helpdesk. Transparency International. F. 3

⁴⁶ U Myint, Corruption: Causes, Consequences and Cures. Asia-Pacific Development Journal Vol. 7, No. 2, December 2000. F. 40



Ish-kreu i Kombeve të Bashkuara Kofi Annan në një adresim të tij ka përmendur edhe dëmet që shkakton korrupsioni zyrtar:

“Korrupsioni është një plagë e fshehtë që ka një gamë të gjerë efektesh gërryese në shoqëritë. Ajo minon demokracinë dhe sundimin e ligjit, çon në shkelje të të drejtave të njeriut, shtrembëron tregun, gërryen cilësinë e jetës dhe lejon që lulëzimi i krimit të organizuar, terrorizmit dhe kërcënimeve të tjera për sigurinë e njeriut. Ky fenomen i lig është gjetur në të gjitha vendet - të mëdha dhe të vogla, të pasura dhe të varfra - por në botën në zhvillim efektet e tij janë më shkatërruese.”⁴⁷

Korrupsioni i vogël është forma në të cilën përfshihen shuma relativisht më të vogla parash ose ndikimi i të cilit ka efekte më të vogla në vend. Kjo formë e korrupsionit shpesh injorohet, por efektet e saj janë edhe më të dëmshme se ato të korrupsionit të madh nëse përmbledhen. Korrupsioni i vogël përfshin akte të tilla si pagimi i tarifave të panevojshme për të vizituar një mjek, për të marrë një vend në një shkollë publike, për të kaluar nëpër një pikë kontrolli, për të marrë promovim profesional ose një transferim nga një lokalitet në tjetrin ose që një gjyqtar të ndryshojë një vendim gjyqësor.⁴⁸ Në dallim nga korrupsioni i madh apo politik, ky mund të jetë më i përhapur, pasi që në të përfshihen më shumë zyrtarë publik. Dëmet e tij mund të jenë shumë të mëdha sidomos nëse në shtet ekziston edhe korrupsioni politik. Atëherë nga politik bërësit nuk do të ekzistojë vullneti për luftimin e kësaj dukurie, duke qenë se edhe ata vet janë të përfshirë në korrupsion. Reformat legjislative dhe institucionale nuk përkrahen nga udhëheqësit dhe si rrjedhojë e kësaj kemi korrupsion serial në të gjitha sferat e jetës publike në vend.

1.5. Shkaqet dhe faktorët e korrupsionit

Studiuesit Mungiu Pippidi⁴⁹ thekson se “të gjitha shtetet kanë filluar të jenë në pronësi të disa individëve që kontrollojnë të gjitha burimet”, dhe rrjedhimisht, “veçanërisht është një

⁴⁷ Cituar nga Matthew Murray and Andrew Spalding: “Freedom from Official Corruption as a Human Right”, Janar, 2015, linku: <file:///C:/Users/Lenovo/Downloads/Freedom%20from%20Official%20Corruption%20as%20a%20Human%20Right.pdf>

⁴⁸ Bertuelle Y. Akeomoa, Types and Impact of corruption. 4 December 2017. <https://www.minpostel.gov.cm/index.php/fr/cellule-anti-corruption/296-types-and-impact-of-corruption>.

⁴⁹ Mungiu-Pippidi, A. (2016). Corruption as social order. Background paper for the 2017 World Development Report. Washington, DC: World Bank.



prirje e natyrshme – njerëzit priren të favorizojnë të tyret”. “Ndarja publike-private në çështjet publike dhe autonomia e plotë e shtetit nga interesi privat janë përjashtime në botën e sotme, të vështira për t’u arritur dhe të vështira për t’u mbajtur”. Me fjalë të tjera, korrupsioni është i vjetër, i rrënjosur, kompleks dhe elastik. Prandaj, përderisa njerëzit nuk kthehen në engjëj, korrupsioni nuk do të çrrënjoset së shpejti.⁵⁰

Korrupsioni është një krim me *shifra të zeza* (pjesë e numrit të errët të kriminalitetit) mjaft të larta. Zakonisht, korrupsioni është i njohur vetëm nga korruptuesit, sekserët, apo ndërmjetësit dhe të korruptuarit, të cilët kanë të gjithë një përkim interesash për të ruajtur heshtjen. Pra, ai nuk ndodh para dëshmitarëve (atyre që nuk janë të inkriminuar në veprimin korruptiv). Ai është një veprim me dëm të shpërndarë, d.m.th., nuk ka një individ fizik që e percepton menjëherë dëmin e pësuar dhe që mund të reagojë dhe të kallëzojë menjëherë: është diçka që dëmton shumë, por në një mënyrë të tillë që askush nuk e percepton drejtpërdrejtë se ka mbetur viktimë.⁵¹

Të njëjtat justifikime dhe justifikime për ryshfet dhe korrupsion, si krimet e tjera të jakës së bardhë, dëgjohen herë pas here: "të gjithë e bëjnë këtë", "është një kosto e të bërit biznes", "nuk ka shumë rëndësi", "askush nuk lëndohet". Kjo nuk është e vërtetë. Korrupsioni i zyrtarëve dhe vendimmarrësve publikë apo privatë dhe pagesa e ryshfeteve ngrenë shqetësime serioze morale dhe politike. Këto nuk janë krime pa viktima, dhe në fakt kanë një kosto të rëndë ekonomike dhe sociale. Ryshfeti dhe korrupsioni krijojnë një fushë të pabarabartë loje për bizneset e ndershme dhe prekin thellë strukturën sociale të vendeve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim. Ato mund të përkthehen në produkte inferiore dhe të rrezikshme të lejuara në treg, materiale ndërtimi nën standarde të përdorura në projekte infrastrukturore që mund të rrezikojnë shëndetin dhe mirëqenien e njerëzve dhe devijimin e parave jetike të nevojshme për arsimin, shëndetin dhe shërbimet e mirëqenies. Në fund të gjithë e paguajmë faturën.⁵²

Shkaqet që ndikojnë në paraqitjen e korrupsionit mund të kategorizohen në disa grupe:

a.) Shkaqet e natyrës politike;

⁵⁰ Fisman, R. and Golden, M. (2017). Corruption: What everyone needs to know. Oxford University Press. Fq. 233.

⁵¹ Piercamillo Davigo. Sistemi i Korrupsionit. Botimet Toena, Tiranë, 2017. F. 47-48

⁵² OECD (2013), “What are bribery and corruption?”, in Bribery and Corruption Awareness Handbook for Tax Examiners and Tax Auditors, OECD Publishing, Paris. F. 9



- b.) Shkaqet e natyrës juridike dhe institucionale;
- c.) Shkaqet e natyrës ekonomike;

A.) Shkaqet e natyrës politike

Në rastet më të shpeshta, ndonëse ndaj korrupsionit nuk janë immune as shtetet e zhvilluara dhe me demokraci të konsoliduar, ky fenomen ka të bëjë me rrethanat politike dhe ekonomike të vendit. Kur përmenden shkaqet politike që ndikojnë në rritjen e korrupsionit mendohet në disa faktor politik, siç janë: mungesa e stabilitetit politik; mungesa e demokracisë së konsoliduar; ekzistimi i procedurave burokratike për marrjen e lejeve të ndryshme dhe kryerja e punëve në administratë publike (ligje restriktive dhe rregullore); niveli i ulët i pagave të zyrtarëve publik.

Fenomeni i korrupsionit ndikohet fuqishëm nga stabiliteti politik dhe niveli i demokracisë në vend. “Stabiliteti politik mund të përkufizohet si një sistem politik i largët ndaj dhunës, forcës brutale, detyrimit dhe destruktivitetit; mungesa e ndonjë përçarjeje në procesin politik dhe, në një shprehje më të përgjithshme, prania e një strukture politike efikase dhe të fuqishme”⁵³. Nëse stabiliteti politik është i pranishëm në një vend vlerësohet me sasinë e dhunës dhe incidenteve terroriste si demonstratat antiqeveritare, vrasjet dhe ekzekutimet politike, krizat e mëdha qeveritare, grushtet e shtetit, revolucionet, kryengritjet sociale, trazirat politike, vdekjet e dhunshme dhe lëvizjet separatiste.⁵⁴ Në një vend ku mungon stabiliteti politik dhe institucional, ku ndryshime të shpeshta politike dhe kriza qeveritare, është e pritshme të ketë korrupsion. Në këso raste, politikanët të pa sigurt për pozitat e tyre i rreken korrupsionit me qëllim të arritjes së përfitimeve të mëdha pasi që janë të vetëdijshëm se mund mos të qëndrojnë gjatë në pozitat e tyre. E thënë thjesht “*duan të pasurohen para se të rrezohen apo t’i rrezojnë nga pushteti*”. Kjo saktësisht ndodh në vendet e Ballkanit Perëndimor, ku krizat politike janë të shpeshta dhe ku partitë politike përdorin edhe dhunën për të arritur në pushtet. Nga këto parti politike nuk pritet luftimi i korrupsionit apo dukurive tjera kriminale. Mos luftimi i korrupsionit ju sjell dobi pasurore. Këto shtete përballën me qeverisje të keqe, jo

⁵³ Caniklioğlu, D. Meltem (1999), “Seçim Sistemlerinin Siyasi İstikrarın Sağlanmasındaki Rolü”, Anayasa Yargısı Dergisi, No. 16, s. 17-44

⁵⁴ Abdiweli, M. Ali (2001), “Political Instability, Policy Uncertainty and Economic Growth: An Empirical Investigation”, Atlantic Economic Journal, Vol. 29, No. 1, fq. 88



transparencë dhe llogaridhënie, pa përgjegjësi ndaj pozitës dhe autoritetit që kanë marrë, e deri tek niveli i ulët i vetëdijes shtet-formuese. Austin (2019), thekson “Duket se për shumicën e sunduesve që nga 1989-a paraaja është ajo që ka më së shumti rëndësi, ngase korrupsioni është pjesa më transparente e Ballkanit. Njerëzit në pushtet kanë mbledhur pasuri të mëdha. Kanë shkelur mbi popullatat që kanë kaluar nëpër tranzicion që 25 vite dhe i kanë shkatërruar ata që ua kanë sfiduar pushtetin”⁵⁵. Kjo argumentohet edhe me raportin vjetor të Transparency International, i cili raport i rendit vendet e Ballkanit Perëndimor shumë keq për nivelin e korrupsionit. Sipas Indeksit të perceptimit të korrupsionit për vitin 2021, Mali i Zi renditet më së mirë, përkatësisht në vendin e 64-të, ndërsa Republika e Kosovës dhe e Maqedonisë Veriore renditen në vendin e 87-të, Serbia në vendin e 96-të, dhe në fund fare Shqipëria dhe Bosnja e Hercegovina në vendin e 110.⁵⁶

Në lidhje me vendet e konsoliduar demokratike “mund të shprehemi se demokracia redukton korrupsionin duke ulur përfitimet private dhe duke rritur kostot e parashikuara (sanksionet ligjore dhe humbjen e reputacionit). Ndërkohë, në të vërtetë ekziston një mjedis më i përshtatshëm për korrupsion në shoqëritë jodemokratike pasi administrata e tyre publike funksionon nën një mekanizëm të dobët kontrolli.”⁵⁷

Megjithatë, ka edhe studime që pohojnë se efekti i demokracisë mbi korrupsionin ndryshon sipas të ardhurave, zhvillimit demokratik dhe niveleve të lirisë ekonomike në një vend. Për shembull, Jetter dhe të tjerë (2015), hulumtoi se demokracia ul korrupsionin në vendet ku të ardhurat për frymë janë 2000 dollarë ose më të larta, ndërsa në vendet e varfra ku të ardhurat për banori është më pak se 2000 dollarë, demokracia në fakt rrit korrupsionin. Triesman (2000) i cili hulumtoi arsyet e korrupsionit nëpërmjet analizës së të dhënave të kryqëzuara shprehu se korrupsioni shihet më rrallë në vendet me një histori të gjatë demokratike pasi probabiliteti që korrupsioni të zbulohet dhe të ndëshkohet është më i lartë në to.⁵⁸

⁵⁵ Robert C. Austin. Bërja dhe Ribërja e Ballkanit – Kombet dhe dhe shtetet që nga 1987-a. University of Toronto Press, për botimin në shqip Koha, 2021. F. 303

⁵⁶ Transparency International. Corruption perceptions index 2021. I qasshëm në linkun: https://www.transparency.org/en/cpi/2021?gclid=CjwKCAjwwb6lBhBJEiwAbuVUSo7h0yEr4iAnBu6P7BO8rkCXG3dmTtSpflek1cfwmf08g4mQOfzWRoCDr8QAvD_BwE.

⁵⁷ Rose-Ackerman, S. (1999b), “Political Corruption and Democracy”, Journal of International Law, Vol. 14, No. 2, s. 363-378.

⁵⁸ Salih Türedi dhe Ali Altiner. Economic and political factors affecting corruption in developing countries. IJER - JAN - FEB 2016. Available online@www.ijeronline.com. Fq.107



Një hapësirë e përshtatshme për rritjen e një sistemi tërësisht të korruptuar do të shfaqet në një vend nëse ai plotëson tre kushtet e mëposhtme:

- Ajo ka një numër të madh ligjesh, rregullash, rregulloresh dhe urdhrash administrativë për të kufizuar biznesin dhe aktivitetet ekonomike dhe në këtë mënyrë krijon mundësi të mëdha për gjenerimin e qirasë ekonomike, dhe veçanërisht nëse këto masa kufizuese janë komplekse dhe të errëta dhe zbatohen në një mënyrë selektive, të fshehtë, jokonsistente dhe në mënyrë jo transparente;
- Administratorëve u jepen kompetenca të mëdha diskrecionale në lidhje me rregullat e interpretimit, u jepet shumë liri për të vendosur se si do të zbatohen rregullat, kujt dhe në çfarë mënyre do të zbatohen, u jepet kompetenca për të ndryshuar, ndryshuar dhe ndryshuar dhe të anulojë rregullat, madje edhe të plotësojë rregullat duke thirrur masa dhe procedura të reja kufizuese administrative; dhe
- Nuk ka mekanizma efektivë dhe rregullime institucionale në vend për t'i mbajtur administratorët përgjegjës për veprimet e tyre.⁵⁹

Korrupsioni ndikohet fuqishëm edhe nga pagat e ulëta të punonjësve të administratës publike (funksionarëve shtetërorë), të cilët për këtë arsye po përpiqen të përmirësojnë gjendjen e tyre financiare duke marrë ryshfet dhe për rrjedhojë edhe gjendja social-ekonomike e qeveritarëve ndikon në fenomenin e korrupsionit.⁶⁰ Është evidente se pagat në sektorin publik në vendet e Ballkanit Perëndimor janë shumë të ulët dhe nuk plotësojnë nevojat minimale të jetesës (jetesë me dinjitet) dhe kjo bën të mundur që shumë zyrtarë publik të përfshihen në afëra korruptive.

Banka Botërore bën dallimin midis korrupsionit administrativ dhe asaj që ajo e quan "kapitalizëm mik" ose "kapje e shtetit". Kërkimet specifike të vendit në vende të tilla si Rusia, Shqipëria, Indonezia dhe Malajzia konfirmojnë rëndësinë e dallimit. Korrupsioni administrativ përfshin përdorimin e ryshfetit dhe favorizimit për të ulur taksat, për t'i shpëtuar rregulloreve dhe për të fituar kontrata prokurimi të nivelit të ulët. "Kapja e shtetit" nënkupton që vetë shteti mund të karakterizohet se i shërben kryesisht interesave të një grupi të ngushtë biznesmenësh

⁵⁹ U Myint, Corruption: Causes, Consequences and Cures. Asia-Pacific Development Journal Vol. 7, No. 2, December 2000. Fq. 39-40

⁶⁰ Štefan Šumah, Corruption, Causes and Consequences, <http://dx.doi.org/10.5772/intechopen.72953>, https://www.researchgate.net/publication/328081475_Corruption_Causes_and_Consequences/fullTextFileContent. Fq. 66



dhe politikanësh, ndonjëherë me elementë kriminalë të përzier. Edhe nëse grupi me ndikim ndryshon kur ndryshon qeveria, shumica e qytetarëve janë lënë jashtë.⁶¹

B.) Shkaqet e natyrës juridike dhe institucionale

Në shkaqet determinuese të korrupsionit të natyrës juridike dhe institucionale, duhet pasur parasysh: parimin e ndarjes së pushtetit; sundimin e së drejtës; legjislacionin; sistemin gjyqësor të pavarur.

Për funksionimin e institucioneve shtetërore është e nevojshme të krijohet një sistem kushtetues dhe e ligjor. Baza e funksionimit të shtetit bazohet në parimet e ndarjes së pushtetit: pushteti legjislativ; ekzekutiv dhe gjyqësor. Secili nga institucionet kryen detyrat dhe përgjegjësitë bazuar në kompetencat kushtetuese dhe ligjore. Në kontekstin e tillë të funksionimit kushtetues – ligjor të institucioneve shtetërore, mund të themi se funksionon shteti i së drejtës (ekziston sundimi i ligjit).

Shteti i së drejtës është një grup parimesh, ose idealesh, për të siguruar funksionimin e një shoqërie të rregullt dhe të drejtë. Shumë vende në mbarë botën përpiqen të mbështesin sundimin e ligjit, ku askush nuk është mbi ligjin, që të gjithë të trajtohen në mënyrë të barabartë sipas ligjit, që të gjithë të mbajnë përgjegjësi për të njëjtat ligje, ku ka procese të qarta dhe të drejta për zbatimin e ligjeve, ku ekziston një sistem gjyqësor i pavarur dhe të drejtat e njeriut janë të garantuara për të gjithë.⁶²

Hapi i parë është kompletimi i bazës ligjore për inkriminim e veprave të veçanta penal dhe për garantimin e pavarësisë institucionale. Në Republikën e Kosovës, por edhe në Shqipëri dhe në Maqedoninë e Veriut janë bërë përparime të shumta në krijimin e një baze ligjore të mirëfilltë në luftimin e korrupsionit. Fatkeqësisht, edhe përkundër kësaj nuk mund të themi se ka përparim në luftimin e kësaj dukurie. Raporti i cituar i Transparency International e dëshmon se niveli i korrupsionit nuk ka rënie në këto vende.

⁶¹ Susan Rose-Ackerman, „The Challenge of Poor Governance and Corruption. Copenhagen Consensus 2004 project. Cambridge University Press, 2004. F.12

⁶² American Bar Association. What is the Rule of Law? I qasshëm në linkun:
https://www.americanbar.org/groups/public_education/resources/rule-of-law/



Në këtë kontekst, ku kemi legjislacion adekuat, por vazhdon niveli i korrupsionit të jetë me përmasa shqetësuese, fajet duhet kërkuar tek institucionet e zbatimit të ligjit dhe sidomos tek sistemi i drejtësisë.

Një gjyqësor i pavarur është i nevojshëm për të garantuar respektimin e sundimit të ligjit. Pavarësia gjyqësore do të thotë që gjyqtarët nuk i nënshtrohen presionit dhe ndikimit dhe janë të lirë të marrin vendime të paanshme bazuar vetëm në fakte dhe ligje. Një gjykatës i pavarur mund të sigurojë se çështja juaj do të vendoset sipas ligjit dhe fakteve dhe jo një klime politike të ndryshueshme. Gjyqtarët interpretojnë dhe zbatojnë ligjin për çështje të veçanta të paraqitura para tyre kur dy palë nuk pajtohen dhe zgjidhin mosmarrëveshjet midis njerëzve, kompanive dhe njësive të qeverisjes. Shpesh, gjyqësori i kërkohet të mbajë kufizimet ndaj qeverisë. Gjyqësori mbron nga abuzimet nga degët e tjera të pushtetit. Ajo mbron pakicat e të gjitha llojeve nga shumica dhe mbron të drejtat e njerëzve që nuk mund të mbrojnë veten e tyre.⁶³

Në një shtet ku ekzistojnë ligje, por institucionet kompetente nuk i zbatojnë në mënyrën e duhur apo ja në nivelin e pritur konform detyrave dhe përgjegjësi të tyre, atëherë nuk mund të ketë luftë efikase kundër korrupsionit.

C.) Faktorët e natyrës ekonomike

Kur analizohen faktorët ekonomik që ndikojnë në përhapjen e korrupsionit duhet të merren parasysh: të ardhurat kombëtare (të ardhurat për kokë banori); liria ekonomike që ekziston në vend; rregullimi i tepruar i ekonomisë me procedura burokratike dhe rregulla të shumta (sidomos kur zyrtarët kanë të drejtë diskrecionale të vendosin për çështje të caktuara).

Kur shihet se korrupsioni është një nga karakteristikat kryesore të vendeve me të ardhura të ulëta dhe të mesme dhe për rrjedhojë vërehet më shpesh në to, do të kuptohet se ekziston një lidhje e ngushtë midis korrupsionit dhe rritjes ekonomike. Niveli i ulët i të ardhurave mund të shkaktojë korrupsion duke prishur etikën e punës së individëve ose organizatave pasi një rritje e të ardhurave e siguruar në mënyrë të paligjshme mund të ketë një ndikim të rëndësishëm në kushtet e jetesës së individëve. Në vendet në zhvillim ku vlera marxhinale e parasë është më e lartë në krahasim me vendet e pasura, një kusht thelbësor për të ulur nivelin e korrupsionit është

⁶³ American Bar Association. Rule of Law and the Courts? I qasshëm në linkun:
https://www.americanbar.org/groups/public_education/resources/rule-of-law/rule-of-law-and-the-courts/.



kryerja e ndryshimeve strukturore që kanë cilësi për të rritur nivelin e të ardhurave. Në këtë kontekst mund të thuhet se rritja ekonomike rrit pagat, pra jetesën dhe standardet e punonjësve; që rezulton në uljen e përpjekjeve të tyre për të siguruar të ardhura shtesë përmes rrugëve të paligjshme.⁶⁴

Një tjetër faktor ekonomik i cili merret në konsideratë në studimet për shkaqet e korrupsionit është liria ekonomike. Liria ekonomike, mund të përkufizohet: “çdo individ të zotërojë të drejtën për të kontrolluar dhe zgjedhur punën dhe pronën e tij dhe lirinë për të konkurruar; pa asnjë ndërhyrje të shtetit.”⁶⁵

Sa më shumë të jetë i rregulluar dhe kufizuar aktiviteti ekonomik në vend, aq më i lartë është autoriteti dhe fuqia e zyrtarëve në vendimmarrje dhe aq më e madhe është mundësia e korrupsionit, pasi individët janë të gatshëm të paguajnë ose ofrojnë pagesë për të shmangur kufizimet. Një potencial i madh për korrupsion është veçanërisht aty ku zyrtarëve u jepet mundësia nga rregullat e brendshme të vendosin në bazë të diskrecionit.⁶⁶

Në lidhje me korrupsionin në fund të fundit duhet pasur parasysh:

- ✚ Korrupsioni në forma të ndryshme reflektohet në të gjithë shoqërinë, ai prek përfaqësimin politik, qeverisjen e përgjithshme si dhe jetën kulturore e sportive.
- ✚ Një sjellje korruptive ka për qëllim marrjen e një privilegji të caktuar për vetë personin, familjen, të afërmit ose miqtë e tij në dëm të pjesës tjetër të shoqërisë.
- ✚ Nga pikëpamja sociologjike, korrupsioni mund të karakterizohet si një marrëdhënie shoqërore e të paktën dy subjekteve që bashkëpunojnë në shkëmbimin e mallrave.
- ✚ Më shpesh, arsyeja e korrupsionit është përfitimi financiar, megjithëse mund të jetë edhe përfitim tjetër material ose jomaterial, si kapitali politik ose privilegje ose shërbime të tjera.
- ✚ Një ryshfet nuk ka nevojë të kërkohet në mënyrë eksplicite, ndodhja e tij mund të kushtëzohet nga një praktikë predikative korruptive në klimën ekzistuese të korrupsionit në shoqëri.⁶⁷

⁶⁴ Paldam, M. (2002), “The Cross-Country Pattern of Corruption: Economics, Culture and The Seesaw Dynamics”, European Journal of Political Economy, Vol. 18, No. 2, f. 220

⁶⁵ Salih Türedi dhe Ali Altiner. Vepra e cituar. Fq. 105

⁶⁶ Štefan Šumah, vepra e cituar, fq. 66

⁶⁷ Factors affecting corruption. <https://www.minv.sk/?survey&okruh=2&tema=10>.



Kapitulli i dytë

2. INSTRUMENTET NDËRKOMBËTARE KUNDËR KORRUPSIONIT

Duke e ditur dëmin që shkakton korrupsioni dhe çdo formë tjetër e keqpërdorimit të pushtetit nga zyrtarët publik, edhe në nivel ndërkombëtar janë miratuar instrumentet juridike për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. Instrumentet e tilla janë të karakterit global dhe rajonal. Në nivel global është Konventa e miratuar nga Kombet e Bashkuara, ndërsa në nivel rajonal, janë konventat e miratuara nga Këshilli i Evropës, OECD dhe BE. E një rëndësie të madhe është edhe Konventa Inter – Amerikane kundër korrupsionit e nënshkruar me 29 mars 1996. Konventa është nënshkruar edhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës (02.06.1996).

Tabela 1. Konventat ndërkombëtare kundër korrupsionit:

Nr.	Konventa	Institucioni dhe data e miratimit
1.	Konventa e Kombeve të bashkuara kundër korrupsionit	United Nation, New York 2004
2.	Konventa e të drejtës penale kundër korrupsionit	Council of Europe, ETS 173 - Strasbourg 27. I.1999
3	Konventa penale kundër korrupsionit (Protocol)	Council of Europe ETS No. 191 – Strasbourg 15.V.2003
4.	Konventa e së Drejtës Civile për Korrupsionin	Council of Europe, ETS No. 174 - Strasbourg 4.XI.1999
5.	Konventa për luftimin e ryshfetit të zyrtarëve të huaj publik në transaksionet e biznesit ndërkombëtar	Organisation for Economic Cooperation and Development (OECD) 21.11.1997
6.	Konventa për luftën kundër korrupsionit që përfshin zyrtarë të Komuniteteve Evropiane ose zyrtarë të Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian	Council of the European Union, Council Act of 26 May 1997



2.1. Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit

Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, është instrumenti i parë në nivel global që adreson në mënyrë gjithëpërfshirëse luftimin e korrupsionit. Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në rezolutën 55/61, të 4 dhjetorit 2000, bëri të ditur që një instrument i efektshëm ligjor ndërkombëtar kundër korrupsionit, i pavarur nga Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (rezoluta 55/25) ishte i dëshirueshëm dhe krijoi një komitet ad hoc për negocimin e një instrumenti të tillë në Vjenë në selinë e Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin⁶⁸. Konventa u miratua nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, me 31 tetor 2003, me rezolutën 58/4. Konventa hyrë në fuqi me 14 dhjetor 2005. Është e rëndësishme të thuhet se, “qasja e gjerë e Konventës dhe karakteri i detyrueshëm i shumë prej dispozitave të saj e bëjnë atë një mjet unik për zhvillimin e një përgjigje gjithëpërfshirëse ndaj një problemi global”⁶⁹

Kjo Konventë është gjithëpërfshirëse dhe karakteristikë e saj është se nuk është e kufizuar vetëm në kriminalizimin e sjelljeve të caktuara, por ka për qëllim të rregullojë edhe aspektet e parandalimit – preventivës kundër korrupsionit me theks të veçantë: bashkëpunimin ndërkombëtar, konfiskimin e dobisë pasurore dhe kthimin e saj në shtetin të cilit i përket.⁷⁰

Qëllimi i Konventës është i spikatur në nenin e parë të saj, ku është paraparë se, “qëllimet e kësaj Konvente janë:

- a) nxitja dhe forcimi i masave për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit më me efikasitet dhe efektivitet;
- b) nxitja, lehtësimi dhe mbështetja e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe asistencës teknike në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, duke përfshirë rimarrjen e pasurisë;
- c) nxitja e integritetit, përgjegjësisë dhe administrimi i rregullt i çështjeve publike dhe pasurisë publike”⁷¹.

⁶⁸ Compendium of International Legal Instruments on Corruption, Vienna, November, 2003. Fq.11

⁶⁹ <https://www.unodc.org/unodc/en/corruption/uncac.html>

⁷⁰ Mehdi J. Hetemi & Nexhat Jashari. Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit me komentim. Shtëpia botuese “Libri Shkollor”, Prishtinë, 2013, fq. 13

⁷¹ Neni 1 i Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit, miratuar në New York, 2004



Konventa përfshinë pesë pika apo fusha kryesore: Dispozitat e përgjithshme (kapitulli I); masat parandaluese (Kapitulli II), penalizimi dhe përmbarimi (kapitulli III), bashkëpunimi ndërkombëtar (kapitulli IV), rikuperimi i aseteve (kapitulli V); asistencë teknike dhe shkëmbimi i informacionit (kapitulli VI); mekanizmat e zbatimit (kapitulli VII) dhe dispozitat e fundit (kapitulli i VIII). “Shtetet, duke u bërë palë të Konventës, shprehin vullnetin dhe dëshirën e tyre për t’i rezistuar korrupsionit, por efektet pozitive të një veprimtarie të tillë humbin shpejt, nëse qeveritë nuk e marrin seriozisht përmbushjen e detyrimeve të konventës.

Konventa kërkon nga qeveritë e vendeve që ata të bashkohen për të arritur të paktën objektivat me sa vijon:

- Miratimi i politikave dhe praktikave parandaluese anti-korrupsion;
- Themelimi dhe funksionimi i organit ose organeve parandaluese anti-korrupsion;
- Vendosja dhe zbatimi i kodeve të sjelljes për zyrtarët publikë;
- Vendosja dhe funksionimi i sistemeve të përshtatshme të prokurimit publik dhe menaxhimit të financave publike bazuar në transparencën, konkurrencën dhe kriteret objektive;
- Krijimi i mekanizmave të raportimit publik; dhe
- Promovoni pjesëmarrjen aktive të shoqërisë në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit”⁷².

Duke u bazuar në neni 5 të Konventës, shteti që është palë, duhet të vendosë kontekstin dhe kornizën e përgjithshme për të parandaluar korrupsionin, siç kërkohet nga Konventa, duke zhvilluar dhe zbatuar një strategji gjithëpërfshirëse anti-korrupsion. Kjo do të arrihet përmes promovimit të parimeve të shtetit të së drejtës, menaxhimit të duhur të çështjeve publike dhe pronës publike, integritetit, transparencës dhe llogaridhënies. Më tej, secilit shtet palë i kërkohet të përpiqet të rishikojë dispozitat përkatëse institucionale, ligjore dhe procedurale për të forcuar një strategji koherente dhe të koordinuar anti-korrupsion. Duke bërë këtë, është e këshillueshme që planifikimi dhe zbatimi i strategjisë të përfitojë nga pjesëmarrja e një game të gjerë palësh të interesuara, përfshirë organizatat e shoqërisë civile dhe sektorin privat. Shteti Palë duhet të punojë me shtetet tjera për të ndarë praktikatat e mira

⁷² Aram Khaghaghordyan, International Anti-corruption Normative Framework: the State of the Art Hertie School of Governance Friedrichstraße 180 10117 Berlin, Germany, fq.11



dhe për të përpunuar rregullimet rajonale dhe ndërkombëtare për të lehtësuar bashkëpunimin dhe mbështetjen e ndërsjellë⁷³.

Për këtë Konventë, mund të thuhet se nuk është ekskluzivisht e natyrës së drejtës ndëshkimore (penale), pasi që kjo dallon nga disa instrumente tjera të kësaj natyre (Konventa Penale Kundër Korrupsionit), po ashtu ajo nuk kufizohet në lëmenjtë të caktuar siç është Konventa e Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), e cila inkriminon mitosjen – dhënien e ryshfetit në transaksionet afariste ndërkombëtare.⁷⁴

2.2. Konventa Penale kundër korrupsionit

Në vitin 1998, Këshilli i Evropës miratoi Konventën e së Drejtës Penale për Korrupsionin (hyri në fuqi më 1 korrik 2002) dhe në 1999 Konventën e së Drejtës Civile për Korrupsionin (hyri në fuqi më 1 nëntor 2003), e cila ishte përpjekja e parë për të përcaktuar rregullat e përbashkëta ndërkombëtare në fushën e së drejtës civile dhe korrupsionit, d.m.th., padi civile për marrjen e dëmshpërblimit mund të inicohet nga persona që kanë pësuar dëme si pasojë e korrupsionit. Në vitin 2003 u miratua një Protokoll Shtesë për Konventën e së Drejtës Penale, i cili zgjeroi fushën e Konventës për të Drejtën Penale tek arbitrat në çështje tregtare, civile dhe çështje të tjera, si dhe juristët.⁷⁵ Përpjekjet e Këshillit të Evropës për të parandaluar dhe ndëshkuar korrupsionin rrjedhin nga mandati i tij për të lehtësuar bashkëpunimin ndërkombëtar në çështjet penale përmes harmonizimit të ligjit penal penal.

Kjo Konventë ka një fushëveprim mjaft të gjerë dhe “është një instrument që synon kriminalizimin e koordinuar të një numri të madh të praktikave korruptive: i) mitmarrja aktive dhe pasive e zyrtarëve publikë vendas dhe të huaj; ii) ryshfet aktive dhe pasive të parlamentarëve vendas dhe të huaj dhe të anëtarëve të asambleve parlamentare ndërkombëtare; iii) ryshfet aktiv dhe pasiv në sektorin privat; iv) ryshfet aktiv dhe pasiv i zyrtarëve të

⁷³ Technical Guide to the United Nations Convention Against Corruption, United Nations Office on Drugs and Crime Vienna, United Nations, New York, 2009, Fq. 3

⁷⁴ Mehdi J. Hetemi & Nexhat Jashari. Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit me komentim. Shtëpia botuese “Libri Shkollor”, Prishtinë, 2013, fq. 13

⁷⁵ Aram Khaghaghordyan, International Anti-corruption Normative Framework: the State of the Art Hertie School of Governance Friedrichstraße 180 10117 Berlin, Germany, fq. 9



organizatave ndërkombëtare; v) mitmarrja aktive dhe pasive e gjyqtarëve dhe zyrtarëve vendas, të huaj dhe ndërkombëtarë të gjykatave ndërkombëtare; vi) tregtia aktive dhe pasive e ndikimit; vii) pastrimi i parave nga të ardhurat nga veprat e korrupsionit; dhe viii) veprat kontabël (faturat, dokumentet e kontabilitetit, etj.) të lidhura me veprat penale të korrupsionit”⁷⁶.

Konventa imponon obligime të shumta për shtetet që janë palë të saj, në ‘rezistencë’ ndajë korrupsionit, në këtë drejtim Konventa u kërkon shteteve të “parashikojnë sanksione dhe masa efektive, proporcionale dhe dekurajuese, duke përfshirë, kur kryhen nga persona fizikë, ndëshkime që përfshijnë heqjen e lirisë që mund të çojnë në ekstradim. Personat juridikë gjithashtu do të jenë përgjegjës për veprat penale të ryshfetit aktiv, ndikimit dhe pastrimit të parave të vendosura në përputhje me Konventën, të kryera për përfitimin e tyre, dhe do t’i nënshtrohen sanksioneve efektive penale ose jo-penale, përfshirë sanksionet monetare. Për më tepër, Konventa përmban dispozita në lidhje me ngritjen e organeve të specializuara anti-korrupsion, mbrojtjen e personave që bashkëpunojnë me autoritetet hetuese ose ndjekëse dhe mbledhjen e provave dhe konfiskimin e të ardhurave”⁷⁷.

Në aspektin e bashkëpunimit ndërkombëtar kundër kriminalitetit, në këtë rast kundër korrupsionit, Konventa “parashikon një bashkëpunim të zgjeruar ndërkombëtar (ndihma e ndërsjellë, ekstradimi dhe sigurimi i informacionit) në hetimin dhe ndjekjen penale të veprave korruptive. Në lidhje me ndihmën e ndërsjellë, parashikon që Palët të krijojnë autoritete qendrore të posaçme të përcaktuara për të trajtuar kërkesat në një mënyrë të shpejtë. Ndërsa ndihma reciproke mund të refuzohet nëse kërkesa minon interesat themelore, sovranitetin kombëtar, sigurinë kombëtare ose rendin publik të Palës së kërkuar, ajo nuk mund të thirret për arsye të sekretit bankar”⁷⁸.

Konventa penale kundër korrupsionit është plotësuar në vitin 2003, kur është miratuar protokolli shtes i konventës. Sipas këtij Protokolli shtrihet fusha e Konventës për arbitrat në çështje tregtare, civile dhe çështje të tjera, si dhe për anëtarët e jurisë, duke plotësuar kështu dispozitat e Konventës që synojnë mbrojtjen e autoriteteve gjyqësore nga korrupsioni. Palët në

⁷⁶ Compendium of International Legal Instruments on Corruption, Vienna, November, 2003. fq.11-12

⁷⁷ Ibid, fq.12

⁷⁸ Po Aty, fq.12



Konventë do të duhet të marrin masat e nevojshme për të vendosur, si vepra penale, rryshfetin aktiv dhe pasiv të arbitrave dhe juristëve vendas dhe të huaj⁷⁹.

2.3. Konventa e të drejtës civile për korrupsionin

Përveç aspektit penal, angazhimi kundër korrupsionit është bërë edhe me ligje civile. Në këtë drejtim Konventa Civile Kundër Korrupsionit është përpjekja e parë për të përcaktuar rregullat e përbashkëta ndërkombëtare në fushën e së drejtës civile dhe korrupsionit. Ne nenin e parë të kësaj konvente parashihet:

“Secila palë pjesëmarrëse duhet të parashikojë në ligjin kombëtar rregullime efektive për personat që dëmtohen si rezultat i veprimeve korruptive, t’u japë atyre mundësi të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre, duke përfshirë dhe mundësinë për t’u kompensuar për dëmin.”⁸⁰

Kjo dispozitë është mjaft e rëndësishme për mbrojtjen e interesave juridike të personave të dëmtuar nga korrupsioni. Duke e ditur se me veprimet korruptive, dëmtohen interesat pasurore të palëve të përfshira në një proces publik, atëherë përveç dënimit penal që duhet të marrin të korruptuarit, kompensimi dhe zhdëmtimi i tyre duhet të jetë pjesë e domosdoshme e legjislacionit vendor.

Ne nenin e 5-të kësaj Konvente është përfshirë përgjegjësia e shtetit për kompensim të personave që kanë pësuar dëm nga veprimet korruptive të zyrtareve publik.

“Secila palë do të parashikojë në ligjin e vet kombëtar procedurat e duhura për personat që janë dëmtuar si pasojë e një veprimi korruptiv nga zyrtarët e tij gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, për të kërkuar kompensim nga shteti ose në rastin e një pale joshitetërore, nga autoritetet zyrtare të palës.”⁸¹

Një prej çështjeve më të rëndësishme të kësaj konventë është paraparë në nenin 8 (vlefshmëria e kontratave).

“Secila palë do të parashikojë në ligjin e vet kombëtar që çdo kontratë ose pjesë kontrate për korrupsion të anulohet dhe të jetë e pavlefshme. Secila palë do të parashikojë në ligjin e vet

⁷⁹ <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/191>

⁸⁰ Konventa e të drejtës civile për Korrupsionin, Council of Europe, ETS No. 174 - Strasbourg 4.XI.1999, neni 1

⁸¹ Ibid, neni 5



kombëtar mundësinë që të gjitha palët në kontratë, leja e të cilëve është shpërdoruar nga një veprim korruptiv, të kenë mundësinë e apelimit në gjykatë për ta shpallur të pavlefshme dhe në kundërshtim me të drejtën e tyre për t'u ankuar për dëmtimet."⁸²

Në kontekst të bashkëpunimit ndërkombëtar edhe kjo Konventë ka përcaktuar se, "palët do të vendosin bashkëpunim efektiv për çështjet që kanë të bëjnë me procedurat civile të çështjeve të korrupsionit, sidomos për shërbimin e dokumenteve, marrjen e provave nga jashtë, juridiksionin, njohjen dhe forcimin e gjykimeve të vendeve të tjera dhe koston e gjykimit në përshtatje me dispozitat përkatëse të instrumenteve ndërkombëtare mbi bashkëpunimin ndërkombëtar në çështjet civile dhe tregtare në të cilën ato janë nënshkruese, si dhe në përputhje me ligjin e tyre të brendshëm"⁸³.

2.4. Konventa për luftimin e ryshfetit të zyrtarëve publik të huaj në transaksionet e biznesit ndërkombëtar

Kjo Konventë është nënshkruar më 17 dhjetor 1997, ndërsa ka hyrë në fuqi më 15 shkurt 1999. Kjo është një konventë anti-korrupsion e OECD që synon uljen e korrupsionit politik dhe krimit të korporatave në vendet në zhvillim, duke inkurajuar sanksione kundër ryshfetit në biznesin ndërkombëtar transaksionet e kryera nga kompanitë e vendosura në vendet anëtare të Konventës. "Konventa për Luftimin e Ryshfetit të Zyrtarëve Publikë të Huaj në Transaksionet Ndërkombëtare të Biznesit (Konventa Kundër Rryshfetit) është instrumenti i parë dhe i vetëm ndërkombëtar anti-korrupsion i përqendruar në "anën e furnizimit" të transaksionit të ryshfetit - personi ose subjekti që ofron, duke premtuar ose dhënia e ryshfetit"⁸⁴. Është me interes të përmendet se, "kjo Konventë merret me atë që, në ligjin e disa vendeve, quhet "korrupsion aktiv" ose "ryshfet aktiv", që do të thotë veprën e kryer nga personi që premtton ose jep ryshfet, në krahasim me "ryshfetin pasiv", vepra e kryer nga zyrtari që merr ryshfet. Konventa nuk përdor termin 'ryshfet aktiv' thjesht për të shmangur keqinterpretimin e

⁸² Ibid, neni 8

⁸³ Ibid neni 13

⁸⁴ <http://www.oecd.org/corruption-integrity/explore/oecd-standards/anti-bribery-convention/>



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

tij nga lexuesi jo-teknik, duke nënkuptuar që ryshfeti ka marrë iniciativën dhe marrësi është një viktimë pasive”⁸⁵.

⁸⁵ Komente mbi Konventën për Luftimin e Ryshfetit të Zyrtarëve Publikë të Huaj në Transaksionet e Biznesit Ndërkombëtar, OECD, fq.11



Kapitulli i tretë

3.0. LEGJISLACIONI NË REPUBLIKËN E KOSOVËS KUNDËR KORRUPSIONIT

Në Kosovë ekziston legjislacion i kompletuar për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. Që nga shpallja e pavarësisë në shkurtin e vitit 2008, institucionet vendore duke ju falënderuar edhe asistencës së organizatave ndërkombëtare të akredituara si OSBE, USAID, dhe ndihmës së misionit të Bashkimit Evropian EULEX, kanë miratuar ligje të standardeve ndërkombëtare për luftimin e korrupsionit. Sfidë e madhe mbetet zbatimi i këtyre ligjeve nga institucionet kompetente.

Tabela nr. 2. Legjislacioni në Republikën e Kosovës kundër korrupsionit

Nr.	Ligji material
1.	Kodi Penal i Republikës së Kosovës_ Kodi Nr. 06/L-074 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 2 / 14 Janar 2019, Prishtinë)
Ligji procedural	
1.	Kodi i Procedurës Penale_ Kodi Nr. 08/L-032 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 24 / 17 Gusht 2022, Prishtinë)
Ligje tjera të rëndësishme për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit	
1.	Ligji për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit_ Ligji Nr.08/L-017 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 19 / 21 Korrik 2022, Prishtinë)
2.	Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik_ Ligji Nr. 06/L-011 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 5 / 27 Prill 2018, Prishtinë)
3.	Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave_ Ligji Nr. 08/L-108 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 21 / 10 Gusht 2022, Prishtinë)

3.1. Kodi Penal i Republikës së Kosovës

Kodi Penal i ri, i cili ka hyrë në fuqi në muajin prill të vitit 2019, krahas disa ndryshimeve dhe plotësimeve tjera, ka paraparë risi në aspektin e luftimit të korrupsionit të zyrtarëve publik në krahasim me Kodin e mëparshëm. Veprat penale të korrupsionit zyrtarë janë të renditura në kapitullin e tridhjetë e tretë (XXXIII) “Korrupsioni Zyrtar dhe Veprat Penale Kundër Detyrës Zyrtare”. Përveç këtyre, Kodi ka inkriminuar edhe dy vepra penale që



kanë të bëjnë me korrupsionin në sektorin privat, ashtu siç kërkohet edhe akte ndërkombëtare. Këto dy vepra penale janë renditur në grupin e veprave penale kundër ekonomisë.

Karakteristikë e përbashkët e veprave penale të tubuara në grupin e veprave të korrupsionit zyrtar është se ato kryhen vetëm me dashje dhe kryhen nga personat zyrtarë. Personat zyrtar me kryerjen e veprave të tilla penale, me vetëdije dhe vullnet veprojnë në mënyrë të kundërligjshme, pra ata e dëshirojnë shkaktimin e pasojës së veprës penale.⁸⁶

Figura e veprës penale të ky grup i veprave penale duhet të përcaktohet saktësisht ashtu siç e ka përkufizuar KPK-ja. Me figurën e veprës penale duhet nënkuptuar tërësinë e elementeve të veprës penale të caktuar, ngase çdo vepër penale i posedon elementet e veta të posaçme që e bëjnë të dallohet nga veprat tjera. Tërësia e elementeve të posaçme sajton figurën e veprës penale të caktuar. Elementet themelore apo të përgjithshme (veprimi i njeriut, kundërligjshmëria, etj.) duhet të shprehen te çdo vepër penale, elementet e posaçme janë tipare apo karakteristikë e veprës penale të caktuar dhe këto shprehen krahas elementeve të përgjithshme. Figura e veprës penale sajohet duke përcaktuar elementet e posaçme veç e veç dhe duke bërë sintetizimin dhe përgjithësimin e tyre në dispozitën e caktuar penalo juridike.⁸⁷

Tek ky grup i veprave penale duhet veçuar elementet të cilat e përbëjnë figurën e veprës penale. Në këtë kontekst duhet veçuar elementet e përgjithshme dhe ato të veçanta. Në grupin e elementeve të përgjithshme bëjnë pjesë 1.) Kundërligjshmëria; 2.) veprimi i subjektit (veprimi i kundërligjshëm në dhe gjatë ushtrimit të funksionit publik nga zyrtarët publik); 3.) vepra e tillë është përcaktuar si vepër penale me KPK; 4.) fajësia (vepra penale e korrupsionit zyrtar kryhet vetëm me dashje). Ndërsa në grupin e elementeve të veçanta të këtyre veprave penale bëjnë pjesë: 1.) keqpërdorimi i pozitës apo detyrës zyrtare; 2.) veprimi i kryerjes së veprës penale shkaktohet nga personi zyrtar (subjekti i cili ushtron autorizime shtetërore apo publike); 3.) objekti i mbrojtur me inkriminimin nga KPK-ja si vepër penale (pasuria, të drejtat dhe liritë individuale; keqpërdorimi i besimit në ushtrimin e funksionit zyrtar); 4.) integriteti në ushtrimin e pushtetit publik; 5.) përfitimi për vete apo për tjerët i personit zyrtar; 6.) t'i shkaktojë dëm personit tjetër ose që seriozisht t'i shkel të drejtat e personit tjetër; 7.) përfitimi i shërbimit apo punës nga subjekti aktiv pa meritë apo pa i plotësuar kushtet.

⁸⁶ Ismet Salihu, E Drejta Penale – Pjesa e posaçme. Universiteti i Prishtinës, Fakultetit Juridik, Prishtinë, 2021, fq.656

⁸⁷ Instituti Gjyqësor i Kosovës, Kodi Penal i Republikës së Kosovës. Prishtinë, 2016, fq. 14-15



Në teorinë dhe praktikën e të drejtës penale, në përcaktimin e elementeve përbërëse për një krim janë të domosdoshme: *actus reus* dhe *mens rea*.

“*Actus reus*: është elementi sjelljes kundrejt veprës penale. *Actus reus*-i përshkruan atë që duhet të provohet se e ka kryer, ose, në disa raste, nuk e ka kryer i pandehuri; në çfarë rrethanash dhe me çfarë pasojash, në mënyrë që ai të jetë përgjegjës për një krim. *Mens rea*: është elementi mendor i veprës penale. Mund të jetë për shembull, qëllimi, pakujdesia ose neglizhenca e të pandehurit.”⁸⁸

Element i përbashkët i këtij grupi të veprave penale është dashja si element subjekti i kryerjes. Dashja sipas KPRK-së, është element i rëndësishëm i përgjegjësisë penale. Neni 17, paragrafi i parë i KPRK-së, parasheh:

“*Kryesi i veprës penale është penalisht përgjegjës nëse është mendërisht i aftë dhe veprën penale e ka kryer me dashje apo nga pakujdesia.*”⁸⁹

Të gjitha veprat e parapara me kapitullin e veprave penale kundër detyrës zyrtare kryhen me dashje, përveç veprës penale të paraparë me në nenin 426 Zbulimi i fshehtësisë zyrtare, ku Kodi parasheh në mënyrë decidive që kryesi do të dënohet edhe kur vepra e tillë është kryer nga pakujdesia.

Pra, dashja është element substancial i kryerjes së kësaj vepre penale. Dashja paraqet formën bazë të fajit së bashku me pakujdesinë. Dashja paraqet raportin psikik të kryesit ndaj veprës. Ky raport shprehet në vetëdijen dhe vullnetin e kryesit. Dashja ekziston kur kryesi ka pasur parasysh pasojat, ka qenë i vetëdijshëm që me veprimet e veta mund të shkaktoi pasojën, pa marrë parasysh nëse e ka dashur apo jo një pasojë të tillë. Tek keqpërdorimi i detyrës zyrtare për ekzistimin e kësaj vepre përpos dashjes nevojitet edhe qëllimi i kryesit që përmes kryerjes së kësaj vepre të përfitohet diçka apo të shkaktohet dëm i caktuar. Kryesi i veprës penale nuk kryen vepra vetëm për të kryer vepër por që përmes kryerjes së asaj vepre të arrijë edhe një qëllim tjetër si arsye për kryerje të veprës.⁹⁰ Ekzistojnë dy lloje të dashjes: dashja direkte dhe dashja indirekte. Elemente të përbashkëta të dashjes direkte dhe eventuale janë vetëdija për veprën dhe vullneti për kryerjen e saj. Të dashja direkte e përcaktuar si dëshirë për kryerjen e

⁸⁸ Jonathan Herring, E Drejta Penale – Teori, kazuse dhe materiale. UET Press, Tiranë, 2013. Fq. 70

⁸⁹ Kodi Penal i Republikës së Kosovës_ Kodi Nr. 06/L-074, neni 17

⁹⁰ Gjykata Supreme e Kosovës, Udhëzues i veçantë - Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, Prishtinë, qershor 2021. Fq.10



veprës, kurse të dashja eventuale si pajtim me pasojën e saj. Në bazë atyre elementeve, dashja përcaktohet si kryerje e vetëdijshme dhe e dëshirueshme e veprës penale.⁹¹

Në këtë pjesë do të ndalemi në analizën shkencore të elementeve të posaçme të cilat e përbëjnë figurën e veprës penale të korrupsionit zyrtar dhe veprës penale kundër detyrës zyrtare.

- 1.) Keqpërdorimi i pozitës apo detyrës zyrtare – në këtë rast personi zyrtar duke ushtruar funksionet e veta të përcaktuara me legjislacion ose ndonjë akt tjetër juridik, bën veprim me të cilin bjen ndesh me autorizimet dhe kompetencat e përcaktuara. Veprimi i subjektit është në kundërshtim me ligjin dhe ka të bëj me ushtrimin e kompetencave të tij. Duke ushtruar funksionet e tij në mënyrë të kundërligjshme, personi zyrtar bën keqpërdorim të detyrës zyrtare.
- 2.) Veprimi i kryerjes së veprës penale shkaktohet nga personi zyrtar (subjekti i cili ushtron autorizime shtetërore apo publike). E domosdoshme për tu përmbushur figura e kësaj vepre penale është që veprimin e kundërligjshëm gjatë ushtrimit të funksionit ta bëjë personi i cili ka cilësinë e zyrtarit publik. Pra, personi publik i veshur me prerogativa të pushtetit shtetëror-publik, apo që ushtron ndonjë funksion publik (shërbim publik), persona që vendosin për të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve. D.m.th., njëri subjekt tek këto vepra penale duhet të jetë person zyrtar. Ky element është esencial, pasi që veprat penale të përcaktuara me kapitullin XXXIII të KPK-së, mund të kryhen vetëm nga personat zyrtarë, gjatë apo në ushtrimin e funksionit të tyre të përcaktuar me akt juridik.
- 3.) Objekti i mbrojtur me inkriminimin nga KPK-ja si vepër penale. Objekti i mbrojtur me këtë grup të veprave penal, marrë në përgjithësi janë: pasuria, të drejtat dhe liritë individuale; keqpërdorimi i besimit në ushtrimin e funksionit zyrtar, etj.
- 4.) Integriteti në ushtrimin e pushtetit publik. Me këtë grup të veprave penale, nga ligjdhënësi synohet karakteri preventiv special për zyrtarët publik në radhë të parë. Përcaktimi me KPK-në si vepër penale e veçantë i Korrupsionit zyrtar, ndikon në integritetin e ofrimit të shërbimeve nga zyrtarët publik. KPK-ja synon të vetë-

⁹¹ Vllado Kambovski & Ismail Zejneli. E Drejta Penale – pjesa e përgjithshme. Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë, 2018, fq. 138



dijesojë bartësit e funksioneve publike dhe politik për ushtrimin e ligjshëm të funksioneve publike.

- 5.) Përfitimi për vete apo për tjerët i personit zyrtar. Prej elementeve qenësore në përcaktimin e figurës së kësaj veprë penale është përfitimi material apo ndonjë dobie tjetër për vete apo për person/a tjerë. D.m.th., veprimi i subjektit pasiv – personit zyrtar rezulton me përfitim material ose dobi tjetër.
- 6.) T’i shkaktojë dëm personit tjetër ose që seriozisht t’i shkel të drejtat e personit tjetër. Kjo vepër penale mund të kryhet edhe nëse subjekti duke ushtruar funksionet publike i shkakton dëm personit tjetër në mënyrë të pa drejtë dhe të kundërligjshme. Gjithashtu edhe nëse shkel të drejtat e personit tjetër konsiderohet se është kryer kjo vepër penale e posaçme.
- 7.) Përfitimi i shërbimit apo punës nga subjekti aktiv pa meritë apo pa i plotësuar kushtet. Përfitimi material konsiston në marrjen e dhuratave apo shumave të caktuara të parave apo ndonjë favor tjetër nga subjekti aktiv në mënyrë që të kryhet një shërbim, punë apo punësim pa pasur të drejtë. Pra, kryerja e shërbimeve për personin i cili jep ryshfet apo ndonjë favor tjetër që nëse nuk jep nuk do të kishte mundësi në mënyrë të ligjshme ta fitoi punën ose shërbimin.

Veprat penale kundër detyrës zyrtare janë renditur nga ligjdhënësi në kapitullin e fundit të KPK-së, përkatësisht në kapitullin e XXXIII (nenet 414-430).

Tabela nr. 3: Renditja e veprave penale të korrupsionit zyrtar në Kodin Penal të Republikës së Kosovës

Kodi Penal i Republikës së Kosovës_ Kodi Nr. 06/L-074		
KAPITULLI XXXIII		
KORRUPSIONI ZYRTAR DHE VEPRAT PENALE KUNDËR DETYRËS ZYRTARE		
Nr.	Neni	Vepra penale
1.	414	Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar
2.	415	Keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik
3.	416	Keqpërdorimi i informatës zyrtare
4.	417	Konflikti i interesit
5.	418	Përvetësimi në detyrë
6.	419	Mashtrimi në detyrë



7.	420	Përdorimi i paaautorizuar i pasurisë
8.	421	Marrja e ryshfetit
9.	422	Dhënia e ryshfetit
10.	423	Dhënia e ryshfetit zyrtarit publik të huaj apo personave të huaj zyrtar
11.	424	Ushtrimi i ndikimit
12.	425	Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore
13.	426	Zbulimi i fshehtësisë zyrtare
14.	427	Falsifikimi i dokumentit zyrtar
15.	428	Arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme
16.	429	Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor
17.	430	Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare
KAPITULLI XXV		
VEPRAT PENALE KUNDËR EKONOMISË		
1.	Neni 309	Pranimi i ryshfetit në sektorin privat
2.	Neni 310	Dhënia e ryshfetit në sektorin privat

3.1.1. Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar

Kjo vepër penale është paraparë si e para në këtë grup të veprave penale. Vepra përcaktohet në neni 414 të KPK-së.

“1. Personi zyrtar, i cili duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që t’i shkaktojë dëm personit tjetër ose që t’i shkel të drejtat e personit tjetër, dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

2. Personi zyrtar që e kryen veprën penale nga paragrafi 1 i këtij neni dhe përfitimi apo dëmi i tejkalon shumë prej pesë mijë (5000) euro, dënohet me gjobë dhe burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet.

3. Për qëllime të këtij neni, shpërdorimi i detyrës zyrtare përfshinë, por nuk kufizohet në:

3.1. shkeljen me dashje apo me dijeni të ligjit lidhur me detyrat apo punësimin e zyrtarit;

3.2. moskryerja me dashje e ndonjë detyre të domosdoshme të përcaktuar me ligj;

3.3. pranimi i dhuratës, tarifës apo përparësisë së çfarëdo lloji si rezultat i kryerjes së detyrës zyrtare, përveç nëse pranimi i dhuratës, tarifës apo përparësisë lejohet me ligj;



3.4. keqpërdorimi i pasurisë, shërbimeve apo personelit qeveritar apo i ndonjë sendit tjetër me vlerë që i përket qeverisë e që ka rënë në kujdesin apo posedimin e zyrtarit si rezultat i detyrës apo punës së tij;

3.5. nënshtrimi me dashje i personit tjetër në keqtrajtim ose arrest, ndalim, kontroll, marrje, heqje, vlerësim ose barrë për të cilën e di se është e kundërligjshme; ose

3.6. ndalimi ose pengimi me dashje i tjetrit në ushtrimin apo gëzimin e ndonjë të drejte, privilegji, pushteti apo imuniteti ligjor”⁹².

Kjo vepër penale kryhet nga personi zyrtar i cili duke shfrytëzuar funksionin e tij, pra ai është përgjegjës në bazë të ligjit të ushtrojë funksione të caktuara dhe pozitën e tij e përdor për tejkalim të kompetencave ose nuk i përmbush detyrat e tij sipas ligjit dhe me këtë rast përfiton dobi për vete ose për personin tjetër, i shkakton dëm personit tjetër apo shkel të drejtat e të tjerëve.

Këtu bëhet fjalë për keqpërdorimet në detyrë, përkatësisht lidhur me detyrën; kryesi i kësaj vepre penale, përmes veprimeve juridike në fushëveprimin e tij zyrtar, përdor autorizimet e tij në mënyrë të kundërligjshme, përkatësisht kryesi i kësaj vepre penale shfrytëzon në mënyrë të kundërligjshme mundësitë reale dhe juridike të lidhura me pozitën zyrtare, duke kryer veprime të cilat, për nga karakteri i tyre, nuk janë zyrtare, po veprime të rëndomta deliktore. Veprimi i kryerjes është përcaktuar në mënyrë alternative dhe vepra penale paraqitet në tri forma, që janë: 1.) shfrytëzimi i pozitës zyrtare (shpërdorim) apo autorizimeve; 2.) tejkalimi i autorizimeve zyrtare dhe 3.) mospërmbushja e detyrave zyrtare (moskryerja e detyrimeve zyrtare).⁹³

A.) Keqpërdorimi i detyrës zyrtare është forma e parë dhe themelore e kryerjes së kësaj vepre penale. Ajo konsiston në kryerjen e veprimeve juridike në kuadër të autorizimeve të veta nga personi zyrtar, por ato nuk i ndërmerr në përputhje me ligjin apo aktin tjetër juridik dhe më këtë përfiton dobi për vete apo për personin tjetër, i shkakton dëm apo shkel të drejtat e personave tjerë. Kjo formë e keqpërdorimit është e mundur te të ashtuquajturat autorizime diskrecionale të personave zyrtar. Nëse personi zyrtar me rastin e përdorimit dhe vlerësimit të pushtetit diskrecional nuk i merr parasysh interesat e detyrës, por vendimin e merr në interes të vetin apo të personit tjetër, edhe pse vepron në suaza të autorizimeve zyrtare, konsiderohet

⁹² Kodi Penal i Republikës së Kosovës_ Kodi Nr. 06/L-074, neni 414

⁹³ Ismet Salihu / Hilmi Zhitija / Fejzullah Hasani, Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Botimi 1, Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Prishtinë, 2014, fq. 1209



se e keqpërdor pushtetin.⁹⁴ Në këtë rast, si për kufijtë e autorizimeve ashtu edhe për shfrytëzimin e autorizimeve të personit përgjegjës, duhen të vërtetohen autorizimet e personit përgjegjës.

B.) Kur personi zyrtar vepron jashtë kompetencave të tij reale të përcaktuara me ligj apo akt tjetër normativ, konsiderohet se ka tejkaluar kufijtë e autorizimeve e tija. Kryerësi i veprës penale i tejkalon kufijtë e autorizimeve të veta zyrtare, kur ndërmerr veprime juridike zyrtare të cilat janë në kompetencë të një institucioni tjetër zyrtar, ndonjë personi tjetër zyrtar dhe me veprimet e tilla të tejkaluara përfiton dobi për vete apo për persona tjerë, i shkakton dëm apo i shkel të drejtat e personave tjerë. Kjo vepër mund të konsiderohet e konsumuar edhe atëherë kur personi zyrtar për ndërmarrjen e një veprimi juridik është i obliguar sipas ligjit të marrë leje nga organi epror dhe ai nuk e merr pëlqimin apo lejen e tillë.

C.) Mos përmbushja (Moskryerja) e detyrës zyrtare është element tjetër i përmendur në figurën e kësaj vepre penale. Përfshirja e këtij elementi nënkupton se kjo vepër penale mund të kryhet edhe me mos veprim.

Kjo vepër penale mund të kryhet nëse personi zyrtar nuk e nxjerr vendimin të cilin është i detyruar ta nxjerrë, ose vendimin e nxjerrë në kohën dhe mënyrën e cila nuk mund të prodhojë efektet e duhura juridike. Edhe në këtë rast, mos nxjerrja apo vonesa në nxjerrjen e vendimit duhet të bëhet me qëllim që të përfitojë kundërligjshëm dobi për vete apo për tjetrin, t'i shkaktojë dëm apo ti shkel të drejtat e tjetrit.⁹⁵

Me përfshirjen e kryerjes së veprës me çfarëdo dobie është zgjeruar forma e kryerjes së kësaj vepre, që tani nuk kufizohet vetëm me dobi materiale apo shkaktimin e dëmit. Për më tepër, kjo vepër kryhet edhe me: shkeljen me dashje apo me dijeni të ligjit lidhur me detyrat apo punësimin e zyrtarit; moskryerja me dashje e ndonjë detyre të domosdoshme të përcaktuar me ligj; pranimi i dhuratës, tarifës apo përparësisë së çfarëdo lloji si rezultat i kryerjes së detyrës zyrtare, përveç nëse pranimi i dhuratës, tarifës apo përparësisë lejohet me ligj; keqpërdorimi i pasurisë, shërbimeve apo personelit qeveritar apo i ndonjë sendit tjetër me vlerë, që i përket qeverisë e që ka rënë në kujdesin apo posedimin e zyrtarit, si rezultat i detyrës apo punës së tij; nënshtrimi me dashje i personit tjetër në keqtrajtim ose arrest, ndalim, kontroll, marrje, heqje, vlerësim ose barrë për të cilën e di se është e kundërligjshme; ose ndalimi ose

⁹⁴ Ismet Salihu. E Drejta Penale – pjesa e posaçme, fq. 658

⁹⁵ Po aty



pengimi me dashje të tjetrit në ushtrimin apo gëzimin e ndonjë të drejte, privilegji, pushteti apo imuniteti ligjor.⁹⁶ Duhet theksuar se kjo vepër penale kryhet vetëm me dashje direkte. Kjo për faktin se nuk ka mundësi që zyrtari publik nga pakujdesia të fitoi dobi pasurore për vete apo për dikend tjetër, t'i shkaktojë dëm apo ti shkel të drejtat e tjerëve.

Gjykata themelore në Prizren, në rastet e rralla që janë shqiptuar aktgjykime dënuese për këtë vepër penale, në rastin PKR.nr.4/2020, me datën 25 tetor 2022, ka shqiptuar aktgjykim dënues me të cilin ka shpallur fajtor personin me inicialet N.M., për veprën penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 414 i KPRK-së. Gjykata e ka dënuar personin me tetë (8) muaj burgim efektiv dhe dënimin plotësues: “Ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbime publike në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, ashtu që koha e mbajtur e dënimit me burgim, nuk do të llogaritet në kohëzgjatjen e këtij dënimi plotësues”.⁹⁷

I akuzuari N.M., në cilësinë e inspektorit të ndërtimtarisë pranë Drejtorisë së Inspektorateve në Komunën e Prizrenit, në periudhën kohore prej datës 07.11.2014 e deri më datën 18.05.2016, me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete dhe personit tjetër, konkretisht investitorëve, si person zyrtar nuk i përmbush detyrat zyrtare të përcaktuara me ligj i cili ka pasur obligim dhe përgjegjësi të inspektimit të ndërtimeve në rrugën “Muhaxherët”- Zona “Qylhanit” në Prizren dhe të ndali punimet e kundërligjshme të investitorëve të cilët janë ndërmarrë jashtë lejes së ndërtimit. I akuzuari nuk ndërmerr veprime për rrënimin e katit të tretë dhe të katërt të cilat punime janë bërë pa leje ndërtimi dhe në kundërshtim me ligjin për ndërtimin 04/L-110 si dhe nenit 10 të Udhëzimit Administrativ 59/2005 mbi mënyrën e kryerjes dhe mbikëqyrjes inspektive të inspekcionit ndërtimor, ndërtimet të cilat janë bërë në kundërshtim me Planin Zhvillimor Urban të Komunës së Prizrenit dhe lejeve të ndërtimit të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor të Komunës së Prizrenit, me numër 04-351-115221 dhe numër 04-351-115218 të datës 29.08.2014. Kështu i akuzuari N.M., iu ka mundësuar investitorëve R.F., dhe T.H., në mënyrë të pakontrolluar të vazhdojnë ndërtimet dhe atë të katit të tretë dhe të katërt të shtëpive individuale, duke bërë konstatim formal të gjendjes faktike në procesverbale, por asnjëherë nuk e ka zbatuar masën e rrënimit edhe pse ka

⁹⁶ Instituti Gjyqësor i Kosovës, Kodi Penal i Republikës së Kosovës. Prishtinë, 2016, fq. 264

⁹⁷ Linku zyrtar i aktgjykimit: https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/verdicts/PZ_PKR_2019-200452_SQ.pdf



qenë i obliguar për një gjë të tillë, me ç'rast ka sjell përfitim investitorëve në vlerën e tarifave të përcaktuar komunale për sigurimin e lejes për mbindërtim, ndërsa Komunës së Prizrenit ka shkaktuar dëm material në vlerën e tarifave të përcaktuara dhe atë në vlerë prej 2.481.18 € (dymijë e katërqind e tetëdhjetë e një euro e tetëmbëdhjetë cent) për sigurimin e lejes së mbindërtimit dhe po ashtu ka dëmtuar edhe infrastrukturën e qytetit në zonën e ndërtimi “Qylhan”. Prokuroria e akuzuar për veprën penale nga neni 414 i KPRK-së dhe i pandehuri ka pranuar fajësinë dhe i është shqiptuar dënimi si më lartë.⁹⁸

Në rastin e dytë, Gjykata Themelore në Gjakovë, departamenti për krime të rënda, ka shpallur aktgjykim dënues, lënda m e PKR.nr.91/2022, për të pandehurin me inicialet M.L., për shkak se:

Me datë 12.10.2018, në cilësinë e zyrtarit administrativ të Zyrës për Gjendje Civile në fshatin . . . , Komuna e Gjakovës, duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar nuk i ka përmbushur dhe i ka tejkaluar kompetencat e tij të parapara me ligj, ashtu që me qëllim që vetës apo tjetrit ti sjellë përfitim të kundërligjshëm, duke vepruar në kundërshtim me Ligjin nr.04/L-215, neni 29 dhe Udhëzimit Administrativ nr.05/2017, ka fut në sistem personin S. T., nga fshati . . . , Komuna e Gjakovës, ku ka bërë gjenerimin e numrit personal, me çka i ka mundësuar në këtë mënyrë pajisjen me dokumente nga zyra e gjendjes civile, ku pas kërkesës së Ambasadës Britanike në Tiranë, drejtuar ZGJ Civile në Gjakovë për verifikimin e të dhënave për S. T., ka rezultuar se personi i tillë nuk është banor, konkretisht nuk është shtetas i Republikës së Kosovës, e as prindërit e tij A. dhe N. T. nuk kanë qenë të regjistruar. Me çka ka kryer veprën penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 prg.1 lidhur me par.2. pika 2.1 të KPRK-së.⁹⁹ Për këtë vepër penale, Gjykata ka shqiptuar dënimin me burgim, në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj. Dënimi me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj me pëlqimin e të pandehurit i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej 2,600.00 (dymijë e gjashtëqind) euro, e cila gjobë duhet te paguhet ne afat prej 3 (tre) muaj nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë. Dhe gjithashtu i shqiptohet dënimi plotësues ndalimi i

⁹⁸ Linku zyrtar i aktgjykimit: https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/verdicts/PZ_PKR_2019-200452_SQ.pdf

⁹⁹ Linku zyrtar i aktgjykimit: https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/verdicts/GJK_PKR_2022-132922_SQ.pdf



ushtrimit të profesionit në administratën publike ose në shërbimin publik në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve duke filluar nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.¹⁰⁰

Këto aktgjykime janë ndër vendimet gjyqësore të rralla me karakter dënues që jepen nga gjykatat e Republikës së Kosovës për këtë vepër penale. Kjo tregon, në radhë të parë për vështirësitë që hasen në të provuarit e kryerjes së këtyre veprave penale dhe në anën tjetër për paaftësinë dhe jo profesionalizmin e institucioneve të sistemit të drejtësisë, siç janë prokurori i shtetit dhe gjykatat e rregullta.

3.1.2. Keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik

Për shkak të natyrës kontraktuale të prokurimit publik me akterë ekonomikë nga sfera private, shpeshherë ky proces është parë si një vegël për keqpërdorimin e mjeteve publike, korrupsionit dhe ndikimit jo të barabartë ndërmjet akterëve ekonomikë dhe zbatuesve qeveritarë të prokurimit publik.¹⁰¹

Vepra penale tjetër e paraparë ka të bëjë me prokurimin publik. Është e ditur se përmes procedurave të prokurimit publik, zyrtarët përdorin autoritetin e tyre dhe përfitojnë dobi pasurore, dhurata apo favore të ndryshme. Prokurimi publik, është veprimtari administrative që ushtrohet nga zyrtarët publik të punësuar në administratën shtetërore apo publike. Pra në këtë aspekt, zyrtarët e prokurimit janë njëkohësisht edhe zyrtar publik. Kjo vepër penale nuk ka qenë e paraparë me Kodin Penal të Republikës së Kosovës_04/L-082 (i shfuqizuar me Kodin aktual). Prandaj përfshirja e kësaj veprë penale në KPK-në e zbatueshme përbën risi dhe zgjidhje të mirë ligjore.

“1. Kushdo që me vetëdije shkel rregullat e prokurimit publik gjatë një oferte për dhënien e kontratës së prokurimit publik, duke paraqitur dokumentacion të rremë, marrëveshje të fshehtë kundërligjore apo ndërmerr ndonjë veprim tjetër të paligjshëm me qëllim të mashtrimit në procedurat e prokurimit publik dhe më qëllim të ndikimit në vendimin e një autoriteti kontraktues në procedurën e prokurimit publik, dënohet me gjobë dhe burgim deri në pesë (5) vjet.

¹⁰⁰ Ibid

¹⁰¹ Genc Nimoni & Arton Demhasaj: Tenderomania e (pa)ndëshkuar, prill 2018, Organizata për Demokraci dhe Anti-Korrupsion, Çohu!: Prishtinë, 2018, fq. 10. http://www.cohu.org/repository/docs/01_-_Tenderomania_ne_Ndjekje_-_05_252314__137170.pdf



2. Personat përgjegjës apo kushdo i cili më qëllimisht dhe duke shkelur procedurat dhe rregullat e prokurimit publik, nuk zbatojnë detyrimet që dalin nga kontrata e prokurimit publik me qëllim të përfitimit për vete apo duke shkaktuar dëme buxhetore, nëse karakteristikat e veprave të tjera penale nuk janë përmbushur, dënohet me gjobë dhe burgim deri në pesë (5) vjet.
3. Nëse kryerësit e veprave penale nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, përfitojnë ose shkaktojnë dëme të konsiderueshme pasurore, në vlerat mbi pesëmijë euro (5.000), atëherë kryerësi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
4. Në rastet e shpalljes fajtor të kryerësit, përveç dënimit, gjykata do t'i shqiptojë kryerësit ndalimin e marrjes pjesë në procedurat për dhënien e kontratave në prokurim publik.¹⁰²

Pika e parë e këtij neni i referohet shkeljes së rregullave të prokurimit publik me dashje direkte. Pra, kjo vepër penale kryhet me dashje kur paraqitet një ofertë për një kontratë publike dhe me rastin e paraqitjes së ofertës së tillë prezantohet dokumentacion i rremë, marrëveshje e fshehtë kundërligjore ose ndonjë veprim tjetër të paligjshëm. Pra, në këtë rast si elemente të posaçme të veprës penale na paraqiten tri forma: 1.) paraqitja e rreme e dokumentacionit; 2.) marrëveshja e fshehtë kundërligjore; 3.) veprim tjetër kundërligjor. Prezantimi i rreme i dokumentacionit bëhet me qëllim që të ndikohet tek autoriteti kontraktues për përfitim të kontratës. Sipas kësaj pike, figurën e veprës penale e përbëjnë: veprimi i kundërligjshëm që rezulton me shkeljen e rregullave të prokurimit publik (Ligjit dhe akteve tjera të prokurimit publik); dashja direkte si element qenësor; objekti i shkeljes janë vlerat e mbrojtura me rregullat e prokurimit publik (pa nashmëria; objektiviteti; meritokracia); kryhet gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit publik; me prezantim të rreme të dokumentacionit ose ndonjë marrëveshje të fshehtë apo veprim tjetër të paligjshëm; qëllimi i saj është të fitohet kontrata pa meritokraci. Tek kjo vepër penale, sidomos tek forma e parë e shfaqjes, paraqitja e rreme e dokumentacionit, kryerësi i veprës penale nuk është person zyrtar, por subjekti i cili aplikon në një tender publik apo në një procedurë të prokurimit publik. Me këtë rast, nga rregulla e përgjithshme për kategorinë e veprave penale të korrupsionit zyrtar, kjo vepër penale bën përjashtim. Forma e dytë e kësaj vepre penale kryhet, në ato raste kur personi zyrtar bën marrëveshje të kundërligjshme me subjekte juridike të cilat aplikojnë në tenderë publikë. Forma e tretë kryhet atëherë kur personat zyrtarë dhe subjektet tjera ekonomike pjesëmarrëse në tenderë e dëmtojnë procesin e prokurimit dhe bëjnë të mundshme të fitohet tenderi pa meritë.

¹⁰² Kodi Penal i Republikës së Kosovës_ Kodi Nr. 06/L-074, neni 415



Pika e dytë i referohet procedurës së zbatimit të kontratës së prokurimit publik pasi që ajo është fituar nga një operator ekonomik. Për tu përmbushur figura e kësaj vepre penale, duhet që personi përgjegjës të mos respektojë rregullat e prokurimit publik me dashje gjatë zbatimit të kontratës duke përfutur për vete apo për persona tjerë ose i shkakton dëm buxhetit të shtetit. Mos respektimi i rregullave këtu nënkupton që personi zyrtar nuk e përcjellë zbatimin konsekuent të kontratës dhe qëllimisht nuk ja tërheq vërejtjen operatorit ekonomik që ka kontratë për ofrimin e shërbimit apo punës përkatëse. Në të njëjtën kohë këtë vepër penale e konsumon edhe personi përgjegjës i personit juridik i cili nuk e zbaton kontratën e nënshkruar. Por duhet pasur kujdes, se kjo vepër penale konsiderohet e konsumuar vetëm nëse tiparet e përcaktuara me pikën e dytë të nenit 415 nuk përbëjnë vepër tjetër penale të paraparë me Kodin Penal të Kosovës.

Pika e tretë e këtij neni ka të bëjë me peshën e veprës penale. Në rast se përfitimi me këtë vepër penale ose shkaktimin të dëmit për buxhetin e shtetit mbi pesë (5) vjet, atëherë dënimi sanksioni penal rendohet deri në 8 vjet heqje lirie.

Pika e katër i referohet shqiptimit të sanksionit penal dhe dënimit plotësues që i shqiptohet personit të dënuar për një vepër të tillë penale.

3.1.3. Keqpërdorimi i informatës zyrtare

Personat zyrtarë gjatë ushtrimit të funksioneve dhe kompetencave të përcaktuara me legjislacion dhe akte tjera juridik, përballen me informata të rëndësishme, publikimi i të cilave mund të sjellë doli për vete apo për personin tjetër. Informatat e tilla, personi zyrtar obligohet të mos i publikojë dhe të ruajë integritetin profesional dhe etik. Kjo vepër penale është paraparë si vepër penale e veçantë për ruajtje dhe garantuar paanshmëri në ushtrimin e funksioneve zyrtare. KPK-ja në nenin 416, e parasheh këtë vepër penale.

“1. Personi zyrtar i cili keqpërdor informatën zyrtare me qëllim që për vete apo për personin tjetër të përfitojë ndonjë përparësi që nuk i takon, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

2. Nëse informata zyrtare ka të bëjë me ndonjë veprim të prokurimit apo ankand publik, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej dy (2) deri në tetë (8) vjet.



3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me dobi pasurore apo humbje në vlerën që tejkalon pesë mijë (5.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
4. Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton në dobi pasurore apo humbje në vlerën që tejkalon pesëdhjetë mijë (50.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.
5. Për qëllime të këtij neni, shprehja “informatë zyrtare” nënkupton informatën në të cilën personi ka qasje si rezultat i detyrës apo punës së tij dhe e cila nuk është bërë publike.”¹⁰³

Në pikën e parë të kësaj vepre penale bëhet fjalë për një informatë të tillë të rëndësishme për ndonjë raport juridik, në të cilën personi zyrtar ka qasje në bazë të punës a detyrës së tij dhe informata apo e dhëna nuk e ka statusin e sekretit shtetëror, por nuk është publikuar ende, dhe kjo informatë nga personi zyrtar përcillet tek persona të tjerë me qëllim të realizimit të ndonjë përparësie për vete apo për një person tjetër (paragrafi 1).¹⁰⁴ Element i rëndësishëm i kësaj vepre penale është që informata e publikuar rezulton me dobi ose përparësi për vete ose për personin tjetër, e cila përparësi nuk i takon. Pika e dytë e këtij neni i referohet rasteve kur kemi të bëjmë me keqpërdorimin e informatës zyrtare në një tender publik e që merret si rrethanë renduese me rastin e caktimit të sanksionit penal. Pika e tretë dhe e katër i referohen tejkalimit të shumës prej 5000 euro dhe 50000 të cilat merren si rrethana renduese të veçanta për caktimin e sanksionit penal. Në pikën e katër ligjdhënësi ka bërë definimin e termit informatë zyrtare që përdoret për të përcaktuar figurën e kësaj vepre penale.

3.1.4. Konflikti i interesit

Ligjdhënësi e ka paraparë si vepër të veçantë penale paraqitjen e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Kjo vepër penale kryhet me dashje. Ligji parasheh se kur paraqiten raste për vendosje lidhur me të drejtat dhe detyrimet e palëve nga personat zyrtar në cilat situata, marrja e vendimit mund të ndikohet nga interesat e caktuara financiare apo të raporteve familjare, atëherë personi zyrtar duhet të jap dorëheqje nga procesi vendimmarrës. Për shmangien e situatave të konfliktit të interesit, është miratuar edhe ligj i posaçëm - Ligji

¹⁰³ Kodi Penal i Republikës së Kosovës_ Kodi Nr. 06/L-074, neni 416

¹⁰⁴ Ismet Salihu / Hilmi Zhitija / Fejzullah Hasani, Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Botimi 1, Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Prishtinë, 2014, fq. 1223



për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik Ligji Nr. 06/L -011. Në rastet kur personi zyrtar vepron në kundërshtim me dispozitat për parandalimin e konfliktit të interesit, atëherë konsumon veprën penale të paraparë me nenin 417 të KPK-së. Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, në neni 6, e përkufizon nocionin konflikt interesi: “Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare”¹⁰⁵.

“1. Personi zyrtar i cili merr pjesë personalisht në ndonjë çështje zyrtare për të cilën e ka ditur apo është dashur ta dijë se ai apo ajo, ndonjë anëtar i familjes së tij ose të saj, ose ndonjë person juridik që ka të bëjë me të, ka interes financiar, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.

2. Nëse çështja zyrtare është veprim i prokurimit apo ankand publik, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.

3. Për qëllime të këtij neni, shprehja “merr pjesë” nënkupton ushtrimin e autoritetit zyrtar përmes vendimit, miratimit, mosmiratimit, rekomandimit, këshillimit, hetimit, mbikëqyrjes, administrimit, likuidimit, pagesës ose në ndonjë mënyrë tjetër të ushtrimit të ndikimit të padrejtë për një çështje zyrtare.

4. Për qëllime të këtij neni, shprehja “çështje zyrtare” nënkupton procedurë gjyqësore ose procedurë tjetër zyrtare; aplikim, kërkesë për vendim ose përcaktim tjetër zyrtar; kontratë apo kërkesë; ankand publik ose veprim tjetër i prokurimit; ose ndonjë çështje tjetër e cila prek interesat financiare të personit zyrtar, anëtarit të familjes apo ndonjë personi juridik që ka të bëjë me të.

5. Për qëllime të këtij neni, shprehja “person juridik që ka të bëjë me të” - nënkupton personin juridik në të cilin zyrtari apo anëtari i familjes ka marrëdhënie financiare aktuale apo të ardhshme, përfshirë marrëdhënien afariste ose të punës apo dobi financiare të çfarëdo natyre.

6. Për qëllimet e këtij neni, një anëtar i familjes do të thotë bashkëshorti ose bashkëshortja, prindi, prindi adoptues, fëmija, fëmija i adoptuar, vëllai ose motra, gjyshi ose gjyshja, nipat e mbesat nga vajza dhe djali, hallat dhe tezet, nipat e mbesat nga vëllai dhe motra, dajët dhe axhallarët, njerku/njerka, thjeshtri/thjeshtja, vëllai /motra nga njëri prind, i afërmi i gjakut që jeton në të njëjtën shtëpi ose personi me të cilin kryesi jeton në bashkësi jashtëmartesore.”¹⁰⁶

Në pikën e parë të kësaj vepre penale është përcaktuar figura e veprës penale të konfliktit të interesit. Në ato raste kur personi zyrtar, duke vepruar në kufijtë e autorizimeve të tija duke e ditur apo që është dashur të dijë, merr pjesë në një proces vendimmarrës ku si palë paraqiten

¹⁰⁵ Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik Ligji Nr. 06/L -011, neni 6

¹⁰⁶ Kodi Penal i Republikës së Kosovës_ Kodi Nr. 06/L-074, neni 417



anëtar të familjes të cilët kanë interesa financiare atëherë konsumohen elementet e veprës penale konflikti i interesit.

Pika e dytë e kësaj vepre penale është edhe forma e dytë me të cilën kryhet kjo vepër penale ka të bëjë me situatat kur zyrtari vepron në konflikt interesi në prokurim publik. Në këtë rast konflikti i interesit merret si rrethanë renduese në lidhje me shqiptimin e sanksionit penal (dënimi parashihet deri në 5 vjet burgim). Pikat pasuese të këtij neni, janë sqarime të përkufizimit të termeve.

3.1.5. Përvetësimi në detyrë

Përvetësimi në detyrë paraqet përvetësim të parave, letrave me vlerë apo sendeve tjera të luajtshme nga personi zyrtar të cilit i janë besuar ato në bazë të detyrës zyrtare apo në një institucion publik, me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore të kundërligjshme për vete apo për tjetrin. Kjo vepër penale është e ngjashme me veprën penale të shpërdorimit dhe për këtë arsye shpesh quhet shpërdorim në detyrë dhe trajtohet si vepër penale kundër pasurisë, (në disa legjislacione, p.sh., në atë slloven kjo edhe është klasifikuar në grupin e veprave penale kundër pasurisë). Kjo për faktin se objekt i kësaj vepre penale, përveç detyrës zyrtare, përkatësisht kryerjes me nder të punës zyrtare, është edhe pasuria. Kryerësi është i autorizuar që të disponojë sende të tilla, të punojë me to, që ato t'i japë për shfrytëzim etj. Të gjitha këto autorizime janë të lidhura me pozitën apo ushtrimin e kompetencave që ai ka në organin shtetëror - publik. Kryerës i kësaj vepre penale është personi të cilit një send i caktuar i është besuar në detyrë në organin publik.¹⁰⁷

1. Personi zyrtar, i cili me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër, përvetëson pasurinë e cila i është besuar për shkak të detyrës apo pozitës së tij, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me dobi pasurore apo humbje në vlerë që tejkalon pesëmijë (5.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

¹⁰⁷ Instituti Gjyqësor i Kosovës, Kodi Penal i Republikës së Kosovës. Prishtinë, 2016, fq. 268



3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me dobi pasurore apo humbje në vlerë që tejkalon pesëdhjetë mijë (50.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.¹⁰⁸

Sipas pikës së parë të këtij neni, figura e kësaj vepre penale plotësohet atëherë kur, personi zyrtar i cili në bazë të autorizimeve të tija i është besuar ruajtja e pasurisë së luajtshme publike, ai me dashje me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete apo për tjetrin e përvetëson pasurinë publike. Pra, kjo vepër kryhet vetëm nga zyrtari publik i cili ka për detyrë ta ruajë pasurinë publike. Objekt i mbrojtur me këtë vepër penale janë sendet (pasuria) e luajtshme (kodi nuk e ka përcaktuar saktë por nënkuptohet) që kategorizohen si të mira publike – pasuri publike të shtetit e cila i është besuar zyrtarit publik. Element tjetër i kësaj vepre penale është përvetësimi i dobisë pasurore publike për vete apo për persona tjerë nga zyrtari publik. Kjo njëkohësisht paraqet edhe element themelor të kësaj vepre penale, i cili e veçon atë nga vepra penale e vjedhjes. Me besim të sendeve konsiderohet besimi i sendeve që janë në funksion të kryerjes së një detyre të caktuar, të cilat janë të lidhura për kryerjen e detyrave të caktuara në punë e që janë të lidhura funksionalisht me kryerjen e obligimeve zyrtare.¹⁰⁹

Përvetësimi në detyrë (shpërdorimi) do të ekzistonte, nëse përvetësimin e sendeve të theksuara me lart do ta bënte zyrtari i postës, i cili përgatit dërgesat, magazinieri, arkëtari, tregtari që shet mallin, arkëtari i këshillit shtëpiak, personi i autorizuar për shpërndarjen e sendeve në organizatat e ndryshme humanitare, në shoqata etj.¹¹⁰

Pika e dytë i referohet përvetësimit në detyrë në rastet kur shuma e përvetësuar e tejkalon shumë më prej 5000 euro, e cila ndikon në rritjen e sanksionit penal. Edhe pika e tretë ndërlihet me të dytën, pasi që përcakton se kur përvetësimi i dobisë pasurore e tejkalon shumë më prej 50000 mijë euro atëherë sanksioni penal shkon nga 3 deri 12 vjet burgim.

3.1.6. Mashtrimi në detyrë

Vepra penale e mashtrimit në detyrë paraqet një formë të posaçme të mashtrimit, që e kryen personi zyrtar apo personi përgjegjës, me qëllim që vetes apo një tjetri t'i sjellë përfitim

¹⁰⁸ Kodi Penal i Republikës së Kosovës_Kodi Nr. 06/L-074, neni 418

¹⁰⁹ Instituti Gjyqësor i Kosovës, Kodi Penal i Republikës së Kosovës. Prishtinë, 2016, fq. 268

¹¹⁰ Ismet Salihu / Hilmi Zhitija / Fejzullah Hasani, Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Botimi 1, Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Prishtinë, 2014, fq. 1227



të kundërligjshëm pasuror, duke prezantuar llogari të rreme apo duke sjellë, në ndonjë mënyrë tjetër, në lajthitje personin e autorizuar që të kryejë një pagesë të kundërligjshme. Kjo vepër është e ngjashme me veprën e përgjithshme të mashtrimit, tek e cila përfitimi i kundërligjshëm i dobisë pasurore kryhet, duke e vënë në lajthitje personin që kryen një pagesë të kundërligjshme. Dallimi qëndron në faktin që këtë vepër penale e kryen personi zyrtar, me se, përpos pasurisë, dëmtohet edhe kryerja e ligjshme e detyrës zyrtare, e cila në këtë rast është objekt primar i mbrojtur. Prandaj, kjo vepër përbën një formë të posaçme të veprës penale të mashtrimit, kështu që, sipas parimit të specialitetit, përjashtohet bashkimi në mes të këtyre veprave penale.¹¹¹

“1. Personi zyrtar, i cili me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër, bën krijimin, përdorimin ose prezantimin e rremë të raportit të llogarive apo në ndonjë mënyrë tjetër e vë në lajthim personin e autorizuar në kryerjen e pagesës ose transferit të kundërligjshëm të parave, pasurisë ose të drejtave tjera, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

2. Kushdo që me qëllim të kryerjes, fshehjes ose maskimit të një veprë penale sipas neneve 309, 310, 421, 422, 423 ose 424 të këtij Kodi, krijon ose përdor një faturë ose ndonjë dokument tjetër kontabël ose regjistrim që përmban informata të rrejshme ose jo të plota, ose heq dorë nga regjistrimi i pagesës, dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me dobi pasurore në vlerë që tejkalon pesëmijë (5.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

4. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me dobi pasurore në vlerë që tejkalon pesëdhjetë mijë (50.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.”¹¹²

Në pikën e parë të këtij neni ligdhënësi ka inkriminuar veprimet e kundërligjshme të zyrtarit publik që rezultojnë me dobi pasurore për vete apo për tjetrin me krijimin ose prezantimin e rremë të raportit llogarive apo e vën në lajthim personin e autorizuar në kryerjen e pagesës apo transferit bankar

¹¹¹ Ismet Salihu / Hilmi Zhitija / Fejzullah Hasani, Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Botimi 1, Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Prishtinë, 2014, fq. 1233-34

¹¹² Kodi Penal i Republikës së Kosovës_ Kodi Nr. 06/L-074, neni 419



3.1.7. Përdorimi i paaautorizuar i pasurisë

Kjo vepër penale ka ngjashmëri me veprën penale të përvetësimit gjatë ushtrimit të detyrës (neni 425), dallohet nga kjo vepër penale për faktin se te vepra e parashikuar nga neni 418, dashja e kryerësit është e orientuar në drejtim të përvetësimit, ndërsa te vepra penale e përdorimit të paaautorizuar të pasurisë dashja e kryerësit është e orientuar në drejtim të përdorimit. Karakteristikë e veprës së përdorimit të paaautorizuar të pasurisë është marrja e përkohshme e sendit të huaj të luajtshëm me qëllim që ai të kthehet përsëri, për dallim nga vepra penale e parashikuar nga neni 418 tek e cila sendi përvetësohet, merren autorizimet pronësore, pronarit të mëparshëm tentohet që përgjithmonë t'i pamundësohet pronësia mbi sendin e përvetësuar.¹¹³

Kushdo që pa autorizim përdor paratë, letrat me vlerë apo pasurinë tjetër të luajtshme e cila i është besuar atij në detyrë ose në përgjithësi në vendin e punës apo në të cilat ka qasje për shkak të shërbimit apo punës së tij, ose kushdo që i jep pasurinë e këtillë personit tjetër për shfrytëzim të paaautorizuar, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.¹¹⁴

3.1.8. Marrja e ryshfetit

Ryshfeti përfshin ofrimin, premtimin ose dhënien e qëllimshme të ndonjë përfitimi të padrejtë monetar ose tjetër për një zyrtar ose vendimmarrës, me qëllim që zyrtari ose vendimmarrësi të veprojë ose të mos veprojë në lidhje me kryerjen e detyrave të tyre.¹¹⁵ Në përgjithësi, në çdo transaksion të ryshfetit lidhur me biznesin ka katër palë kryesore: ryshfetuesi; personi i marrë ryshfet dhe organizatat e tyre përkatëse. Ndonëse nuk është gjithmonë kështu, këto organizata ndonjëherë janë viktimë e drejtpërdrejtë e ryshfetit, për shembull, agjencia qeveritare që paguan shumë për shërbimet si pjesë e një skeme ryshfeti ose organizata private që lidh kontrata me kushte të pafavorshme si një rezultat i veprimeve të ryshfetit dhe personit të ryshfet. Mund të ketë gjithashtu shumë viktimë indirekte të ryshfetit, duke përfshirë individë që vuajnë kur fondet devijohen nga shërbimet publike dhe bizneset që

¹¹³ Instituti Gjyqësor i Kosovës, Kodi Penal i Republikës së Kosovës. Prishtinë, 2016, fq. 271

¹¹⁴ Kodi Penal i Republikës së Kosovës_ Kodi Nr. 06/L-074, neni 420

¹¹⁵ OECD (2013), "What are bribery and corruption?", in Bribery and Corruption Awareness Handbook for Tax Examiners and Tax Auditors, OECD Publishing, Paris. F. 10



i binden ligjit që humbasin kontratat sepse refuzojnë të paguajnë ryshfet.¹¹⁶ Ligjdhënësi në Kosovë, në lidhje me ryshfetin i ka paraparë dy vepra penale: marrja e ryshfetit dhe dhënia e ryshfetit. D.m.th., se edhe dhënësi i ryshfetit përfshihet në veprime korruptive dhe në një mënyrë është ai i cili ia mundëson marrësit të ryshfetit (zyrtarit publik) të ndërmerr veprim të kundërligjshëm. Këto dy lloje të veprave penale përbëjnë në esencë korrupsionin pasi paraqesin rastet flagrante të përfitimit material për vete ose për tjetrin.

1. Personi zyrtar ose personi i huaj zyrtar apo zyrtari publik i huaj i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, kërkon ose pranon ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër për vete apo personin tjetër, ose që pranon ofertën apo premtimin për dhuratë apo përfitim të tillë, në mënyrë që personi zyrtar ose personi i huaj zyrtar apo zyrtari publik i huaj të veprojë ose të mos veprojë në pajtim me detyrën e tij zyrtare, dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

2. Personi zyrtar ose personi i huaj zyrtar apo zyrtari publik i huaj i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, kërkon ose pranon ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër për vete apo personin tjetër, ose që pranon ofertën apo premtimin për dhuratë apo përfitim të tillë, në mënyrë që personi zyrtar ose personi i huaj zyrtar apo zyrtari publik i huaj të veprojë ose të mos veprojë, në kundërshtim me detyrën e tij zyrtare, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.

3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me dobi materiale në vlerë që tejkalon pesëmbëdhjetë mijë (15.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej pesë (5) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet.¹¹⁷

Në pikën e parë të nenit 421, ligjdhënësi ka paraparë subjektet që mund të kryejnë veprën penale marrja e ryshfetit. Këtu na paraqiten si subjekte të veprës penale: personi zyrtar vendor; personi zyrtar i huaj dhe zyrtari publik i huaj. Objekt i kësaj vepre penale është kërkesa ose pranimi i dhuratave apo ndonjë përfitimi tjetër për vete apo për tjetrin. Vepra mund të kryhet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë. Kërkesa ose pranimi i dhuratave dhe përfitimi tjetër bëhet me qëllim të kryerjes apo mos kryerjes së detyrave të zyrtarit publik në pajtim me ligjin.

Pika e dytë e këtij neni ka të bëjë me atë që zyrtari publik duhet të veprojë në kundërshtim me detyrën zyrtare dhe në këtë rast sanksioni penal është më i madh.

Pika e tretë i referohet ndëshkimit penal në rast se për pikën e parë të këtij neni, dëmi e kalon shumë prej 15.000 euro.

¹¹⁶ Ibid, f. 10

¹¹⁷ Kodi Penal i Republikës së Kosovës_ Kodi Nr. 06/L-074, neni 421



Në këtë vepër penale kemi të bëjmë me korrupsionin pasiv – pra, kërkimin apo marrjen e ryshfetit. Vepra penale konsiderohet e konsumuar edhe vetëm nëse dikush ka kërkuar ryshfet, pa u shkaktuar pasoja kriminale. Kjo për faktin se pika e parë dhe e dytë e këtij neni e përcakton edhe kërkesën për ryshfet si element të figurës së veprës penale. “Kjo formë e veprës penale të marrjes së ryshfetit, për nga veprimi i kryerjes, nuk dallon nga paragrafi 2, po dallon vetëm për nga veprimi zyrtar për të cilin kërkohet apo merret ryshfeti. Tek forma e dytë e veprës penale bëhet fjalë për veprim të palejueshëm, të paligjshëm të personit zyrtar, ndërsa te kjo formë e veprës penale ryshfeti merret që të veprohet në kuadër të kufijve të autorizimeve zyrtare dhe ndërmerret veprimi i ligjshëm, pra duhet të ndërmerret a të mos ndërmerret veprimi zyrtar, që edhe ashtu nuk ka mundur të ndërmerret, d.m.th., te kjo formë veprimi zyrtar është dashur të ndërmerret edhe pa ryshfet, përkatësisht veprimi zyrtar nuk është ndërmarrë për shkak se me ligj ka qenë e ndaluar të ndërmerret dhe jo që nuk është ndërmarrë për shkak të marrjes së ryshfetit.”¹¹⁸

Në lidhje me këtë vepër penale, kemi marrë dy aktgjykime nga gjykatat e rregullta të Kosovës. Rasti i parë ka të bëjë me një drejtor të financave në Komisionin e Pavarur për Media dhe rasti i dytë ka të bëjë një referent në Gjykatën Themelore të Pejës.

Arben Bilalli, ish-drejtor i Administratës dhe Financave në Komisionin e Pavarur të Mediave (KPM), është dënuar me 140 ditë burgim dhe 12 mijë euro gjobë për veprën penale “Marrja e ryshfetit”. Bilalli po akuzohej bashkë me ish-kryeshefin e KPM-së, Luan Latifi se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale “Marrja e ryshfetit”. Në seancën e mbajtur më datë 25 korrik 2022, Bilalli kishte pranuar fajësinë, dhe ishte veçuar procedura ndaj tij, ndërsa Latifi ishte deklaruar i pafajshëm. Aktgjykimi ndaj të akuzuarit Bilalli u shpall të enjten nga gjyqtari Alban Ajvazi, raporton “Betimi për Drejtësi”. Sa i përket dënimit me burgim prej 140 ditëve, gjyqtari Ajvazi tha se të akuzuarit Bilalli do t’i llogaritet edhe koha e mbajtur në paraburgim dhe koha të cilën e ka kaluar në arrest shtëpiak, i cili dënim do të ekzekutohet pas shpalljes së këtij aktgjykimi. Gjithashtu të njëjtit në emër të dënimit plotësues, i ndalohet ushtrimi

¹¹⁸ Ismet Salihu / Hilmi Zhitija / Fejzullah Hasani, Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Botimi 1, Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Prishtinë, 2014, fq. 1245



i funksionit publik në administratë publike ose shërbime publike në kohëzgjatje prej 3 vitesh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.¹¹⁹

Me një vit burgim efektiv dhe 1 mijë euro gjobë për marrje të ryshfetit është dënuar Z.H., ish-zyrtar i Gjykatës Themelore të Pejës. Prokuroria e akuzon se ai në këmbim të shërbimit të kryer, ka marrë shumën prej 30 euro e 50 centë në dy raste të ndryshme. Sipas aktakuzës, Z.H., ka pranuar 30 euro si shpërblim për rregullimin e dokumentacionit të një vendimi gjyqësor në favor të palës D.Sh. Përveç kësaj, dyshohet se ai ka pranuar 0.50 euro nga një person tjetër, pasi e ka informuar atë për zyrën e një avokati. Gjykata e Prizrenit, në seancën e së mërkurës, e shpalli fajtor ish-zyrtarin Hoxha dhe atë e dënoi me 1 vit burgim dhe 1 mijë euro gjobë për akuzën e marrjes së ryshfetit. Ndaj të njëjtit u shqiptua dhe dënimi plotësues, ndalimi i ushtrimit të profesionit për një vit, pas mbajtjes së dënimit.¹²⁰

Siç vërehet në rastin e dytë, gjykata ka shqiptuar një dënim shumë të rëndë për marrje ryshfeti në shumën prej 30.05 euro. Ndoshta Gjykata ka menduar që shqiptimi i një dënimi më të ashpër do të ketë efekte preventive në parandalimin e veprave të tilla penale.

3.1.9. Dhënia e ryshfetit

E veçanta e veprës penale *dhënia e ryshfetit* është se ajo nuk kryhet nga personi zyrtar, edhe pse kjo vepër penale është renditur në grupin e veprave penale kundër detyrës zyrtare. Me që ekziston një lidhje ndërmjet dhënies së ryshfetit dhe pranimi, atëherë ligjdhënësi e ka paraparë këtë vepër në këtë grup të veprave penale.

Dhënia e ryshfetit paraqet korrupsionin aktiv. Personi që jep ryshfet është person aktiv.

1. Kushdo që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, për vete apo për një person tjetër i premtan, ofron ose i jep ndonjë dhuratë të paarsyeshme apo përfitim tjetër personit zyrtar, në mënyrë që ai person të veprojë ose të mos veprojë në pajtim me detyrën e tij zyrtare, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në pesë (5) vjet.

2. Kushdo që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, për vete apo për një person tjetër i premtan, ofron ose i jep ndonjë dhuratë të paarsyeshme apo përfitim tjetër personit zyrtar, në mënyrë që ai person të veprojë ose të mos veprojë në kundërshtim me detyrën e tij zyrtare, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

¹¹⁹ <https://betimiperdrejtesi.com/https-betimiperdrejtesi-com-wp-admin-post-phppost134372actionedit/>

¹²⁰ <https://kallxo.com/ligji/akuzohet-se-mori-30-5-euro-ryshfet-denohet-me-burg-ish-zyrtari-i-gjykates-se-pejes/>



3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me përfitim në vlerë që tejkalon pesëmbëdhjetë mijë (15.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

4. Nëse kryesi i veprës penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni e ka dhënë dhuratën e paarsyeshme apo përfitimin me kërkesë të personit zyrtar apo personit përgjegjës dhe e lajmëron veprën para fillimit të procedurës penale ose para se ta dijë që ka filluar procedura penale, gjykata mund ta lirojë nga dënimi.¹²¹

Paragrafi i parë dhe i dytë i këtij neni janë të ngjashme me marrjen e ryshfetit, me dallimin se në këtë rast kemi korrupsion aktiv. E veçanta e kësaj vepre penale është se pika e katër e këtij neni parasheh situatën kur dhënësi i dhuratës së pa arsyeshme apo me kërkesën e personit zyrtar dhe e lajmëron veprën para fillimit të procedurës penale, atëherë gjykata mund ta lirojë nga dënimi dhënësin e ryshfetit. Kjo paraqet bazë të veçantë për lirim nga dënimi.

Duke marrë parasysh rrethanat në të cilat kryhet kjo vepër penale, atëherë edhe mbledhja e provave me të cilat argumentohet nuk është e lehtë në praktikë. Gjykata themelore e Prishtinës, departamenti special, në lëndën me PS.nr.12/2022, datën 25 nëntor 2022, ka shpallur fajtor për veprën penale “dhënie e ryshfetit” personat me inicialet A.D dhe D.S. Që nga viti 2016 e deri në vitin 2019, në vazhdimësi, të pandehurit A. D. dhe D.S, me qëllim të kalimit të mallrave kontrabandë nga Republika e Serbisë për në Republikën e Kosovës dhe anasjelltas, u kanë dhënë shuma të parave apo përfitim tjetër personave zyrtar – policeve të SPMK në L., në mënyrë që personat zyrtar të veprojnë ose të mos veprojnë në kundërshtim me detyrën e tyre zyrtare, ku me të njëjtit janë dakorduar që me rastin e kalimit të mallrave të paguajnë shuma të parave sipas tarifave të përcaktuara për çdo automjet dhe atë nga 20 Euro për vetura të vogla, 30 – 50 Euro për furgona dhe 100-150 Euro për çdo kamion, e që këto shuma të parave i kanë paguar tek zyrtaret policor por edhe i kanë lenë nëpër vend të caktuara si tek pompa e derivateve “Ç.”, dyqani “T M.” si dhe në veturën e tani të pandehurit M. J. – L., ku pas hetimit nga ana e policisë edhe janë arrestuar. Me këtë secili veç e veç ka kryer veprën penale “Dhënia e ryshfetit” nga neni 429 par.2 të KPRK-së. Mirëpo me që të pandehurit kanë qenë dëshmitar bashkëpunues të shpallur sipas urdhrit të gjykatës PPPS.nr.52/2019, të dt: 18.12.2019, dhe urdhrit PS.nr.20/2020 të dt:18.06.2020, janë liruar nga dënimi.¹²²

¹²¹ Kodi Penal i Republikës së Kosovës_ Kodi Nr. 06/L-074, neni 422

¹²² Linku zyrtar i aktgjykimit: https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/verdicts/PR_P_2020-046099_SQ.pdf



3.1.10. Dhënia e ryshfetit zyrtarit publik të huaj apo personave të huaj zyrtar

Kjo vepër penale është paraparë edhe me Konventën penale kundër korrupsioni, përkatësisht me nenet 2 (Korrupsioni aktiv i zyrtareve publike kombëtare); neni 3 (Korrupsioni pasiv i zyrtareve publike kombëtare); neni 5 (Korrupsioni i zyrtareve publike të huaj); neni 9 (Korrupsioni i zyrtareve të organizatave ndërkombëtare); neni 10 (Korrupsioni i anëtarëve të asambleve parlamentare ndërkombëtare); dhe neni 11 (Korrupsioni i gjyqtareve dhe zyrtareve të gjykatave ndërkombëtare). Konventa i obligon shtetet që në legjislacionin e brendshëm të inkriminojnë si vepra penale të veçanta veprimet korruptive të zyrtarëve publik ndërkombëtar. Duke u bazuar në këtë, edhe pse Kosova nuk është nënshkruese e kësaj Konvente e ka përvetësuar këtë zgjidhje ligjore në legjislacionin e brendshëm.

1. Kushdo që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, i premtan, ofron ose i jep ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër zyrtarit publik të huaj apo personit të huaj zyrtar, për veten ose për personin tjetër, në mënyrë që ai zyrtar i huaj publik apo personi i huaj zyrtar ose personi tjetër të veprojë ose të mos veprojë në pajtim me detyrën e tij zyrtare, dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
2. Kushdo që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, i premtan, ofron ose i jep ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër zyrtarit publik të huaj apo personit të huaj zyrtar, për veten ose për personin tjetër, në mënyrë që ai zyrtar i huaj publik apo personi i huaj zyrtar ose personi tjetër të veprojë ose të mos veprojë në kundërshtim me detyrën e tij zyrtare, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.
3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me përfitim në vlerë që tejkalon pesëmbëdhjetë mijë (15.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.
4. Dhurata apo përfitimi i pranuar apo i ofruar në kundërshtim të këtij neni konfiskohet.¹²³

Figura e kësaj vepre penale është e ngjashme me dy veprat penale të shpërmendura nga neni 421 (marrja e ryshfetit) dhe 422 (dhënia e ryshfetit). Pra, kjo vepër penale i përfshinë elementet e të dyja veprave penale.

3.1.11. Ushtrimi i ndikimit

Kjo vepër penale, me përshkrimin ligjor të cilin e ka paraparë Kodi Penal, mund të kryhet edhe nga personat tjerë që nuk e kanë statusin e zyrtarit publik. Kjo për faktin se norma përdor

¹²³ Kodi Penal i Republikës së Kosovës_ Kodi Nr. 06/L-074, neni 423



fjalën “*kushdo*”. Në këtë rast “*kushdo*” mund të jenë persona zyrtar (zyrtar publik) ose persona që nuk ushtrojnë funksione publike. Pra subjekt të veprës penale mund të jenë zyrtarët publik por edhe personat tjerë.

1. Kushdo që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, kërkon ose pranon ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër për vete apo personin tjetër, ose pranon ofertën apo premtimin për dhuratë apo përfitim të tillë, me pretendimin se ai apo ajo është në gjendje të ushtrojë ndikim të padrejtë mbi vendimmarrjen e personit zyrtar, zyrtarit të huaj publik ose personit të huaj zyrtar, pavarësisht nëse ndikimi është ushtruar ose pavarësisht nëse ndikimi i supozuar shpie deri te rezultati i synuar, dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

2. Kushdo që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, i premtton, ofron ose i jep ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër personit tjetër, në mënyrë që ky person të ushtrojë ndikim të papërshtatshëm mbi vendimmarrjen e personit zyrtar, zyrtarit të huaj publik ose personit të huaj zyrtar, pavarësisht nëse ndikimi është ushtruar ose pavarësisht nëse ndikimi i supozuar shpie deri te rezultati i synuar, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tetë (8) vjet.

3. Dhurata apo përfitimi i pranuar apo i ofruar në kundërshtim të këtij neni konfiskohet.¹²⁴

Me këtë vepër penale inkriminohet intervenimi te personi zyrtar kompetent për interes të personit të tretë. Këtu bëhet fjalë për ndërmjetësim-për ndikim te personi zyrtar apo te personi përgjegjës lidhur me punën nga fushëveprimi i tij zyrtar e për llogari të personit të tretë, i cili është i interesuar që një veprim i tillë të kryhet a të mos kryhet, ose është i interesuar të kryhet një punë e paligjshme apo të mos kryhet një veprim që është dashur të kryhet. Vetë ndikimi mbi personin zyrtar qëndron në shfrytëzimin e kryesit të pozitës zyrtare a shoqërore apo ndikimin mbi një autoritet të tillë, të bazuar në pozitën e kryesit në detyrë ose në shoqëri, në parti politike etj.¹²⁵

3.1.12. Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore

Këtë vepër penale mund ta kryej vetëm gjyqtari gatë ushtrimit të kompetencave të përcaktuara me ligj.

¹²⁴ Ibid, neni 424

¹²⁵ Ismet Salihu / Hilmi Zhitija / Fejzullah Hasani, Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Botimi 1, Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Prishtinë, 2014, fq. 1257



*Gjyqtari i cili me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër ose për t'i shkaktuar dëm personit tjetër, nxjerr vendim të kundërligjshëm, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.*¹²⁶

Veprimi i kryerjes qëndron në marrjen e vendimit të kundërligjshëm, apo shkeljen e ligjit në ndonjë mënyrë tjetër. Me shkelje të ligjit, ku bën pjesë edhe marrja e vendimit të kundërligjshëm, nënkuptojmë çdo vendosje në kundërshtim me ligjin, qoftë duke mos e aplikuar ligjin, qoftë duke aplikuar ligjin në kundërshtim me dispozitat dhe kuptimin e tij. Shprehja ligj, në kuptim të kësaj vepre penale, duhet interpretuar me një vështrim të gjerë, pra me të duhet kuptuar çdo dispozitë e ligjshme, të cilën gjykata është e detyruar ta aplikojë në një rast konkret (dispozita kushtetuese dhe ligjore, dispozitat e përcaktuara me akt të përgjithshëm, urdhëresat, statuti, rregulloret që janë nxjerrë në bazë të autorizimeve kushtetuese apo në bazë të ligjit).¹²⁷

3.1.13. Zbulimi i fshehtësisë zyrtare

Me këtë vepër penale mbrohet fshehtësia e të dhënave të cilat konsiderohen fshehtësi zyrtare. Karakteristikë e përgjithshme e të dhënave të cilat paraqesin fshehtësi zyrtare është se ato i di vetëm një numër i vogël i personave dhe se në rastet e zbulimit të tyre mund të rrezikohet funksionimi normal dhe efikas i detyrave zyrtare, interesi i qytetarit apo i shoqërisë. Për këtë arsye, fshehtësia zyrtare mbrohet edhe me normat e të drejtës penale materiale.¹²⁸ Për ta sqaruar figurën e kësaj vepre penale, në nenin e 5 është përkufizuar termi fshehtësi zyrtare.

- 1. Personi zyrtar i cili pa autorizim kumton, dërgon ose në ndonjë mënyrë tjetër i vë në dispozicion personit tjetër informatën që përbën fshehtësi zyrtare ose siguron informatën e tillë me qëllim që t'ia përcjellë ndonjë personi të paautorizuar, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet.*
- 2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet për përfitim personal ose me qëllim të publikimit apo shfrytëzimit të informacionit jashtë Republikës së Kosovës, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.*
- 3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.*

¹²⁶ Kodi Penal i Republikës së Kosovës_ Kodi Nr. 06/L-074, neni 425

¹²⁷ Ismet Salihu / Hilmi Zhitija / Fejzullah Hasani, op. cit, fq. 1262

¹²⁸ Ismet Salihu. E Drejta Penale – pjesa e posaçme, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, Prishtinë, 2021, f. 681



4. Dispozitat e këtij neni zbatohen ndaj personit i cili zbulon fshehtësinë zyrtare edhe pasi që të ketë pushuar statusi i tij zyrtar.

5. Për qëllime të këtij neni, shprehja “fshehtësi zyrtare” nënkupton informatat ose dokumentet të shpallura si fshehtësi zyrtare me ligj, dispozita të tjera ose me vendim të organit kompetent të nxjerrë në bazë të ligjit dhe zbulimi i të cilave ka shkaktuar ose mund të shkaktojë pasoja të dëmshme. Sidoqoftë, informatat në vijim nuk konsiderohen fshehtësi zyrtare:

5.1. informatat apo dokumentet të cilat janë të drejtuara në cenimin e rëndë të të drejtave themelore të njeriut ose mos zbulimi i të cilave do të mund të rrezikonte rendin kushtetues apo sigurinë e Republikës së Kosovës; ose

5.2. informatat dhe dokumentet të cilat kanë për qëllim fshehjen e kryesit të veprës penale të dënueshme me së paku pesë (5) vjet burgim.¹²⁹

Vepra penale kryhet nga personi zyrtar, d.m.th., subjekt i veprës është personi zyrtar, mirëpo, sipas paragrafit 4, kryes i kësaj vepre mund të jetë edhe personi të cilit ndërkohë i ka pushuar statusi i personit zyrtar, i cili i kumton ndonjë personi tjetër të dhënat që paraqesin fshehtësi, për të cilat ka marrë dijeni në kohën sa e kishte statusin e personit zyrtar. Veprimi i kryerjes.- Te kjo vepër penale është përcaktuar në mënyrë alternative si kumtim, bartje apo bërje e të dhënave të tilla, që paraqesin të dhëna të fshehta, të qasshme në ndonjë mënyrë tjetër, si dhe sigurimi i të dhënave të tilla, me qëllim që ato t’ia dorëzojë personit të paautorizuar. këto të dhëna duhet t’i kumtohen tjetrit, e shprehja “tjetrit” në kuptim të kësaj vepre penale, duhet kuptuar - çdo person fizik a juridik, i cili nuk është kompetent as i autorizuar që të dijë për të dhëna të tilla. Personi tjetër mund të jetë edhe personi që nuk është i autorizuar të mësojë për përmbajtjen e të dhënave të tilla.¹³⁰

3.1.14. Falsifikimi i dokumentit zyrtar

Subjekt i kësaj vepre penale është personi zyrtar, i cili gjatë ushtrimit të detyrave dhe kompetencave të veta bën falsifikim të dokumentit zyrtar.

Ekzistojnë tri modalitete të falsifikimit të dokumentit: 1. futja e të dhënave të pavërteta apo mos futja e ndonjë të dhëne të rëndësishme; 2. vërtetimi i dokumentit, regjistrimit apo

¹²⁹ Kodi Penal i Republikës së Kosovës_ Kodi Nr. 06/L-074, neni 425

¹³⁰ Ismet Salihu / Hilmi Zhitija / Fejzullah Hasani, op. cit, fq. 1265



shkresës së rreme; 3. mundësimi i përpilimit të dokumentit, librit apo shkresës së pavërtetë, me përmbajtje të rreme.¹³¹

1. Personi zyrtar i cili në dokumentin zyrtar, në regjistër ose në shkresën zyrtare shënon të dhëna të rreme ose nuk shënon të dhënat e duhura apo me nënshkrimin e tij ose me vulën zyrtare vërteton dokumentin zyrtar, regjistrin apo shkresën zyrtare e cila përmban të dhëna të rreme ose mundëson përpilimin e dokumentit, regjistrin ose shkresës së tillë me përmbajtje të rreme, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

2. Personi zyrtar i cili shfrytëzon dokumentin zyrtar, regjistrin ose shkresën zyrtare të rreme si të vërtetë në veprimtarinë e tij afariste ose i cili asgjëson, fsheh, dëmton apo në ndonjë mënyrë tjetër e bën të papërdorshëm dokumentin zyrtar, regjistrin ose shkresën zyrtare, dënohet me dënimin nga paragrafi 1. i këtij neni.¹³²

Nisur nga fakti se falsifikimi i dokumenteve zyrtare shërben kryesisht për kryerjen ose për fshehjen e ndonjë veprë tjetër penale, kjo vepër penale shpesh kryhet në bashkim me vepra të tilla, si, p.sh., me veprën e marrjes së ryshfetit, të shpërdorimit, mashtrimit në detyrë etj.. Praktika gjyqësore pranon edhe konstruktin e veprës penale të vazhduar të falsifikimit të dokumentit zyrtar. Përpos dokumentit zyrtar, librave (regjistrave) apo shkresave zyrtare, të cilat i janë besuar personit zyrtar për kryerjen e detyrës zyrtare dhe përbëjnë objekt të kryerjes së këtyre veprave penale, konsiderohet se kjo vepër penale mund të kryhet edhe në raport me dokumentin privat a me një dokument tjetër publik, nëse ato i janë bashkëngjitur dokumentit zyrtar, librit apo shkresës zyrtare.¹³³

3.1.15. Arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme

Arkëtimi i kundërligjshëm si formë e kësaj veprë penale kryhet në dy variante: a.) kur personi zyrtar ose përgjegjës arkëton nga personi i cili fare nuk ka qenë i obliguar të paguaj; dhe b.) kur arkëton më tepër se që personi tjetër ka qenë i obliguar të paguaj.¹³⁴ Kjo vepër penale kryhet nga personi zyrtar, d.m.th., subjekt i kësaj veprë penale është personi zyrtar.

¹³¹ Instituti Gjyqësor i Kosovës, Kodi Penal i Republikës së Kosovës. Prishtinë, 2016, fq. 283

¹³² Kodi Penal i Republikës së Kosovës_ Kodi Nr. 06/L-074, neni 427

¹³³ Ismet Salihu / Hilmi Zhitija / Fejzullah Hasani, op. cit, fq. 1269

¹³⁴ Ismet Salihu. E Drejta Penale – pjesa e posaçme, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, Prishtinë, 2021, f. 681



1. *Personi zyrtar i cili arkëton nga tjetri diçka që personi i tillë nuk është i detyruar të paguajë ose arkëton më shumë se që personi i tillë është i detyruar të paguajë apo që gjatë pagesës ose dërgesës, paguan ose dërgon më pak se që është dashur, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.*
2. *Nëse vlera e pagesës apo dërgesës nga paragrafi 1. i këtij neni tejkalon shumën prej pesëmbëdhjetë mijë (15.000) Euro, kryesi dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.*
3. *Tentativa për të kryer veprën penale nga paragrafi 1. i këtij neni është e dënueshme.*¹³⁵

Në variantin e parë, zyrtari publik arkëton të hyra monetare nga personi tjetër edhe pse nuk ekziston baza ligjore për arkëtim të tillë. Ndërsa në rastin e dytë, ekziston baza juridike për pagesën e detyrimeve të caktuara financiare, por zyrtari publik, arkëton shumë më të lartë monetare se sa është i obliguar të paguaj personi tjetër.

3.1.16. Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor

Kjo veprë penale është e posaçme pasi që përveç shpërdorimit të detyrës zyrtare, ka edhe elemente të figurës së veprës penale të vjedhjes. Në këtë rast personat zyrtar, duke kryer detyrën e tyre ligjore, e keqpërdorin detyrën zyrtare dhe përvetësojnë të mira materiale për vete ose për tjetrin. Subjekt i kësaj veprë penale janë zyrtarët publik. Objekt i veprës penale janë sendet e luajtshme. Për konsumimin e kësaj veprë penale, duhet të jetë shkaktuar pasoja – të jetë marrur sendi i personit/ave të cilët u bastiset lokali.

*Personi zyrtar i cili gjatë bastisjes së lokaleve, personit apo gjatë ekzekutimit të vendimit gjyqësor, merr pasurinë e luajtshme me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete ose për personin tjetër, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.*¹³⁶

Sipas tekstit ligjor, veprën e kryen personi zyrtar, i cili me rastin e kontrollimit të banesës, të lokaleve apo personit, ose me rastin e zbatimit të përmbarimit, merr sendin e luajtshëm me qëllim që, me përvetësimin e tij, t'i sjellë vetes apo tjetrit përfitim të kundërligjshëm. Fjala është për vjedhje në detyrë, në kryerjen e punëve zyrtare, duke keqpërdorur pozitën zyrtare, ngase këtu nuk bëhet fjalë për sendet që i janë besuar personit zyrtar.¹³⁷

¹³⁵ Kodi Penal i Republikës së Kosovës_ Kodi Nr. 06/L-074, neni 428

¹³⁶ Kodi Penal i Republikës së Kosovës_ Kodi Nr. 06/L-074, neni 429

¹³⁷ Ismet Salihu / Hilmi Zhitija / Fejzullah Hasani, op. cit, fq. 1273



3.1.17. Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare

Kjo vepër penale paraqet një zgjidhje të re ligjore në drejtësinë penale të Republikës së Kosovës. Kjo vepër ndërlidhet me procedurën e deklarimit të pasurisë për zyrtarët publik të paraparë me Ligj për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave, Ligji nr. 08/L-108. Ky ligj i parasheh subjektet të cilat janë të detyruara të deklarojnë pasurinë në baza vjetore të rregullt, me rastin marrjes së detyrës dhe me rastin e lënies së detyrës.

- 1. Çdo person, i cili sipas ligjit është i detyruar të bëjë deklarimin e pasurisë, të të ardhurave, të dhuratave, të dobisë tjetër pasurore ose të detyrimeve financiare, dhe i cili nuk bën një gjë të tillë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet. Vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni konsiderohet se është kryer kur deklarata nuk paraqitet brenda afatit për paraqitjen e deklaratës.*
- 2. Çdo person, i cili sipas ligjit është i detyruar të bëjë deklarimin e pasurisë, të të ardhurave, të dhuratave, të dobisë tjetër pasurore ose të detyrimeve financiare, i cili bën deklaratë të rreme ose nuk paraqet të dhënat e kërkuara në deklaratë, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet. Gjybat e shqiptuara sipas këtij neni mund të jenë ditore dhe mund të shqiptohen derisa kryesi të përfill urdhrin, vendimin apo aktgjykimin e plotfuqishëm që është subjekt i veprimit.*
- 3. Vlera e padeklaruar ose e deklaruar rrejtshëm e pasurisë, të ardhurave, dhuratave ose të dobisë tjetër pasurore, konfiskohet.¹³⁸*

Sipas paragrafit të parë të këtij neni, zyrtarët publik kryejnë vepër penale nëse nuk e deklarojnë fare pasurinë apo e deklarojnë pas afatit të paraparë me Ligj për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave.

Paragrafi i dytë e inkriminon si vepër të veçantë penale edhe deklarimin e rremë të pasurisë apo të dhuratave.

Ndërsa e veçanta e paragrafit të tretë është parashihet konfiskimi i pasurisë së pa deklaruar apo të pasurisë së deklaruar rrejtshëm. Bashkë me aktgjykimin dënues, ky nen përcakton edhe konfiskimin e pasurisë.

Duke u bazuar në këtë nen, Agjencia për parandalimin e korrupsionit, ka paraqitur kallëzime penale të shumta ndaj zyrtarëve publik si subjekte të kësaj vepre penale dhe prokuroria ka ngritur aktakuza penale. Pra, baza e ngritjes së aktakuzës për këto vepra penale

¹³⁸ Kodi Penal i Republikës së Kosovës_ Kodi Nr. 06/L-074, neni 430



vjen nga kallëzimi penal që paraqitet nga Agjencia për parandalimin e korrupsionit. Gjykatat e Kosovës kanë shqiptuar sanksione penale për këtë vepër penale, por dënimet kryesisht kanë qenë me gjobë dhe asnjë rast i konfiskimit të pasurisë së pa deklaruar nuk është raportuar.

3.2. Ligji për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit

Ligji për Agjencinë për parandalimin e korrupsionit është miratuar me 1 korrik 2022 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 19 / 21 korrik 2022, Prishtinë) dhe ka hyrë në fuqi në muajin gusht në të njëjtin, përjashtimisht nenet 25, 26 dhe 27 të këtij ligji kanë filluar të zbatohen gjashtë (6) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Ligji i ri ka shfuqizuar Ligjin për Agjencinë kundër korrupsionit Ligji nr. 03/L- 159.

“Ky ligj ka për qëllim që të rregullojë statusin, mënyrën e organizmit, kompetencat Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, si organ i pavarur i specializuar në parandalimin e korrupsionit”.¹³⁹ Pra ligji vazhdon veprimtarinë e Agjencisë, me dallimin nga ligji i kaluar i cili e titullonte “Agjencia kundër korrupsionit”, Ligji i ri e quan “Ligji për Agjencinë për parandalimin e korrupsionit. Pra, ligji i ri i jep ma shumë karakter preventiv Agjencisë, edhe pse ky institucion ka të drejtë të shqiptojë gjopa administrative me të cilat realizohet edhe karakteri represiv i punës së saj. Agjencia udhëhiqet nga Drejtori i cili zgjidhet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me mandat 5 vjeçar, në përputhje me dispozitat e nenit 11 të Ligji nr. 08/L-017 për Agjencinë për parandalimin e korrupsionit.”¹⁴⁰

Krejt veprimtaria e punës së Agjencisë është procedurë administrative dhe sanksionet e shqiptuara janë dënime administrative. Agjencia ka të drejtë të zhvillojë hetime, të jep këshilla juridike dhe të nxjerr vendime për konfliktin e interesit dhe të shqiptojë sanksione ndaj subjekteve në përputhje me kompetencat e përcaktuara me nenin 5 të ligjit. Ndër të tjera, Agjencia ka kompetenca për:

“1.1. Zbatimin e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave dhe Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve që përfshijnë:

¹³⁹ Ligji për Agjencinë për parandalimin e korrupsionit, Ligji nr. 08/L-017, neni 1

¹⁴⁰ Ibid, neni 11



- 1.1.1. Mbikëqyrjen dhe parandalimin e rasteve të konfliktit të interesit dhe marrjen e masave të parapara me ligjin e veçantë;
- 1.1.2. Mbikëqyrjen e deklarimit të pasurive siç parashihet me ligj;
- 1.1.3. Mbikëqyrjen e pranimit të dhuratave që lidhen me kryerjen e detyrës zyrtare dhe ndërmarrjen e masave të parapara me ligj;
- 1.1.4. Dhënien e mendimeve lidhur me konfliktin e interesit dhe mbikëqyrjen e dhuratave që lidhen me kryerjen e detyrës zyrtare;
- 1.1.5. Mbikëqyrjen dhe marrjen e masave të nevojshme për mbrojtjen e sinjalizuesve.....]”.¹⁴¹

Pra, roli i agjencisë shihet në zbatimin e ligjeve të cilat indirekt ndikojnë në parandalimin e korrupsionit.

3.3. Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

Konflikti i interesit është temë brenda kornizës së temave që kanë për qëllim luftimin dhe parandalimin e dukurive antiligjore dhe antidemokratike në sferën institucionale. Si i tillë, rregullimi i shmangies së konfliktit të interesit përbën një nga tri shtyllat themelore në fushën kundër korrupsionit, paralelisht me Deklarimin e Pasurisë dhe Konfiskimin e Pasurisë.¹⁴²

Vendet e zhvilluara në njëzetvjeçarin e fundit i kanë kushtuar rëndësi të konsiderueshme përmirësimit të këtij aspekti. Marrë në përgjithësi, trendet kryesore në fushën e konfliktit të interesit në 20 vitet e fundit përfshijnë:

- a) Tendencën për përkufizime të qarta të konfliktit të interesit;
- b) Nxitjen e një kodi të ri të sjelljes;
- c) Përmirësimin dhe thjeshtësimin e standardeve në mënyrë që të gjejnë aplikim në shkallë të gjërë;
- d) Zgjerimin e shkallës së përfshirjes së zyrtarëve të lartë publikë në organet administrative e jo vetëm ato politike;
- e) Përforsimin e monitorimit dhe parandalimit;
- f) Kampanja vetëdijesimi.¹⁴³

¹⁴¹ Ligji për Agjencinë për parandalimin e korrupsionit, Ligji nr. 08/L-017, neni 5/1

¹⁴² Organizata për Demokraci, Antikorrupsion dhe Dinjitet, Çohu! Parandalimi i konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. F. 12

¹⁴³ Ibid



Për të kompletuar bazën ligjore në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Ligji Nr. 06/L -011. Ligji ka shfuqizuar të vjetrin dhe është në përputhje me standardet ndërkombëtare për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike. Ligji ka për qëllim “forcimin e integritetit të sektorit publik dhe garantimi i kryerjes së detyrave publike në mënyrë objektive, të paanshme dhe transparente në shërbim të interesit publik nëpërmjet identifikimit, parandalimit, menaxhimit dhe zgjidhjes së konfliktit të interesave të zyrtarëve”¹⁴⁴.

Sipas këtij ligji, “konflikt interesi lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare”¹⁴⁵. Për përcaktimin e konfliktit të interesit është e rëndësishme të përcaktohet *person i afërm me zyrtarin*. Ligji e ka sqaruar në mënyrë precize këtë fakt. Sipas nenit 3 pika 1.6: Person i afërm me zyrtarin – bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adoptuesi, i adoptuari, i afërmi në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë si dhe çdo person fizik apo juridik i cili ka pasur ose ka një lidhje të përbashkët interesi privat pasuror ose jopasuror me zyrtarin. Për qëllime të këtij ligji, personi juridik konsiderohet si person i afërm, sipas dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.¹⁴⁶

Ligji ka paraparë edhe institucionet kompetente për monitorimin dhe parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike. Në radhë të parë, kjo detyrë u takon “udhëheqësve të drejtpërdrejt të zyrtarëve sipas hierarkisë brenda një institucioni dhe institucionet dhe autoritetet udhëheqëse sipas ligjit”¹⁴⁷. Institucionet publike duhet të miratojnë rregullore të brendshme në përputhje me këtë ligj për të shmangur çfarëdo pa pajtueshmërie në ushtrimin e funksionit publik (konflikt interesi). Rolin kryesor në parandalimin e konfliktit të interesit e ka Agjencia për parandalimin e korrupsionit ashtu siç përcaktohet me nenin 21 të këtij ligji.

Në botë ka sisteme që përfshijnë në masë të madhe zyrtarët politikë dhe ata që emërohen për pozita drejtuese, pastaj sisteme që përfshijnë zyrtarët politikë dhe shërbyesit civil, si dhe

¹⁴⁴ Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Ligji Nr. 06/L -011, neni 1

¹⁴⁵ Ibid, neni 6

¹⁴⁶ Ibid, neni 3 pika 1.6

¹⁴⁷ Ibid neni, 20/2



sisteme që përfshijnë zyrtarët politikë, shërbyesit civilë dhe administrativë si dhe “shërbyesit publikë” (rasti i Koresë). Megjithatë, është shumë vështirë të gjesh ndonjë model të kategorizuar me ndarje strikte. Modelet ekzistuese përgjithësisht janë modele të përziera sa i përket shtrirjes në kategorizimin e zyrtarëve. Po ashtu ka edhe modele të përziera sa i përket shtrirjes në kategorizimin e pushtetit qendror dhe lokal.¹⁴⁸ Kosova bën pjesë në grupin e vendeve që kanë themeluar institucion kompetent për monitorimin e zbatimit të ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit. Këtë funksion dhe kompetencë në radhë të parë e ka Agjencia për parandalimin e korrupsionit.

3.4. Ligj për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave

Deklarimi i pasurisë dhe interesave tjera financiare nga zyrtarët publikë përdoret gjerësisht për të ndërtuar integritetin dhe luftimin korrupsionit. Për të qenë të dobishme, deklarimi i pasurisë dhe interesave tjera duhet të përfshijë informacionin që lejon gjurmimin e të gjitha asetet dhe interesat e rëndësishme të zyrtarëve publik. Informacioni i dhënë duhet gjithashtu të theksojë ndryshime të rëndësishme në pasuri që të ardhurat e ligjshme nuk mund t'i shpjegojnë dhe zbulojnë interesa që mund të jenë në konflikt me detyrat zyrtare të parashtruesit.¹⁴⁹

Ligj për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave, Ligji nr. 08/L-108, ka hyrë në fuqi me 10 mars të vitit 2023. Ligji i ri ka shfuqizuar Ligjin për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, Ligji Nr. 04/L-050. Ligji në esencë ka për objektive që duke bërë deklarimin e pasurisë zyrtarët publikë të parandalojë korrupsionin. Gjithsej ka 29 nene dhe synon të krijojë një sistem ligjor të deklarimit të rregullt të pasurisë dhe dhuratave nga zyrtarët publik. “Ky ligj ka për qëllim përcaktimin e sistemit të deklarimit të pasurisë, duke përfshirë mënyrat dhe procedurat e deklarimit të pasurisë dhe të dhuratave, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së deklaruar dhe të dhuratave, si dhe subjektet deklaruese me qëllim të parandalimit të korrupsionit, konfliktit të interesit dhe fuqizimin e

¹⁴⁸ Organizata për Demokraci, Antikorrupsion dhe Dinjitet, Çohu! Parandalimi i konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. F. 15

¹⁴⁹ <https://thedocs.worldbank.org/en/doc/419301611672162231-0090022021/original/AssetandInterestDeclarations.pdf>.



integritetit të institucioneve publike, përfshirë edhe sanksionimin.”¹⁵⁰ Institucion kompetent për zbatimin e këtij ligji është Agjencia për parandalimin e korrupsionit. Ligji në neni e katër (4) përcakton se kush janë zyrtarët e lartë të cilët obligohen të bëjnë deklarin e pasurisë dhe dhuratave.

Sipas Ligjit, subjektet deklaruese duhet të bëjnë deklarin e pasurisë në këto raste: “Deklarimi i pasurisë nga subjektet deklaruese bëhet në rastet si në vijim: a.) deklarimi me marrje të detyrës; b.) deklarimi i rregullt vjetor; c.) deklarimi pas mbarimit ose shkarkimit nga funksioni publik.”¹⁵¹

¹⁵⁰ Ligj për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave, Ligji nr. 08/L-108, neni 1

¹⁵¹ Ibid, neni 7



3.5. Analizë krahasuese (Shqipëri dhe Maqedoni e Veriut)

Në këtë kapitull si analizë krahasuese janë marrë Republika e Shqipërisë dhe Republika e Maqedonisë së Veriut. Në analizë përfshihet legjislacioni i të drejtës penale për veprën penale të korrupsionit zyrtar.

3.5.1. Analizë krahasuese me legjislacionin e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Kodi penal i Republikës së Maqedonisë Veriore në kapitullin e tridhjetë (XXX) i ka paraparë veprat penale kundër detyrës zyrtare. Nga viti 1996 kur është aprovuar Kodi i ri në Republikën e pavarur të Maqedonisë, është ndryshuar disa herë dhe ndryshimet e fundit janë bërë në vitin 2013.

Tabela nr.4. Veprat penale kundër detyrës zyrtare sipas Kodit Penal të Maqedonisë

Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë		
Kodi Penal ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 37/96). Ligji për Ndryshimet dhe Plotësimet në Kodin Penal ("Gazeta Zyrtare e Republika e Maqedonisë" nr. 80/99, 4/02, 43/03, 19/04, 81/05, 60/06, 73/06, 7/08, 139/08, 114/09, 51/11, 135/11, 185/2011, 142/2012, 166/2012, 55/2013.		
Kreu XXX		
VEPRAT PENALE KUNDËR DETYRËS ZYRTARE		
Nr.	Neni	Vepra penale
1.	353	Keqpërdorimi i pozitës dhe autoritetit zyrtar
2.	353-a	Shkelje e ruajtjes së kufirit shtetëror
3.	353-b	Dështimi për të ekzekutuar një urdhër
4.	353-c	Keqpërdorim në shërbim
5.	354	Përvetësim në shërbim
6.	355	Mashtrim në shërbim
7.	356	Duke shërbyer në shërbim
8.	357	Marrja e ryshfetit
9.	358	Dhënia e ryshfetit
10.	358-a	Dhënia e një shpërblimi për ndikim të paligjshëm



11.	359	Marrja e një çmimi për ndikim të paligjshëm
12.	359-a	Fitimi dhe fshehja e paligjshme e pasurisë
13.	359-a	Fshehja e origjinës së pasurisë së fituar në mënyrë disproporcionale
14.	360	Zbulimi i një sekreti zyrtar
15.	360-a	Keqpërdorimi i një sekreti shtetëror, zyrtar apo ushtarak
16.	361	Falsifikimi i një dokumenti zyrtar
17.	362	Mbledhja dhe pagesa e paligjshme
18.	362-a	Ndjekja penale e krimeve kundër detyrës zyrtare
19.	362-b	Dënimi i detyrueshëm me ndalim të ushtrimit të një profesioni, veprimtarie ose detyre

Burimi: Kodi penal i Republikës së Maqedonisë¹⁵²

Siç shihet, Kodi penal i Maqedonisë së Veriut, në total i parasheh 17 vepra penale që kryhen gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, përkatësisht keqpërdorimit të detyrës zyrtare si dhe 2 vepra penale të cilat kanë të bëjnë me ndjekjen penale (neni 362-a) të personave që kanë kryer vepra penale jashtë territorit të Maqedonisë nga jo shtetasit për veprat e parapara me nenet 357 (Marrja e ryshfetit); 358 (Dhënia e ryshfetit) dhe 359 (Marrja e një çmimi për ndikim të paligjshëm). Ndërsa në nenin neni 362-b, parashihet sanksioni për dënimet plotësuese me ndalimin e ushtrimit të profesionit për ata që kryejnë vepra penale në përputhje me nenet 357 (Marrja e ryshfetit); 358 (Dhënia e ryshfetit) dhe 359 (Marrja e një çmimi për ndikim të paligjshëm), në përputhje me neni 38-b (Ndalimi i drejtimit të mjetit motorik).¹⁵³

Nga sa shihet në Kodin Penal të Maqedonisë, në nenet 357 dhe 358 si vepra penale janë paraparë edhe “marrja e ryshfetit” dhe “dhënia e ryshfetit”. Vepra penale “marrja e ryshfetit” kryhet nga personi zyrtar apo përgjegjës dhe duhet të përfshijë vetëdijen e kryesit se ai/ajo po merr dhurata apo përfitime të tjera. Ndërsa, veprën penale “dhënia e ryshfetit” e kryen personi që dëshiron t’i japë ose i premtton zyrtarit një dhuratë ose përfitim tjetër në mënyrë që brenda autorizimit të tij zyrtar të kryejë veprime zyrtare që nuk duhet t’i kryejë, apo edhe ai që

¹⁵² Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë - Kodi Penal (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 37/96). Ligji për Ndryshimet dhe Plotësimet në Kodin Penal (“Gazeta Zyrtare e Republika e Maqedonisë” nr. 80/99, 4/02, 43/03, 19/04, 81/05, 60/06, 73/06, 7/08, 139/08, 114/09, 51/11, 135/11, 185/2011, 142/2012, 166/2012, 55/2013, Kreu XXX

¹⁵³ Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, op. cit, neni 362-a; 362-b dhe 38-b



ka ndërmjetësuar në këtë. Kryes i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person dhe kjo vepër konsiderohet se është kryer vetëm me faktin e premtimit apo dhënies së dhuratës, ndërsa nuk është thelbësore nëse zyrtari e ka kryer apo jo veprimin e kundërligjshëm.¹⁵⁴

Vepra e penale e paraparë me nenin 353-a (Shkelje e ruajtjes së kufirit shtetëror); neni 353-b (Dështimi për të ekzekutuar një urdhër); neni 353-b (Dështimi për të ekzekutuar një urdhër); neni 353-c (Keqpërdorim në shërbim); neni 358-a (Dhënia e një shpërblimi për ndikim të paligjshëm); neni 359-a (Fshehja e origjinës së pasurisë së fituar në mënyrë disproporcionale) dhe vepra penale nga neni 360-a (Keqpërdorimi i një sekreti shtetëror, zyrtar apo ushtarak) nuk bëjnë pjesë në grupin e veprave penale kundër detyrës zyrtare në Kodin Penal të Kosovës.

Tabela nr. 5. Krahasimi i veprave penale kundër detyrës zyrtare: Kodi Penal i Kosovës me të Maqedonisë së Veriut.

Nr.	KODI PENAL I KOSOVËS	KODI PENAL I MAQEDONISË SË VERIUT
1.	Keqpërdorimi i pozitës dhe autoritetit zyrtar (neni 414)	Keqpërdorimi i pozitës dhe autoritetit zyrtar (neni 352)
2.	Përvetësimi në detyrë (neni 418)	Përvetësim në shërbim (neni 354)
3.	Mashtrimi në detyrë (neni 419)	Mashtrim në shërbim (neni 355)
4.	Përdorimi i paautorizuar i pasurisë neni (neni 420)	Duke shërbyer në shërbim (neni 356)
5.	Marrja e ryshfetit (neni 421)	Marrja e ryshfetit (neni 357)
6.	Dhënia e ryshfetit (neni 422)	Dhënia e ryshfetit (neni 358)
7.	Ushtrimi i ndikimit (424)	Marrja e një çmimi për ndikim të paligjshëm (neni 359)
8.	Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare (neni 430)	Fitimi dhe fshehja e paligjshme e pasurisë (neni 359-a)
9.	Zbulimi i fshehtësisë zyrtare (neni 426)	Zbulimi i një sekreti zyrtar (neni 360)
10.	Falsifikimi i dokumentit zyrtar (neni 427)	Falsifikimi i një dokumenti zyrtar (neni 361)
11.	Arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme (neni 428)	Mbledhja dhe pagesa e paligjshme (neni 362)

¹⁵⁴ Ismail Zejneli, Jeton Shasivari & Albana Metaj-Stojanova. Corruption as a form of Organized Crime. International Journal of Humanities and Social Science Vol. 4 No. 2 [Special Issue – January 2014], pg. 102



Tabela e krahasimi na jep të dhëna të sakta se ndërmjet dy kodeve penale ekzistojnë ngjashmëri tek 11 vepra penale.

Tabela nr. 6. Veprat penale kundër detyrës zyrtare të cilat nuk parasheh Kodi Penal i Maqedonisë së Veriut dhe parashihen me Kodin Penal të Kosovës

Nr.	Kodi Penal i Republikës së Kosovë
1.	Keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik (neni 415)
2.	Keqpërdorimi i informatës zyrtare (neni 416)
3.	Konflikti i interesit (neni 417)
4.	Dhënia e ryshfetit zyrtarit publik të huaj apo personave të huaj zyrtar (neni 423)
5.	Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore (neni 425)
6.	Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor (neni 429)

Nga tabela nr. 6, shihet se ekzistojnë 6 vepra penale të cilat nuk i parasheh Kodi Penal i Maqedonisë së Veriut në dallim prej KP të Kosovës.

3.5.2. Analizë krahasuese me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë

Bazën e legjislacionit penal për ndjekjen dhe ndëshkimin e kryerësve të veprave penale që ndërlidhen me korrupsionin dhe shpërdorimin e detyrës zyrtare, në Republikën e Shqipërisë e përbën Kodi Penal. Kodi penal i Shqipërisë i ka të shpërndara dispozitat e veprës penale të korrupsionit në disa kapituj të ndryshëm, për dallim prej Kosovës. Kjo shpërndarje në kapituj të ndryshëm të veprave penale të korrupsionit e bën të vështirë edhe për praktikën gjyqësore edhe për studiuesit ti qasen analizës së veprave të tilla penale. Veprat e tilla penale përfshihen në katër (4) kapituj të ndryshëm të Kodit Penal. Kodi Penal nga viti 1995 kur është miratuar pas rënies së sistemit komunist, është ndryshuar ndër vite dhe ndryshimet janë përfshirë në Kodin e vitit 1995. Kjo mënyrë e përfshirjes së ndryshimeve në Kodin e parë të miratuar, shpesh e bën të paqartë Kodin edhe për sistemin gjyqësor në tërësi. Në Republikën e Kosovës, ekziston një praktikë tjetër e ndryshimeve legjislative. Nëse ligji ndryshohet në masë të caktuar, atëherë miratohet komplet ligj i ri dhe nuk inkorporohen ndryshimet në ligjin aktual. Ndryshim tjetër i ndryshimeve legjislative në Kosovë në dallim prej Shqipërisë, është se miratimi i ndryshimeve të ligjit, bëhet përmes miratimit të një ligji të ri i cili e plotëson ose ndryshon ekzistuesin.



Tabela nr.7. Veprat penale që ndërlidhën me korrupsionin në Republikën e Shqipërisë.

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë_		
Miraturar me ligjin nr.7895, datë 27.1.1995		
SEKSIONI II		
VEPRA PENALE KUNDËR VEPRIMTARISË SHTETËRORE TË KRYERA NGA PUNONJËSIT SHTETËRORE OSE NË SHËRBIM PUBLIK		
Nr.	Neni	Vepra penale
1.	248	Shpërdorimi i detyrës
2.	257	Përfitimi i paligjshëm i interesave
3.	258	Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike
4.	259	Kërkim për dhënie mite
5.	260	Marrja e mitës
KREU VIII		
KRIME KUNDËR AUTORITETIT TË SHTETIT SEKSIONI I VEPRA PENALE KUNDËR VEPRIMTARISË SHTETËRORE TË KRYERA NGA SHTETASIT		
1.	244	Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike
2.	244/a	Korrupsioni aktiv i nëpunësve të huaj publikë
3.	245	Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë
4.	245/1	Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike
KREU IX		
VEPRA PENALE KUNDËR DREJTËSISË		
1.	312	Korrupsioni aktiv i dëshmitarit, i ekspertit ose përkthyesit
2.	319	Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë
3.	319/a	Korrupsioni aktiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare
4.	319/b	Korrupsioni aktiv i arbitrit vendas dhe të huaj
5.	319/c	Korrupsioni aktiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja
6.	319/ç	Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë
7.	319/d	Korrupsioni pasiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare
8.	319/dh	Korrupsioni pasiv i arbitrit vendas dhe të huaj
9.	319/e	Korrupsioni pasiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja



SEKSIONI IV		
VEPRA PENALE TË KRYERA NË SHOQËRITË TREGTARE		
	164/a	Korrupsioni aktiv në sektorin privat
	164/b	Korrupsioni pasiv në sektorin privat

Burimi: Kodi penal i Republikës së Shqipërisë¹⁵⁵

3.5.2.1. Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik

Në këtë grup të veprave penale bëjnë pjesë pesë vepra penale që ndërlidhën me keqpërdorimit të funksioneve publike.

Vepra penale e “*Shpërdorimi i detyrës*” sipas nenit 248 të Kodit penal të Shqipërisë është e njëjtë me veprën penale “*Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar*” sipas Kodit penal të Kosovës. Vepra penale “*Përfitimi i paligjshëm i interesave*” është e njëjtë me veprën penale “*përvetësimi në detyrë*” e paraparë me Kodin Penal të Kosovës. Vepra penale “*Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike*” është e krahasueshme me veprën penale “*Keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik*” e paraparë me Kodin penal të Kosovës.

Vepra penale “*Kërkim për dhënie mite*” nuk është e paraparë me Kodin Penal të Kosovës, por është paraparë vepra penale e marrjes së ryshfetit dhe dhënies së ryshfetit. Kodi penal i Kosovës nuk e ka inkriminuar si vepër penale të veçantë kërkimin për mito.

3.5.2.2. Krime kundër autoritetit të shtetit, seksioni i vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit

Në kreun VIII [Krime kundër autoritetit të shtetit seksioni i vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit], janë paraparë gjithsej katër (4) vepra penale që

¹⁵⁵ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë_ Miratuar me ligjin nr.7895, datë 27.1.1995, i ndryshuar me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 21; ndryshuar me ligjin nr.9686, datë 26.2.2007, neni 21; pjesa që parashikon edhe dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim, shfuqizohet me ligjin nr.144, datë 2.5.2013.



ndërlidhen me korrupsionin: Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike; Korrupsioni aktiv i nëpunësve të huaj publikë; Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë; dhe Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike¹⁵⁶.

Dy veprat e para penale (nenet 244; 244/a), kanë dallime në emërtim me Kodin penal të Kosovës. Figura e këtyre veprave penale bën pjesë në vepra tjera penale në Kodin penal të Kosovës. Vepra penale *“Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”*, përbën elemente të veprës penale *“dhënia e ryshfetit”*, ashtu sikurse vepra penale *“Korrupsioni aktiv i nëpunësve të huaj publikë”* përbën elemente të veprës penale *“Dhënia e ryshfetit zyrtarit publik të huaj apo personave të huaj zyrtar”* sipas Kodit penal të Kosovës. Vepra penale *“Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”* përbën elemente të figurës së veprës penale *“ushtrimi i ndikimit”* e paraparë me Kodin penal të Kosovës.

3.5.2.3. Vepra penale kundër drejtësisë

Në këtë grup të veprave penale bëjnë pjesë veprat penale të cilat kryhen brenda sistemit të drejtësisë (në sistemin gjyqësor dhe prokurorial)¹⁵⁷. Kodi penal i Kosovës nuk i ka inkriminuar si veprime të veçanta penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare në sistemin e drejtësisë. Por, kjo nuk do të thotë se veprimet e tilla nuk përbëjnë vepra penale. Veprimet e tilla të kundërligjshme përbëjnë figura të veprave penale të parapara me vepra penale tjera të inkriminuara me Kodin penal të Kosovës. Këto vepra penale nuk janë paraparë në grupin e *“veprave penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike”*. Vepra penale *“Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë”*, përbën elemente të veprës penale nga neni 425 i Kodit Penal të Kosovës *“Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore”*. Kjo vepër është renditur në grupin e veprave penale të korrupsionit zyrtar në Kodin Penal të Kosovës.

¹⁵⁶ Ibid, nenet 244; 244/a; 245; 245/1

¹⁵⁷ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë_ Miratuar me ligjin nr.7895, datë 27.1.1995, nenet 312; 319; 319/a; 319/b; 319/c; 319/ç; 319/d; 319/dh; 319/e



Mendimi jonë është se ky grup i veprave penale do të ishte mirë të parashihej edhe në Kodin Penal të Kosovës. Kjo do të mundësonte inkriminime të veçanta të veprave penale që kryhen në sistemin e drejtësisë.

3.5.2.4. Vepra penale të kryera në shoqëritë tregtare

Në këtë grup të veprave penale, të cilat siç shihet kryhen në sektorin privat dhe duke ushtruar funksione drejtuese në shoqëritë tregtare, janë paraparë dy vepra penale: Korrupsioni aktiv në sektorin privat dhe Korrupsioni pasiv në sektorin privat.¹⁵⁸ Të dy veprat penale por me emërtime të ndryshme (pranimi i ryshfetit në sektorin privat dhe dhënia e ryshfetit në sektorin privat). Në Kodin penal të Kosovës, këto dy vepra penale janë renditur në grupin e veprave penale kundër ekonomisë¹⁵⁹. Këto vepra penale kryhen në sektorin privat dhe nuk kanë të bëjnë me keqpërdorimin e detyrës zyrtare nga zyrtarët publik. Kjo është e veçanta e këtyre veprave penale.

¹⁵⁸ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë_ Miratuar me ligjin nr.7895, datë 27.1.1995, nenet 164/a dhe 164/b

¹⁵⁹ Kodi penal i Kosovës, Kodi nr. 06/L-074, nenet 309 dhe 310



Kapitulli i katër

4.0. BASHKËPUNIMI INSTITUCIONAL PËR LUFTIMIN E KORRUPSIONIT

Korrupsioni si fenomen i përhapur dhe prezent dhe si dukuri shqetësuese, luftohet në mënyrë efikase përmes bashkëpunimit institucional.

Programi Global i Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, promovon një përpjekje të bashkërenduar bazuar në gjashtë shtylla: (1) reforma demokratike; (2) një shoqëri e fortë civile me qasje në informacion dhe një mandat për të mbikëqyrur shtetin; (3) prania e shtetit të së drejtës që do të thotë parashikueshmëria, stabiliteti dhe koherenca në interpretimin dhe zbatimin e ligjit; (4) kontrole dhe ekuilibra të rritur përmes rritjes së pranisë dhe ekuilibrit ndërmjet përgjegjësisë institucionale dhe pavarësisë së bashku me një besim të shtuar të publikut në agjencitë anti-korrupsion; (5) partneritete të reja strategjike kombëtare dhe ndërkombëtare për të mbrojtur dhe mbështetur zbatimin e politikave dhe masave kombëtare dhe ndërkombëtare anti-korrupsion dhe (6) partneritete të reja strategjike kombëtare dhe ndërkombëtare për të zhvilluar strategji të përbashkëta për zbatimin e politikave dhe masave ndërkombëtare dhe kombëtare anti-korrupsion¹⁶⁰.

Sipas një studimi të Freedom House paraqitja në rritje i korrupsionit nuk ka arritur të frymëzojë përpjekje më energjike ose përmbajtjesore antigraft në Kosovë, ku autoritetet janë përqendruar në krijimin e institucioneve të reja sesa në zbatimin e një strategjie ekzistuese antikorrupsion¹⁶¹, e që nënkupton se janë krijuar institucione të panevojshme. Këtu vlen të përmendet se, më 23 mars 2018, Qeveria ka miratuar Strategjinë Kombëtare kundër Korrupsionit 2018-2022 (në vijim: Strategjia Kombëtare për LKK) dhe Planin e Veprimit (Vendimi nr. 02/37). Plani i veprimit përkatës përmban masa specifike, përcakton ministritë dhe institucionet përgjegjëse si dhe përcakton afatet për zbatimin e tyre. Ai është i organizuar

¹⁶⁰ United Nations Manual On Anti-Corruption Policy, Prepared by the Global Programme against Corruption, Centre for International Crime Prevention, Office of Drug Control and Crime Prevention, United Nations Office at Vienna, 2001, fq.17

¹⁶¹ Freedom House, Nations in Transit, 2013, fq. 8



sipas katër fushave të veprimit, përkatësisht: 1) sektori politik; 2) administrata publike; 3) zbatimi i ligjit dhe gjyqësori; 4) prokurimi publik dhe menaxhimi i financave publike¹⁶².

Legjislacioni vendor për bashkëpunimin në mes të Policisë së Kosovës dhe Prokurorisë në hetimin e korrupsionit është saktësisht i përcaktuar dhe i specifikuar në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, nga Ligji për Policinë dhe Ligjin për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë. Sipas Kodit të Procedurës Penale (KPP), roli kryesor në hetimin e krimeve është i paraparë për Prokurorinë e shtetit mbështetur nga policia për kryerjen e duhur të hetimeve. Prokurori i Shtetit varet nga policia, por jo ekskluzivisht, siç thuhet në KPP " Prokurori i shtetit mund të fillojë hetimin në bazë të kallëzimit të policisë apo burimeve tjera, nëse ka dyshim të arsyeshëm se vepra penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare ose me propozim të të dëmtuarit është kryer, po kryhet ose ka gjasë që të kryhet në një të ardhme të afërt. "¹⁶³. Megjithatë, në procesin e hetimit të dy organet do të punojnë së bashku në hapat e parë. Prokuroria drejton dhe mbikëqyr punën e policisë dhe organeve të tjera që kryejnë hetimet penale, pasi që një masë e tillë është e autorizuar ose inicohet përderisa ka edhe të drejtë për qasje në të gjitha informatat relevante hetimore të cilat policia i posedon. Problemet ndodhin gjatë bashkëpunimit praktik që shkaktohet nga mungesa e bazës së të dhënave të përbashkët dhe menaxhimi jo i koordinuar rasteve korruptive nën hetim.

Tabela 8. Paraqitja tabelore e institucioneve kompetente për luftimin e korrupsionit

Institucioni		
Policia e Republikës së Kosovës		
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë	Drejtoritë Rajonale të Policisë	Stacionet Policore Lokale
Departamentet: 1. Departamenti i operacioneve; 2. Departamenti i hetimeve; 3. Departamenti për kufi; 4. Departamenti i shërbimeve mbështetëse; 5. Departamenti i shërbimeve të përbashkëta.	Prishtinë, Mitrovicë Jug, Mitrovicë Veri, Prizren, Pejë, Gjilan, Ferizaj dhe Gjakovë	Në komunat e vogla
Departamenti i Hetimit:		

¹⁶² RAPORT I VLERËSIMIT për pajtueshmërinë me standardet ndërkombëtare në fushën e luftës kundër korrupsionit (LKK), Këshilli i Evropës, Prishtinë, Dhjetor 2018, fq.18

¹⁶³ Kodi i Procedurës Penale_Kodi nr. 08/L-032, neni 100



Drejtoria për hetimin e krimeve ekonomike dhe të korrupsionit			
Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit			
Drejtori i Përgjithshëm			
Departamentet			
Departamenti për luftimin e korrupsionit	Departamenti për parandalimin e korrupsionit	Departamenti për parandalimin e konfliktit të interesit	Departamenti për financa dhe punë të përgjithshme
- Divizioni për hetim dhe analiza; - Divizioni për hetime dhe strategji; - Divizioni për mbrojtjet e sinjalizuesve dhe hetime	- Divizioni për deklarimin e pasurisë dhe dhuratave; - Divizioni për parandalimin e korrupsionit në prokurimin publik.	- Divizioni për parandalimin e konfliktit të interesit për zyrtarët e lartë dhe autoritetet përgjegjëse; - Divizioni për parandalimin e konfliktit të interesit për autoritetet përgjegjëse dhe personat zyrtarë.	Divizioni për shërbime të përgjithshme, buxhet dhe financa
Dogana e Kosovës			
Njësia për Standarde Profesionale	Njësi i Inspektimit të Brendshëm	Drejtoria e zbatimit të ligjit: - Sektori për hetim; - Sektori i inteligjencës	
Administrata Tatimore e Kosovës			
Standardet Profesionale	Njësia e hetimeve		
Këshilli Prokurorial i Republikës së Kosovës			
Prokurori i Shtetit			
Prokuroria themelore	Prokuroria e Apelit	Prokuroria speciale	
- Departamenti i Përgjithshëm; - Departamentet për Krime të Rënda; - Departamenti për të Mitur.	- Departamenti i Përgjithshëm; dhe - Departamenti për Krime të Rënda.	- Departamenti kundër korrupsionit	
Këshilli Gjyqësor i Kosovës			
Sistemi gjyqësor i Republikës së Kosovës			



Gjykatat themelore	Gjykata e Apelit në Prishtinë	Gjykata Supreme
Gjykata Themelore në Prishtinë: - Departamenti Special për Lëndët në Kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, me kompetencë për tërë territorin e Republikës së Kosovës. - Departamenti për Çështjet Ekonomike; - Departamenti për Çështjet Administrative që vepron në Gjykatën Themelore në Prishtinë; - Departamenti i përgjithshëm; - Departamenti për krimet e rënda; - Departamenti për të mitur.	- Departamenti i Përgjithshëm; - Departamenti për Krime të Rënda; - Departamenti special për lëndët në kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës; - Departamenti për Çështje Ekonomike; - departamenti për Çështje Administrative; - Departamenti për të Mitur.	Gjykata Supreme e Kosovës është instanca më e lartë gjyqësore në Kosovë dhe ka juridiksion në gjithë territorin e Republikës së Kosovës.
Në gjykatat tjera themelore: - Departamenti i përgjithshëm; - Departamenti për krimet e rënda; - Departamenti për të mitur.		

Nga tabela shihet se në Kosovë aktualisht ekzistojnë institucione të shumta të cilat ndër të tjera kanë kompetenca ligjore për luftimin e korrupsionit. Më rëndësi është që këto institucione të kryejnë punët e tyre ligjore dhe në këtë mënyrë mund të rezultojnë efikase në luftimin e korrupsionit.

4.1. Roli i Agjencisë për parandalimin e korrupsionit

Agjencia për parandalimin e korrupsionit është institucion i pavarur me kompetenca administrative, i specializuar, i themeluar me ligj të veçantë. Agjencia është themeluar në korrik të vitit 2006, ndërsa është funksionalizuar më 12 shkurt 2007 dhe është përgjegjëse për



zbatimin e politikës shtetërore për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në Kosovë. Në këtë drejtim, del se Agjencia ka një rol jashtëzakonisht të madh institucional në luftën kundër korrupsionit. Bazuar në ligjin për Agjencinë për parandalimin e korrupsionit, ajo ka këto përgjegjësi:

1. Agjencia është përgjegjëse për:

1.1. Zbatimin e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave dhe Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve që përfshijnë:

1.1.1. Mbikëqyrjen dhe parandalimin e rasteve të konfliktit të interesit dhe marrjen e masave të parapara me ligjin e veçantë;

1.1.2. Mbikëqyrjen e deklarimit të pasurive siç parashihet me ligj;

1.1.3. Mbikëqyrjen e pranimit të dhuratave që lidhen me kryerjen e detyrës zyrtare dhe ndërmarrjen e masave të parapara me ligj;

1.1.4. Dhënien e mendimeve lidhur me konfliktin e interesit dhe mbikëqyrjen e dhuratave që lidhen me kryerjen e detyrës zyrtare;

1.1.5. Mbikëqyrjen dhe marrjen e masave të nevojshme për mbrojtjen e sinjalizuesve.

1.2. Ndërmarrjen e veprimeve në fushën e monitorimit të planit të veprimit të strategjisë nacionale kundër korrupsionit, vlerësimit kundër- korrupsion të akteve ligjore, vlerësimeve të rrezikut të korrupsionit dhe planeve të integritetit që përfshijnë:

1.2.1. Dhënien e ndihmës profesionale dhe teknike, këshilla dhe mbështetje të iniciativave të cilat synohen të ndërmerren nga institucionet për parandalim të korrupsionit;

1.2.2. Dhënien e rekomandimeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës mbi vlerësimin e projektligjeve që lidhen me parandalimin e korrupsionit kur kjo kërkohet nga këto institucione apo me vendim të Drejtorit të Agjencisë;

1.2.3. Monitorimin e zbatimit të Strategjisë Kundër Korrupsionit dhe planit të saj të veprimit;

1.2.4. Bashkëpunimin me institucionet shtetërore dhe shoqërinë civile për vetëdijesimin e publikut për parandalimin e korrupsionit;

1.2.5. Zhvillimin dhe mbikëqyrjen e vlerësimit të rrezikut të korrupsionit;

1.2.6. Dhënien e opinioneve lidhur me aktet ligjore për qëllim të përafrimit me standardet ndërkombëtare kundër korrupsionit;

1.2.7. Monitorimin e zbatimit të planit të integritetit të institucioneve publike;



- 1.3. Kryerjen e hetimeve administrative dhe ndërmarrjen e veprimeve në rastet që bien në kuadër të kompetencave të Agjencisë;
- 1.4. Referimin e kallëzimeve penale në prokurorinë e shtetit ose në rast të shkeljes administrative përcjelljen e rastit tek organi administrativ kompetent;
- 1.5. Inicion procedurë kundërvajtëse nga fushë veprimtaria e vet në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi;
- 1.6. Shqiptimin e gjobave dhe ndërmarrjen e masave tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- 1.7. Mbledhjen, analizimin dhe publikimin e të dhënave statistikore ose të dhënave tjera që lidhen me gjendjen e rasteve që bien në kuadër të kompetencave të Agjencisë;
- 1.8. I raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës mbi punën e Agjencisë.
- 1.9. Përgatitjen dhe propozimin e buxhetit vjetor të Agjencisë;
- 1.10. Dizajnimin dhe zbatimin e mjeteve për parandalim të korrupsionit si trajnimet, hulumtimet, edukimi dhe vetëdijesimi i publikut.
- 1.11. Kryerjen e detyrave tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.¹⁶⁴

Nëse analizohen me kujdes të gjitha përgjegjësitë e këtij institucioni, atëherë kuptohet roli dhe rëndësia e tij për parandalimin dhe luftën efikase kundër korrupsionit.

Në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të veta që rrjedhin nga ligji, Agjencia ka ndërtuar edhe strategjinë e punës. Kjo strategji mbështetet në tri shtylla kryesore:

- Zbatimin e ligjit ku përfshihet përcjellja e informatave për korrupsion në Prokurorinë Publike të Kosovës si dhe hartimi i ligjeve të reja për plotësimin e kornizës ligjore në këtë fushë;
- Parandalimin ose eliminimin e shkaqeve të korrupsionit përmes kryerjes së deklartimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë, parandalimin e konfliktit të interesave dhe regjistrimit të dhuratave në organet qendrore; dhe
- Edukimin e administratës publike dhe qytetarëve mbi kornizën ligjore dhe mekanizmat aktuale anti-korrupsion, si dhe ngritjen profesionale të stafit¹⁶⁵.

Zbatimi i Ligjit është një nga tri shtyllat kryesore në të cilat mbështet strategjia e punës e Agjencisë. Zbatimi i Ligjit nënkupton hetimin e rasteve të dyshuara të korrupsionit dhe

¹⁶⁴ Ligjit për Agjencinë për parandalimin e Korrupsionit, Ligji nr. 08/L – 017, neni 5

¹⁶⁵ <https://www.akk-ks.org/agjencia/43/strategjia/43>



përcjelljen e kallëzimeve penale për veprat penale të korrupsionit në Prokurorinë e shtetit kompetente të Kosovës në rastet kur nuk inicohet procedurë penale, si dhe hartimin e ligjeve të reja për plotësimin dhe ndryshimin e kornizës ligjore në këtë fushe.¹⁶⁶

Agjencia është e strukturuar në tri departamente kryesore që kanë të bëjnë me parandalimin dhe luftimin e korrupsionit si dhe departamentin për financa dhe punë të përgjithshme. Departamentet kryesore janë: departamenti për luftimin e korrupsionit; departamenti për parandalimin e korrupsionit; departamenti për parandalimin e konfliktit të interesit. Në kuadër të departamentit për luftimin e korrupsionit është divizioni i hetimeve dhe analiza dhe divizioni për hetime dhe strategji.

Divizioni i Hetimeve në mesin e prioriteteve ka hetimin e rasteve të dyshuara të korrupsionit, si atyre që raportohen, po ashtu edhe hetimin e rasteve sipas detyrës zyrtare atëherë kur Agjencia vjen deri te informacionet e bazuara për veprime korruptive të dyshuara. Ky divizion në vazhdimësi ka studiuar dhe përcjellur trendet pozitive të zhvillimit të kornizës ligjore antikorrupsion në vendet e rajonit dhe ato evropiane, me qëllim të ndryshimit dhe plotësimit të kornizës ligjore antikorrupsion në Kosovë. Në këtë drejtim Divizioni i Hetimeve në mënyrë aktive është angazhuar në lidhje me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e korrupsionit, Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik si dhe Projektligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, duke marrë pjesë në grupet punuese ndërqeveritare. Ky divizion, gjithashtu ka marrë pjesë dhe ka dhënë kontributin e vetë, përmes komenteve profesionale, rekomandimeve konkrete si dhe duke marrë pjesë në grupet punuese gjatë amendamentimit të Kodit Penal të Kosovës sidomos sa i përket veprave penale kundër detyrës zyrtare, duke propozuar ndryshimin e veprave aktuale, shtimin e veprave të reja si dhe ashpërsimin e sanksioneve penale për këto vepra penale. Divizioni i Hetimeve ka ofruar edhe këshilla të konsiderueshme ligjore për qytetarët e ndryshëm të cilët i janë drejtuar Agjencisë për paraqitjen e ankesave të tyre.¹⁶⁷

Agjencia bashkëpunon ngushtë me Prokurorin e shtetit në adresimin e rasteve të korrupsionit. Si institucion i specializuar, ajo paraqet kallëzime penale ndaj subjekteve të ndryshme kur ekziston dyshime se kanë kryer vepra penale që ndërlidhën me korrupsionin

¹⁶⁶ https://www.akk-ks.org/luftimi_i_korrupsionit/162/zbatimi-i-ligjit/162. E shikuar për herë të fundit me 13 qershor 2023.

¹⁶⁷ <https://akk-ks.org/agjencia/76/departamenti-i-hetimeve/76>. E shikuar për herë të fundit me 13 qershor 2023.



zyrtar. Paraqitja e kallëzimeve penale i ndihmon prokurorit të shtetit që të ndërmerr hetime penale dhe ngritje të aktakuzave për veprat penale kundër detyrës zyrtare.

4.2.Roli i Policisë së Kosovës

Policia është institucion kyç për luftimin e krimit në përgjithësi dhe korrupsionit në veçanti. Shikuar në aspektin e zhvillimit historik të Policisë së Kosovës, “më 6 shtator të vitit 1999, Misioni i OSBE-së në Kosovë, në pajtim me Rezolutën e Kombeve të Bashkuara 1244, ka hapur Shkollën e policisë dhe ka filluar trajnimin e kandidatëve për pjesëtarë të Policisë së Kosovës. Gjenerata e parë e kandidatëve për pjesëtarë të këtij Shërbimi filloi trajnimin në këtë qendër më 6 Shtator 1999”¹⁶⁸. Policia është institucion kushtetutës pasi që është themeluar në përputhje me nenin 128 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. “Policia e Republikës së Kosovës mban përgjegjësinë për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike në tërë territorin e Republikës së Kosovës”¹⁶⁹.

Të gjitha autorizimet dhe detyrat e policisë së Republikës së Kosovës janë të parapara me ligjin për Policinë, i cili është nxjerrë në vitin 2012, dhe rregullon autorizimet dhe detyrat e Policisë së Republikës së Kosovës, organizimin e saj dhe çështje të tjera lidhur me aktivitetet dhe veprimet e Policisë së Republikës së Kosovës¹⁷⁰. Policia është e detyruar të bashkëpunoj ngushtë me institucionet gjegjëse në luftimin e kriminalitetit dhe ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike. Në këtë drejtim, në nenin 6 ligji ka paraparë se, Policia zbaton urdhrat dhe udhëzimet e lëshuara në mënyrë të ligjshme nga prokurori publik ose gjyqtari kompetent. Gjithashtu, Policia bashkëpunon dhe i raporton Zyrës së Prokurorit Publik kompetent për informatat lidhur me akuzat për aktivitete të dyshimta kriminale, për të cilat policia është njoftuar në pajtim me ligjin e aplikueshëm¹⁷¹.

Policia e Republikës së Kosovës gjithashtu është e obliguar me ligj që të ketë bashkëpunim me komunitetin si dhe bashkëpunim me institucionet qendrore dhe me ato lokale të qeverisjes¹⁷². Po ashtu, policia e Kosovës është e obliguar të bashkëpunoj me organizatat

¹⁶⁸ <https://www.kosovopolic.com/per-ne/historiku/>

¹⁶⁹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 18

¹⁷⁰ Neni 1 i Ligji Nr. 04/L-076 për policinë, 2 mars 2012

¹⁷¹ Neni 6, paragrafi 1 dhe 2 i Ligji Nr. 04/L-076 për policinë, 2 mars 2012

¹⁷² Shih: Nenet 7 dhe 8 të Ligjit Nr. 04/L-076 për policinë, 2 mars 2012



policore ndërkombëtare dhe me institucionet e tjera të huaja, në bazë të ligjit në fuqi ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare. Në këtë kontekst, Policia mund të dërgoj zyrtarë policorë në shërbim të përkohshëm në një organizatë tjetër policore ndërkombëtare me qëllim të kryerjes së detyrave policore jashtë vendit, në përputhje me ligjin në fuqi ose në bazë të marrëveshjes ndërkombëtare¹⁷³.

Bashkëpunimi ndërinstitucional në luftimin e kriminalitetit dhe korrupsionit në rastin tonë, është i një rëndësie të veçantë sidomos midis Policisë dhe Prokurorisë së Shtetit. Në një analizë të KIPRED-it, veç të tjerash vihet në përfundim se “kuadri ligjor për bashkëpunimin në mes të Policisë së Kosovës dhe Prokurorisë në hetimin e korrupsionit është në masë të madhe i përcaktuar dhe ai është detalisht i specifikuar nga Kodi i Procedurës Penale të Kosovës dhe nga Ligji për Policinë. Megjithatë, problemet ndodhin gjatë bashkëpunimit praktik që shkaktohet nga mungesa e bazës së duhur të të dhënave dhe menaxhimit të dosjeve të rasteve”¹⁷⁴. Po ashtu, në kontekst të bashkëpunimit institucional vlen të theksohet fakti se, Kodi i Procedurës Penale (Nr. 04/L-123) dhe Ligji për Policinë (Nr. 03/L-035) janë ligjet kryesore që parashikojnë bashkëpunimin në mes të Policisë së Kosovës dhe shërbimeve prokuroriale në Kosovë. Sipas Kodit të ri të Procedurës Penale (KPP) të Kosovës (2013), roli kryesor në hetimin e krimeve është i paraparë për shërbimet prokuroriale mbështetur nga policia për kryerjen e duhur të hetimeve¹⁷⁵.

4.3. Prokurori i shtetit

Nuk ka dyshim se ndër institucionet prijëse në luftë kundër kriminalitetit është Prokuroria e Shtetit. Prokurori i shtetit është institucion kushtetues dhe është institucion i pavarur në ushtrimin e funksioneve të veta. Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka paraparë që, “Prokurori i Shtetit është institucion i pavarur me autoritet dhe përgjegjësi për ndjekjen penale të personave të akuzuar për ndonjë vepër penale ose për ndonjë vepër tjetër, sikurse është rregulluar me ligj”¹⁷⁶.

¹⁷³ Neni 9 i Ligji Nr. 04/L-076 për policinë, 2 mars 2012

¹⁷⁴ Analizë e Shkurtër, Hetimi i Korrupsionit në Kosovë: (Mos) Bashkëpunimi në mes të Policisë dhe Prokurorisë NR. 1/14, Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave – KIPRED, Prill 2014, fq.4

¹⁷⁵ Po Aty, fq.5

¹⁷⁶ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 109, paragrafi 1



Organizimi, juridiksioni, funksionimi, kompetencat dhe detyrat e Prokurorit të Shtetit janë të parapara me ligjin për Prokurorin e Shtetit¹⁷⁷. Sipas këtij ligji detyrat dhe kompetencat e prokurorëve të shtetit përfshijnë:

1. ushtrimin e funksioneve prokuroriale në mënyrë të pavarur, të drejtë, objektive dhe të paanshme dhe të sigurohen që të gjithë personat trajtohen në mënyrë të barabartë para ligjit;
2. zbatimin e standardeve më të larta të kujdesit gjatë kryerjes së funksioneve zyrtare;
3. sjellje të ndershme dhe profesionale si në jetën personale ashtu edhe profesionale dhe bazuar në ligjin e zbatueshëm dhe kodin e etikës profesionale;
4. ruajtjen e nderit dhe dinjitetit të Prokurorit të Shtetit;
5. mbrojtjen e të drejtave ligjore të viktimave, dëshmitarëve, të dyshimtëve, të akuzuarve dhe personave të dënuar;
6. ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme juridike për zbulimin e veprave penale dhe të autorëve të krimit si dhe hetimin dhe ndjekjen me kohë të veprave penale;
7. marrjen e vendimeve mbi iniciimin, vazhdimin apo ndërprerjen e procedurës penale ndaj personave të dyshuar apo të akuzuar për kryerjen e veprave penale;
8. ngritjen e aktakuzave dhe përfaqësimin e tyre para gjykatës;
9. ushtrimin e mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve gjyqësore;
10. bashkëpunimin me policinë, gjykatat dhe institucionet e tjera;
11. ndërmarrjen e të gjitha veprimeve të tjera të përcaktuara me ligj¹⁷⁸.

Është e rëndësishme të përmendet se, Prokurori i shtetit përbëhet nga Zyra e Prokurorisë Themelore, Prokuroria Speciale, Prokuroria e Apelit dhe Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit¹⁷⁹. Në këtë rast vlen të theksohet se, “Zyra e Prokurorisë Speciale në kuadër të Prokurorit të Shtetit ka kompetencë ekskluzive për të hetuar dhe ndjekur penalisht disa vepra të rënda, përfshirë krimet e rënda të korrupsionit (që do të thotë vepra penale të korrupsionit të kryera nga zyrtarë të lartë dhe krime me vlerë të lartë monetare që gjobiten deri në 500.000 euro në përputhje me

¹⁷⁷ Ligji për Prokurorin e Shtetit, Ligji Nr. 03/L-225

¹⁷⁸ Neni 7, paragrafi 1, pikat 1.1 – 1.11, të Ligjit Nr. 03/L-225, Për Prokurorin e Shtetit, 30 shtator 2010

¹⁷⁹ Ligji Nr. 05/L-034. Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Prokurorin e Shtetit. Neni 14



nenin 46 të Kodit Penal). Kjo zyrë ka juridiksion në tërë territorin e Kosovës¹⁸⁰. Kritikata më të ashpra për mos luftim të korrupsionit çdoherë janë drejtuar tek prokurorët, ata “shpesh kritikohen për joefikasitet në luftimin e korrupsionit. Lëndët e pazgjidhura vazhdojnë të shtohen, ndërkaq një numri të rasteve kundër të dyshuarve iu kanë skaduar afatet ligjore dhe lëndët janë parashkruar”¹⁸¹. Përveç tjerash edhe profesionalizmi ngelet ndër problemet jo pak me ndikim në prokurori, andaj me të drejtë theksohet se, “janë përhapur dukshëm edhe sjelljet joprofesionale; shoqëria civile ka paraqitur mbi 600 raste disiplinore ndaj prokurorëve, të cilët akuzohen se që nga viti 2013 kanë bërë keqpërdorime të ndryshme gjatë hetimeve paraprake dhe penale”¹⁸². Gjithashtu, vlen të theksohet se, “lufta kundër korrupsionit përkeqësohet edhe më shumë kur aktakuzat të arrijnë në gjykata. Gjykatësit shpesh i shtyjnë seancat, për shkak se palët nuk paraqiten, ose për arsye se prokurorët dështojnë të ofrojnë prova ose dokumentacion të plotë. Krahas vonesave tjera, edhe këto ndikojnë në atë që gjykatat të veprojnë ngadalë”¹⁸³.

Në Kosovë, roli i prokurorit të shtetit është inicimi i hetimeve penale, zbulimi dhe marrja e provave dhe informatave, dhe përfundimisht ngritja e aktakuzave dhe ndjekja penale e personave të dyshuar për kryerje të veprave penale. Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale janë relativisht të avancuar në sanksionimin e aktiviteteve korruptive, të cilat mund të përfshijnë sa vijon: abuzimin dhe keqpërdorimin e pozitës zyrtare, mashtrimin zyrtar, marrjen dhe/apo dhënien e ryshfetit, këmbimin e ndikimit dhe shpalosjen e informative zyrtare. Procedura penale fillohet vetëm me vendim të prokurorit të shtetit kur ekziston dyshim i arsyeshëm se është kryer vepër penale ose kur është ngritur aktakuzë e drejtpërdrejtë sipas dispozitave të këtij Kodi. Prokurori i shtetit mund të fillojë procedurën penale në pajtim me paragrafin 2 të neni 6, pas marrjes së informacionit nga policia, institucioni tjetër publik, institucioni privat, qytetari, media, nga informacioni i marrë në një procedurë tjetër penale ose pas ankimit ose propozimit të të dëmtuarit ose viktimës.¹⁸⁴ Prokuroria speciale (PSRK) është themeluar në kuadër të Prokurorisë së shtetit me anë të ligjit nr. 2008/03-L052 e cila udhëheq me juridiksionin territorial, fushëveprimin, kompetencat, përbërjen dhe caktimin e

¹⁸⁰ RAPORT I VLERËSIMIT për pajtueshmërinë me standardet ndërkombëtare në fushën e luftës kundër korrupsionit (LKK), Këshilli i Evropës, Prishtinë, Dhjetor 2018, fq.24

¹⁸¹ Po aty, fq.16

¹⁸² Fighting Corruption Without Judicial Control, Prishtinë, Kosovo Law Institute, mars 2018, fq.5-6

¹⁸³ GJYQËSORI I KEQ-ADMINISTRUAR I KOSOVËS, vepra e cituar, fq.17

¹⁸⁴ Ibid neni 6, paragrafët 2 dh 3



Kryeprokurorit. PSRK-ja u bë funksionale me 9 dhjetor 2008 si një "zyrë e përhershme dhe e specializuara e prokurorisë që vepron në kuadër të Zyrës së Prokurorit të Shtetit në Kosovë". PSRK-ja administrohet nga të dy, autoritetet e Kosovës (Ministria e Drejtësisë) dhe nga EULEX-i, dhe udhëhiqet nga një prokuror i EULEX-it. Ligji i PSRK-se 38 është hartuar nën udhëheqjen e administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë gjatë vitit 2007 në mënyrë që të përmbushë nevojat e Kosovës për të luftuar krimin e organizuar, pastrimin e parave, terrorizmin, krimet ekonomike dhe krimet e luftës. Misioni ishte i vetëdijshëm për rolin e tij të zvogëluar pasi që institucionet e Kosovës shpallen pavarësinë në vitin 2008, kishin për qëllim krijimin e PSRK-së për të siguruar transferimin e rasteve të pazgjidhura të UNMIK-ut në misionin e ri të ardhshëm për sundimin e ligjit EULEX. Që nga themelimi i saj, PSRK-ja u përqendrua kryesisht në çështjet e krimeve të luftës, por në vitet e fundit PSRK-ja i ka kushtuar gjithnjë e më shumë vëmendje rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë. Megjithatë, rezultatet kanë qenë të kufizuara me një normë prej përafërsisht 26 % të dënimeve për rastet e ngarkuara nga PSRK-ja në vitin 2012. Në krahasim zyra e USKOK në vitin 2012 kishte një normë prej 95 % të dënimeve.¹⁸⁵

PSRK-ja ka kompetencë të veçantë që të hetojë dhe ndjek penalisht, ndër të tjera, pastrimin e parave, veprat penale të terrorizmit, krimin e organizuar (neni 5) si dhe kompetencat plotësuese për veprat e përcaktuara në nenin 9 të ligjit (veprat e trafikimit, falsifikimit të parasë, veprat e korrupsionit dhe mashtrimit si dhe veprat e tjera të rënda). Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) ka Departamentin Kundër Korrupsionit të përbërë prej 5 prokurorëve special dhe 5 ekspertëve në luftën kundër korrupsionit, dhe Task Forcën të përbërë prej 30 oficerëve policorë të cilët ekskluzivisht merren me hetimin e veprave penale të korrupsionit. Doganat e Kosovës e kanë një Njësit të Standardeve Profesionale i cili merret me rastet disiplinore. Çfarëdo ankese serioze kundër zyrtarëve të Doganës së Kosovës do të shikohet në shkallë të parë nga Njësi i Inspektimit të Brendshëm dhe më vonë mund t'i kalohet Njësitit për Hetime të Doganës së Kosovës për hetime të mëtutjeshme. Administrata Tatimore e Kosovës e ka po ashtu një Njësit Hetimor të cilit mund t'i referojë raste të dyshimeve të korrupsionit për veprime/raportime të duhura.

¹⁸⁵ Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave KIPRED. Lufta kundër Korrupsionit: Analizë krahasuese mes Kosovës dhe Kroacisë, Analizë e Politikave Nr. 1/14 – Shkurt 2014, f. 9



4.4. Gjykatat

Gjerësisht është e përhapur bindja tek qytetarët e Kosovës se gjyqësori është ndër institucionet më të korruptuara në vend. Pa dyshim që, “një gjyqësor i dobët nuk mund të pritet ta luftojë korrupsionin e përhapur, i cili po e shkatërron gjithë shoqërinë. Ai fillimisht duhet ta eliminojë korrupsionin brenda radhëve të veta, në mënyrë që pastaj të mund ta ndjekë penalisht korrupsionin jashtë tij. Sfidë fillestare në këtë drejtim është vlerësimi se sa i korruptuar është vërtet gjyqësori, dhe në çfarë formash manifestohet ai korrupsion”¹⁸⁶.

Gjithsesi ky është vetëm perceptim qytetar, po megjithatë bazuar në shumë raporte, si të brendshme ashtu edhe të organizatave të ndryshme ndërkombëtare, vihet lehtë në përfundim se korrupsioni ka shtrirje mjaft të gjerë. Në këtë drejtim, rrjedh se “herë pas here shfaqen edhe akuza për forma të egra të korrupsionit, si për ryshfet, për shembull, megjithëse korrupsioni në gjyqësor tashmë po merr forma më të sofistikuara. Gjykatësit ose prokurorët shpeshherë dyshohen se kanë bërë trajtime preferenciale për miq dhe familjarë, duke i shtyer gjykimet, duke lejuar që lënda të parashkruhet, ose duke ndryshuar vendimin e lëndës shkaku i presionit politik. Ata akuzohen edhe për bashkëpunim me pjesëtarët e qeverisë, me parti politike ose me biznesmenë. Këto forma të korrupsionit - nepotizmi dhe ndikimi politik – është shumë më vështirë të provohen sesa pagesa apo marrja e ryshfetit, kështu që zhdukja e tyre mbetet çështje veçanërisht sfiduese”¹⁸⁷.

Megjithatë, shikuar nga një dioptri tjetër mund të thuhet që, “besimi se vendi dhe gjyqësori i tij janë të korruptuar pa dyshim se është i lartë, por çështja se sa ky besim e reflekton realitetin, në masë të madhe mbetet pa përgjigje. Me qëllim të trajtimit të problemit të korrupsionit në gjyqësor, edhe korrupsioni real edhe perceptimi i qytetarëve duhen adresuar bashkërisht. Mënyra e vetme për përmirësimin e imazhit të gjyqësorit në sytë e popullatës është nëpërmjet përpjekjeve të vazhdueshme për luftimin e korrupsionit. Proceset e gjata e të ngadalta, mungesa e interesimit për përfundimin e plotë të hetimeve dhe përsëritja e vazhdueshme e dënimeve më të ulëta të mundshme, vetëm sa e fuqizojnë bindjen për mosndëshkim”¹⁸⁸.

¹⁸⁶ GJYQËSORI I KEQ-ADMINISTRUAR I KOSOVËS, Analizë e Politikave, Balkans Policy Research Group (BPRG), Prishtinë, Shtator 2019, f.15

¹⁸⁷ Ibid, f. 16

¹⁸⁸ Po Aty, Fq.17



Gjithashtu, sa i përket efikasitet të punës së gjyqësorit, “gjatë dekadës së fundit është bërë një numër ndërhyrjesh në sistemin gjyqësor dhe është përgatitur një strategji sektoriale. Mirëpo, nuk është iniciuar asnjë qasje gjithëpërfshirëse ose strategjike për zhvillimin e një sundimi të efektshëm të ligjit. Gjurmët e sistemeve të ndryshme ligjore tashmë janë pjesë e sektorit të sundimit të ligjit. Reformat ad-hoc, mos koordinimi i qeverisë, i sistemit të drejtësisë dhe i donatorëve ndërkombëtarë, ndikuan në performancën e përgjithshme të gjyqësorit”¹⁸⁹. Veç tjerash një çështje mjaft me rëndësi që duhet trajtuar paraqet edhe reforma në administratën e sistemit gjyqësor dhe atij prokurorial. Në këtë kontekst dhe në mënyrë “që vërtet të kuptohet thelbi i problemeve të gjyqësorit, nuk mjafton përqendrimi vetëm në sundimin e ligjit; është e domosdoshme të shqyrtohen edhe qeverisja, institucionet administrative dhe anëtarët e personelit administrativ të gjykatave dhe prokurorisë. Përderisa gjyqësori kalon nëpër reforma të njëpasnjëshme, kryesisht falë presionit të BE-së dhe donatorëve tjerë ndërkombëtarë, roli kyç i administratës gjyqësore pothuajse injorohet tërësisht”¹⁹⁰. Këtu nuk bëtë të mbetet pa u përmendur që “sipas raporteve respektive, në gjykata punojnë mbi 1600 pjesëtarë të personelit administrativ, dhe mbi 565 të tjerë në prokurori. Nga ana tjetër, 560 prej tyre posedojnë vetëm diploma të shkollës së mesme”¹⁹¹.

¹⁸⁹ Po Aty, Fq.22

¹⁹⁰ Po Aty, Fq.24

¹⁹¹ Po Aty, Fq.30



KAPITULLI I PESTË

5. ANALIZA E TË DHËNAVE STATISTIKORE TË INSTITUCIONEVE TË DREJTËSISË (Këshillit Prokurorial dhe Këshillit Gjyqësor)

Për ta kuptuar ma mirë efikasitetin e sistemit gjyqësor, kemi kërkuar zyrtarisht nga Këshilli prokurorial dhe Këshilli gjyqësor i Kosovës të dhënat statistikore për aktet akuzuese të ngritura nga Prokuroria dhe vendimet gjyqësore të shqiptuara nga gjykatat e rregullta për periudhën 2015-2020. Në vijim janë paraqitur të dhënat statistikore.

Tabela 9. Aktet akuzuese të cilat janë ngritur nga Prokurori i shtetit për periudhën 2015-2020

Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare	
Raporti vjetor 2015 (1 janar - 31 dhjetor 2015)	
➤ Për 15 person është ngritur aktakuzë për dhënien e urdhrit ndëshkimor; ➤ Për 42 persona është ngritur aktakuzë e drejtpërdrejtë; ➤ Për 386 persona është ngritur aktakuzë pas procedurës hetimore.	
Raporti vjetor 2016 (1 janar - 31 dhjetor 2016)	
➤ Për 8 persona është ngritur aktakuzë për dhënien e urdhrit ndëshkimor ➤ Për 418 persona është ngritur aktakuzë.	
Raporti vjetor 2017 (1 janar - 31 dhjetor 2017)	
➤ Për 2 persona është ngritur aktakuzë për dhënien e urdhrit ndëshkimor; ➤ Për 30 persona është ngritur aktakuzë e drejtpërdrejtë; ➤ Për 282 persona është ngritur aktakuzë pas procedurës hetimore ➤ Për 3 persona (mënyrë tjetër)-është bashkuar procedura.	



Raporti vjetor 2018 (1 janar - 31 dhjetor 2018)
➤ Për 1 person –Aktakuzë për dhënien e urdhrit ndëshkimor; ➤ Për 21 persona – aktakuzë e drejtpërdrejtë; ➤ Për 229 persona – aktakuzë pas procedurës hetimore.
Raporti vjetor 2019 (1 janar - 31 dhjetor 2019)
➤ Për 12 persona është ngritur aktakuzë e drejtpërdrejtë; ➤ Për 220 persona është ngritur aktakuzë pas procedurës hetimore; ➤ Për 1 person – Aktakuzë për dhënien e urdhrit ndëshkimor
Raporti vjetor 2020 (1 janar - 31 dhjetor 2020)
➤ Për 15 persona është ngritur aktakuzë e drejtpërdrejtë; ➤ Për 230 persona është ngritur aktakuzë pas procedurës hetimore.

Burimi: Këshilli Prokurorial i Kosovës¹⁹²

Numri i akteve akuzuese të ngritura nga ana e prokurorit të shtetit ka pësuar rënie. Nëse në vitin 2016 kishin 426 persona ndaj të cilëve është ngritur akt akuzues, ky numër ka rënë në 245 në vitin 2020. Nga këto të dhëna mund të kuptojmë se në Kosovë në lidhje me korrupsionin mund të diskutohen dy çështje: e para, ulja e nivelit të korrupsionit dhe e dyta, mos efikasiteti i sistemit prokurorial në identifikimin e rasteve të korrupsionit me çka do të rezultonte në ngritjen e aktakuzave. Duke marrë parasysh perceptimin e korrupsionit që ekziston në vend dhe raportin e Transparency International (TI report, 2020), konstatimi që ka rënie të nivelit të korrupsionit nuk është i qëndrueshëm.

¹⁹² Tabela me statistika zyrtare janë marrë nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.



Tabela 10. Vendimet gjyqësore në lidhje me veprat penale korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare sipas rasteve të zgjidhura në periudhën 2016-2020

Viti	2016	2017	2018	2019	2020
KORRUPSIONI ZYRTAR DHE VEPRAT PENAL KUNDËR DETYRËS ZYRTARE	284	254	207	150	112
KEQPËRDORIMI I POZITËZ APO AUTORITETIT ZYRTAR (neni 414 kodit i ri, neni 422 sipas kodit te vjetër)	171	153	124	93	77
KEQPËRDORIMI DHE MASHTRIMI NË PROKURIM PUBLIK (neni 415 kodit i ri.)	2	2	0	0	0
KEQPËRDORIMI I INFORMATËS ZYRTARE (neni 416 kodit i ri, neni 423 sipas kodit te vjetër)	2	3	2	2	0
KONFLIKTI I INTERESIT (neni 417 kodit i ri, neni 424 sipas kodit te vjetër)	30	23	19	17	0
PËRVETËSIMI NË DETYRË (neni 418 kodit i ri, neni 425 sipas kodit te vjetër)	2	1	4	0	10
MASHTRIMI NË DETYRË (neni 419 kodit i ri, neni 426 sipas kodit te vjetër)	1	1	0	0	0
PËRDORIMI I PAAUTORIZUAR I PASURISË (neni 420 kodit i ri, neni 427 sipas kodit te vjetër)	28	21	30	15	1
MARRJA E RYSHFETIT (neni 421 kodit i ri, neni 428 sipas kodit te vjetër)	27	37	15	12	9
DHËNIA E RYSHFETIT (neni 422 kodit i ri, neni 429 sipas kodit te vjetër)	0	0	0	0	9
DHËNIA E RYSHFETIT ZYRTARIT PUBLIK TË HUAJ (neni 423 kodit i ri, neni 430 sipas kodit te vjetër)	7	4	4	2	0
USHTRIMI I NDIKIMIT (neni 424 kodit i ri, neni 431 sipas kodit te vjetër)	1	0	0	1	2



NXJERRJA E KUNDËRLIGJSHME E VENDIMEVE GJYQËSORE (neni 425 kodi i ri, neni 432 sipas kodit te vjetër)	2	1	2	0	0
ZBULIMI I FSHETËSISË ZYRTARE (neni 426 kodi i ri, neni 433 sipas kodit te vjetër)	7	8	7	8	0
FALSIFIKIMI I DOKUMENTIT ZYRTAR (neni 427 kodi i ri, neni 434 sipas kodit te vjetër)	4	0	0	0	4

Burimi: Këshilli Gjyqësor i Kosovës¹⁹³

Nga të dhënat e paraqitura në tabelë shihet se mbi 60% e vendimeve gjyqësore në vitet 2016-2019 lidhet me veprën KEQPËRDORIMI I POZITËS APO AUTORITETIT ZYRTAR (neni 414 kodi i ri, neni 422 sipas kodit te vjetër). Ky raport ndryshon dhe rritet në 68% në vitin 2020. Vendimet tjera që marrin pjesë me nga 10% përafërsisht janë: KONFLIKTI I INTERESIT (neni 417 kodi i ri, neni 424 sipas kodit te vjetër), PËRDORIMI I PAAUTORIZUAR I PASURISË (neni 420 kodi i ri, neni 427, sipas kodit te vjetër), MARRJA E RYSHFETIT (neni 421 kodi i ri, neni 428 sipas kodit te vjetër).

Nga analiza e trendit nëpër vite mund të vërehet një rënie e dukshme e vendimeve gjyqësore, posaçërisht tek vepra penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”, ku nga 171 vendime në vitin 2016, numri bie në 77 në vitin 2020. Trendi i tillë përcillet me një rënie vjetore prej 20% në vendimeve, por duhet të theksohet se viti 2020 ka vetëm 40% raste të zgjidhura në krahasim me vitin 2016.

Grafiku nr. 1. Paraqitja grafike lakores së vendimeve gjyqësore së rasteve të zgjidhura nga gjykatat në periudhën 2016-2020

¹⁹³ Tabela me statistika zyrtare janë marrë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.




Tabela 11: Vendimet gjyqësore në lidhje me veprat penale korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare sipas numrit të personave të zgjidhura në periudhën 2016-2020

Viti	2016	2017	2018	2019	2020
KORRUPSIONI ZYRTAR DHE VEPRAT PENAL KUNDËR DETYRËSZYRTARE	594	386	375	328	152
KEQPËRDORIMI I POZITËZ APO AUTORITETIT ZYRTAR (neni 414 Kodi i ri, neni 422 sipas kodit të vjetër)	402	245	242	253	107
KEQPËRDORIMI DHE MASHTRIMI NË PROKURIM PUBLIK (neni 415 Kodi i ri.)	2	2	0	0	0




KEQPËRDORIMI I INFORMATËS ZYRTARE (neni 416 kodit i ri, neni 423 sipas kodit te vjetër)	2	3	3	2	0
KONFLIKTI I INTERESIT (neni 417 kodit i ri, neni 424 sipas kodit te vjetër)	37	27	27	26	0
PËRVETËSIMI NË DETYRË (neni 418 kodit i ri, neni 425, sipas kodit te vjetër)	2	1	4	0	13
MASHTRIMI NË DETYRË (neni 419 kodit i ri, neni 426, sipas kodit te vjetër)	1	1	0	0	0
PËRDORIMI I PAAUTORIZUAR I PASURISË (neni 420 kodit i ri, neni 427 sipas kodit te vjetër)	52	41	64	18	1
MARRJA E RYSHFETIT (neni 421 kodit i ri, neni 428 sipas kodit te vjetër)	34	41	15	12	12
DHËNIA E RYSHFETIT (neni 422 kodit i ri, neni 429, sipas kodit te vjetër)	0	0	0	0	10
DHËNIA E RYSHFETIT ZYRTARIT PUBLIK TË HUAJ (neni 423 kodit i ri, neni 430 sipas kodit te vjetër)	11	4	8	4	0
USHTRIMI I NDIKIMIT (neni 424 kodit i ri, neni 431 sipas kodit te vjetër)	2	0	0	1	5
NXJERRJA E KUNDËRLIGJSHME E VENDIMEVE GJYQËSORE (neni 425 kodit i ri, neni 432 sipas kodit te vjetër)	4	9	2	0	0
ZBULIMI I FSHETËSISË ZYRTARE (neni 426 kodit i ri, neni 433 sipas kodit te vjetër)	7	12	10	12	0
FALSIFIKIMI I DOKUMENTIT ZYRTAR (neni 427 kodit i ri, neni 434 sipas kodit te vjetër)	38	0	0	0	4



Nga tabela 11 mund të konkludojmë se rreth 70% e vendimeve gjyqësore sipas personave lidhen me veprën “KEQPËRDORIMI I POZITËZ APO AUTORITETIT ZYRTAR” (neni 414 Kodi i ri, neni 422 sipas kodit të vjetër).

Duke qenë se trendi vendimeve gjyqësore është në rënie, atëherë edhe numri i personave të përfshirë ka pësuar rënie po ashtu. Nga 594 persona ndaj të cilëve është shqiptuar vendim në vitin 2016, ky numër bie në vetëm 152 në vitin 2020. Përderisa kemi një rënie prej mbi 35% (nga 594 në 386) të numrit të personave me vendime gjyqësore, vitet 2017, 2018 dhe 2019 i përcjell një rënie e vogël. Mirëpo, prapë në vitin 2020 kemi një zvogëlim të theksuar me mbi 55% të vendimeve sipas personave.

Grafiku nr. 2. Paraqitja grafike lakores së vendimeve gjyqësore sipas numrit të personave të zgjidhura nga gjykatat në periudhën 2016-2020





UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Ajo që mbetet shqetësuese është numri i rasteve të pazgjidhura të bartura nga viti në vit, i cili vitet e fundit ishte rreth 250. Pra, nëse gjyqësori nuk do të kishte zvogëluar numrin e vendimeve edhe përkundër zvogëlimit të akteve të reja akuzuese, gjykatat do të kishim shumë më pak lëndë të bartura dhe do të rritej shumë efikasiteti i punës së tyre.



6. PËRFUNDIMI

Nga ajo që elaboruam në tërë këtë punim kemi arritur të kuptojmë se fenomeni i korrupsionit është i përhapur kudo dhe në çdo vend. Kjo ka bërë që të ketë studime të mira nga autor të njohur. Ndër përkufizimet e njohura për korrupsionin vlejnë të përmenden, ato të Nye (1967) dhe Rose-Ackerman: “Korrupsioni është sjellje e cila devijon nga detyrat formale të një roli publik [zyre] për shkak të përfitimeve monetare (personale, familjare të ngushtë, private) private ose statusore; ose shkel rregullat kundër ushtrimit të disa llojeve të ndikimit privat”. “Korrupsion” është një term kuptimi i të cilit ndryshon me folësin. . . . Unë përdor përkufizimin e përbashkët të korrupsionit si "keqpërdorim i pushtetit publik për përfitime private ose politike", duke pranuar se "keqpërdorimi" duhet të përkufizohet në terma të disa standardeve.

Ky term është përkufizuar edhe nga instrumente ndërkombëtare, nga organizatat ndërkombëtare më e njohura është Transparency International TI, por edhe nga legjislacioni vendor.

Republika e Kosovës, ka krijuar një bazë ligjore moderne dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare kundër korrupsionit. Legjislacioni vendor në veçanti Kodi Penal i Kosovës i ka inkriminuar shumicën e veprave penale të cilat rekomandojnë konventat ndërkombëtare si Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit dhe Konventa Penale Evropiane. Ligjet tjera janë miratuar në funksion të parandalimit dhe luftimit efikas të kësaj dukurie.

Kodi penal i Republikës së Maqedonisë Veriore në kapitullin e tridhjetë (XXX) i ka paraparë veprat penale kundër detyrës zyrtare, që marrë në tërësi janë përafërsisht të njëjta me Kodin Penal të Kosovës. Janë vetëm 6 vepra penale që nuk përputhen me Kodin Penal të Kosovës. Në dallim prej Maqedonisë së Veriut, Kodi Penal i Shqipërisë i ndryshuar, veprat penale kundër detyrës zyrtare i ka të shpërndara në disa kapituj të Kodit Penal. Kjo e bën nganjëherë të vështirë si për studiuesit analizën shkencore ashtu edhe për praktikën gjyqësore të jetë efikase në luftimin e krimit të korrupsionit.

Në aspektin institucional janë krijuar institucione të cilat duhet të kryejnë detyrat e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe të luftojë korrupsionin galopant i cili ekziston në Kosovë. Është me rëndësi jetike që institucionet e pavarura, si Policia e Republikës së Kosovës,



Prokuroria e Shtetit dhe Sistemi Gjyqësor të punojnë në përputhje me legjislacion në fuqi dhe shteti seriozisht ta luftojë korrupsionin. Bashkëpunimi institucional në zbatimin e ligjit dhe përkrahja me informata dhe raportime nga qytetarët dhe denoncimi nga shoqëria civile mund të jetë kruciale në luftën efikase kundër korrupsionit.

Prokurorët duhet të jenë më kompetent në përgatitjen e lëndëve, efektiv dhe guximtar në luftimin e korrupsionit. Kjo përfundimisht do të varet nga mbështetja dhe mjetet institucionale (p.sh. masat shtesë të sigurisë për prokurorët dhe familjet e tyre). Këto masa duhet t'i japin shtytje përpjekjeve të prokurorisë së shtetit për luftimin efikas të korrupsionit. Prokurori i shtetit duhet të veprojë në pajtim me atë që e kërkojnë ligjet. Duhet investuar më shumë në mbështetje financiare me qëllim të trajnimit dhe rekrutimit të prokurorëve të rinj dhe stafit mbështetës. Gjithashtu duhet të investohet në programe adekuate trajnime për prokurorët dhe duk i dërguar jashtë Kosovës për ekspertiza hetimore dhe të specializohen për luftimin e korrupsionit.

Gjyqtarët duhet të jenë të guximshëm në nxjerrjen e aktgjykimeve të bazuara në prova dhe të shqiptojnë dënime meritorë ndaj kryerësve të veprave të korrupsionit. Në këtë aspekt duhet rritur edhe numri i gjykatëse dhe stafit mbështetës në mënyrë që të ulët volumi i lëndëve për gjyqtarët.

Për parandalim dhe luftim të korrupsionit janë të nevojshme veprimet institucionale si vijon:

- Monitorimi i procedurave të prokurimit publik në nivel lokal dhe qendror. Për çdo dyshim të arsyeshëm policia dhe prokuroria duhet të ndërmarrin veprime hetimore në procedurat e prokurimit publik;
- Raportet e Auditorit të përgjithshëm duhet të lexohen dhe merren në konsideratë për fillimin e hetimeve. Raportet e tilla mund të jenë bazë e mirë për hetime kundër korrupsionit.
- Mbikëqyrja e shtuar e punës së zyrtarëve të Administratës Tatimore të Kosovës. Hetimi i pasurisë së zyrtarëve drejtues por edhe inspektorëve tatimor mund të jetë pistë e mirë për fillimin e procesit penal ndaj tyre;
- Mbikëqyrja e shtuar e punës së oficerëve doganor në Doganën e Kosovës, pasi që ka indikacione se personeli doganor korruptohet gjatë zhvillimit të procedurave doganore;



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

- Duhet marrë në konsideratë krijimi i Zyrës Kombëtare të Hetimeve. Kjo zyre ndër të tjera, do të duhej merrej me hetimin e korrupsionit të zyrtarëve të lartë shtetëror duke filluar nga Presidenti i Republikës, Kryeministrit, zëvendës kryeministrave, ministrave, kryetarëve të komunave, zyrtarëve të lartë të Policisë së Kosovës, prokurorëve dhe gjyqtarëve. Kjo pasi që institucionet të cilat funksionojnë shtetërore deri me tani nuk kanë arritur të luftojnë seriozisht korrupsionin.



Bibliografia:

Abdiweli, M. Ali (2001), "Political Instability, Policy Uncertainty and Economic Growth: An Empirical Investigation", Atlantic Economic Journal, Vol. 29, No. 1

Acemoglu, D. and Robinson A. J. Why Nations Fail: The Origins of Power, Prosperity and Poverty (London: Profile, 2012). Diego Comin, William Easterly, and Erick Gong. "Was the Wealth of Nations Determined in 1000 BC?" American Economic Journal-Macroeconomics, 2 (July 2010)

Amundsen, I. "Political Corruption: An Introduction to the Issues", Chr. Michelsen Institute Development Studies and Human Rights, WP 1999.

Austin, C. R. Bërja dhe Ribërja e Ballkanit – Kombet dhe dhe shtetet që nga 1987-a. University of Toronto Press, Koha për botimin në shqip, 2021.

Bertuelle Y. Akeomoa, B.Y. [Types and Impact of corruption](#). 4 December 2017

Blanche, M. / Depardon, A. & Gros, F., EU Action Against Corruption: Steps forward and setbacks in a strategic policy for Europe, Themis Competition 2019

Bosso, F. / Martini, M. / Ardigó, I. A. Political Corruption Topic Guide Compiled by the Anti-Corruption Helpdesk. Transparency International.

Caniklioğlu, D. Meltem (1999), "Seçim Sistemlerinin Siyasi İstikrarın Sağlanmasındaki Rolü", Anayasa Yargısı Dergisi, No. 16

Davigo, P. Sistemi i Korrupsionit. Botimet Toena, Tiranë, 2017

Denker, F. / Galičić, D. / Geiser, J.C. dhe Dunga, E. "Raporti i Vlerësimit mbi përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare në fushën e luftës kundër korrupsionit (LKK), Këshilli i Evropës, Prill 2015, Edicioni në gjuhën shqipe (I përkthyer nga gjuha angleze) Botuar nga Këshilli i Evropës F-67075 Strasbourg Cedex

Fisman, R. and Golden, M. (2017). Corruption: What everyone needs to know. Oxford University Press.

Friedrich, [C. J.](#) "Political Pathology", The Political Quarterly, 37.1966.

Gardiner, J. A. 1970. The Politics of Corruption. New York: Russell Sage Foundation

Hetemi, j. M. & Jashari, N. Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit me komentim. Shtëpia botuese "Libri Shkollor", Prishtinë, 2013



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Kambovski, V., & Zejneli, I. E Drejta Penale – pjesa e përgjithshme. Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë, 2018

Khaghaghordyan, A. International Anti-corruption Normative Framework: the State of the Art Hertie School of Governance Friedrichstraße 180 10117 Berlin, Germany

Korajlic, N., Muharremi, D. dhe Ademaj, Xh. Fjalori Terminologjia Kriminalistike. Prishtinë

Mason, P. (2018). Pressure to change: A new donor approach to anti-corruption? Public Administration Review, 22 October.

Murray, M. and Spalding, A. Freedom from Official Corruption as a Human Right. Governance Studies at Brookings Institution, January, 2015

Myint, U. Corruption: Causes, Consequences and Cures. Asia-Pacific Development Journal Vol. 7, No. 2, December 2000.

Mungiu-Pippidi, A. (2016). Corruption as social order. Background paper for the 2017 World Development Report. Washington, DC: World Bank

Nye, J. S. (1967). Corruption and Political Development: A Cost-Benefit Analysis. American Political Science Review,

Rose-Ackerman, S. (1999b), "Political Corruption and Democracy", Journal of International Law, Vol. 14, No. 2

Rose-Ackerman, S. The Challenge of Poor Governance and Corruption. Copenhagen Consensus 2004 project. Cambridge University Press, 2004

Rothstein, B. and Teorell, J. 2012. "Defining and measuring quality of government." Pp. 6-26 in Good Government: The Relevance of Political Science, edited by S. Holmberg and B. Rothstein. Cheltenham: Edward Elgar.

Salihu, I. Leksikon i së Drejtës Penale. Prishtinë, 2022

Salihu, I. / Zhitija, H. / Hasani, F. Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Botimi 1, Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Prishtinë, 2014

Salihu, I. E Drejta Penale – Pjesa e posaçme. Universiteti i Prishtinës, Fakultetit Juridik, Prishtinë, 2021

Scott, J. C. 1972. Comparative political corruption. Prentice-Hall. Chapter 1.



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Scharbatke-Church, C. and Chigas, D. 2016. Taking the blinders off: Questioning how development assistance is used to combat corruption. Occasional Paper. Medford, MA:

Türedi, S. and Altiner, A. Economic and political factors affecting corruption in developing countries. IJER - JAN - FEB 2016. Available online@www.ijeronline.com.

Wathne, C. Understanding corruption and how to curb it A synthesis of latest thinking, Chr. Michelsen Institute (CMI) in Norway, U4 Issue 2021:3

Zejneli, I. / Shasivari, J. & Albana Metaj-Stojanova. Corruption as a form of Organized Crime. International Journal of Humanities and Social Science Vol. 4 No. 2 [Special Issue – January 2014]

Raportet

Analizë e Shkurtër, Hetimi i Korrupsionit në Kosovë: (Mos) Bashkëpunimi në mes të Policisë dhe Prokurorisë NR. 1/14, Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave – KIPRED, Prill 2014

European Commission (2014), The EU Anti-Corruption Report,

TNS Political and Social, Flash Eurobarometer 457: Businesses' attitudes towards corruption in the EU, 2017

European Parliament (2016) resolution of 25 October 2016 on the fight against corruption and follow-up of the CRIM resolution (2015/2110(INI))

Institute for Human Security, Fletcher School of Law and Diplomacy, Tufts University.

Transparency International. 2009. Anti-Corruption Plain Language Guide

OECD (2013), "What are bribery and corruption?", in Bribery and Corruption Awareness Handbook for Tax Examiners and Tax Auditors, OECD Publishing, Paris.

Compendium of International Legal Instruments on Corruption, Vienna, November, 2003

Freedom House, Nations in Transit, 2013

Technical Guide to the United Nations Convention Against Corruption, United Nations Office on Drugs and Crime Vienna, United Nations, New York, 2009



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Gjyqësori i keq-Administruar i Kosovës, Analizë e Politikave, Balkans Policy Research Group (BPRG), Prishtinë, Shtator 2019

Fighting Corruption Without Judicial Control, Prishtinë, Kosovo Law Institute, mars 2018
Instituti Gjyqësor i Kosovës, Kodi Penal i Republikës së Kosovës. Prishtinë, 2016

Nimoni, G. & Demhasaj, A.: Tenderomania e (pa)ndëshkuar, prill 2018, Organizata për Demokraci dhe Anti-Korrupsion, Çohu!: Prishtinë, 2018

Raport I Vlerësimit për pajtueshmërinë me standardet ndërkombëtare në fushën e luftës kundër korrupsionit (LKK), Këshilli i Evropës, Prishtinë, Dhjetor 2018

Gjykata Supreme e Kosovës, Udhëzues i veçantë - Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, Prishtinë, qershor 2021.

United Nations Manual On Anti-Corruption Policy, Prepared by the Global Programme against Corruption, Centre for International Crime Prevention, Office of Drug Control and Crime Prevention, United Nations Office at Vienna, 2001

Akte juridike

Kushtetuta e Republikës së Kosovës K-09042008, 09.04.2008

Konventës Civile për Korrupsionin, Strasbourg, Council of Europe, ETS No. 174 - Strasbourg 4.XI.1999

Komente mbi Konventën për Luftimin e Ryshfetit të Zyrtarëve Publikë të Huaj në Transaksionet e Biznesit Ndërkombëtar, OECD

Konventa e të drejtës civile për Korrupsionin, Council of Europe, ETS No. 174 - Strasbourg XI.1999

United Nations Convention Against Corruption United Nation, New York 2004

Criminal Law Convention on Corruption Council of Europe, ETS 173 - Strasbourg 27. I.1999

Kodi Nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 2 / 14 janar 2019, Prishtinë)

Ligjin kundër korrupsionit - Ligji Nr. 2004/34 (Gazeta Zyrtare e institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë / Prishtinë :Viti II / NR. 10 / 01 mars 2007)



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Ligji Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 8 / 11 mars 2019, Prishtinë)

Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik Ligji Nr. 06/L-011 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 5 / 27 Prill 2018, Prishtinë)

Kodi i Procedurës Penale - Kodi nr. 08/L-032 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 24 / 17 Gusht 2022, Prishtinë)

Ligj për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave, Ligji nr. 08/L-108 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 21 / 10 Gusht 2022, Prishtinë)

Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 04 / 19 Mars 2012, Prishtinë)

Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë - Kodi Penal ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 37/96). Ligji për Ndryshimet dhe Plotësimet në Kodin Penal ("Gazeta Zyrtare e Republika e Maqedonisë" nr. 80/99, 4/02, 43/03, 19/04, 81/05, 60/06, 73/06, 7/08, 139/08, 114/09, 51/11, 135/11, 185/2011, 142/2012, 166/2012, 55/2013,

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë_ Miratuar me ligjin nr.7895, datë 27.1.1995, i ndryshuar me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 21; ndryshuar me ligjin nr.9686, datë 26.2.2007, neni 21; pjesa që parashikon edhe dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim, shfuqizohet me ligjin nr.144, datë 2.5.2013.

Ligjit për Agjencinë për parandalimin e Korrupsionit, Ligji nr. 08/L – 017 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 19 / 21 Korrik 2022, Prishtinë)

Ligji për Prokurorin e Shtetit, Ligji Nr. 03/L-225 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti V / Nr. 83 / 29 Tetor 2010)

Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. ref.:AGJ 1583/20, në rastin nr. KO203/19 parashtrues Avokati i Popullit Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve të caktuara të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë

Web sajte

Štefan Šumah, Corruption, Causes and Consequences,

<http://dx.doi.org/10.5772/intechopen.72953>,

https://www.researchgate.net/publication/328081475_Corruption_Causes_and_Consequences#fullTextFileContent.

Transparency International. Corruption perceptions index 2021. I qasshëm në linkun:

https://www.transparency.org/en/cpi/2021?gclid=CjwKCAjwwb6lBhBJEiwAbuVUSo7h0yEr4iAnBu6P7BO8rkCXG3dmTtSpflek1cfwmf08g4mQOflzWRoCDr8QAvD_BwE



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

American Bar Association. What is the Rule of Law? I qasshëm në linkun:

https://www.americanbar.org/groups/public_education/resources/rule-of-law/

American Bar Association. Rule of Law and the Courts? I qasshëm në linkun:

https://www.americanbar.org/groups/public_education/resources/rule-of-law/rule-of-law-and-the-courts/

<https://www.transparency.org/en/cpi/2022>.

<http://www.corruptie.org/en/corruption/what-is-corruption/>

<https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/191>

<http://www.oecd.org/corruption-integrity/explore/oecd-standards/anti-bribery-convention/>

<https://www.unodc.org/unodc/en/corruption/uncac.html>

<file:///C:/Users/Lenovo/Downloads/Freedom%20from%20Official%20Corruption%20as%20a%20Human%20Right.pdf>

<https://www.minpostel.gov.cm/index.php/fr/cellule-anti-corruption/296-types-and-impact-of-corruption>

www.coe.int

https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/verdicts/PZ_PKR_2019-200452_SQ.pdf

https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/verdicts/PR_P_2020-046099_SQ.pdf

<https://betimiperdrejtesi.com/https-betimiperdrejtesi-com-wp-admin-post-phppost134372actionedit/>

<https://kallxo.com/ligji/akuzohet-se-mori-30-5-euro-ryshfet-denohe-me-burg-ish-zyrtari-i-gjykates-se-pejes/>

What is corruption? Available at: <https://www.transparency.org/what-is-corruption#define>.

Organizata për Demokraci, Antikorrupsion dhe Dinjitet, Çohu! Parandalimi i konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

<https://thedocs.worldbank.org/en/doc/419301611672162231-0090022021/original/AssetandInterestDeclarations.pdf>

<https://www.akk-ks.org/agjencia/43/strategjia/43>



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

https://www.akk-ks.org/luftimi_i_korrupsionit/162/zbatimi-i-ligjit/162. E shikuar për herë të fundit me 13 qershor 2023.

<https://akk-ks.org/agjencia/76/departamenti-i-hetimeve/76>. E shikuar për herë të fundit me 13 qershor 2023.

<https://www.kosovopolice.com/per-ne/historiku/>